


بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ



**THEMELIMI I QYTETËRIMIT
ISLAM NË MENDIMIN E
IMAM KHAMENEIT**



Themelimi i qytetërimit islam

**Titulli i librit: Themelimi i qytetërimit islam në
mendimin e imam Khameneit**

Autori: Sejjid Ali Khamenei

Përktheu: Vullnet Merja

Redaktoi: Jerida Kulla

Korrekttoi: Vjollca Karaj

Përgatiti për shtyp & Kopertina: Sabrie Feza

Botues: Shoqata FLLADI

بسم الله الرحمن الرحيم

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit,
Mëshirëbërësit!

HYRJE

Falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve. Paqja dhe bekimet qofshin për të Dërguarin tonë, Muhamedin, familjen e tij të pastër dhe sahabëve të tij të zgjedhur.

Shoqëria arabe ekzistonte me të mirat dhe të këqijat e saj të shumta, pastaj u përhap thirrja islame, me të cilën erdhi Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*), si përgëzues dhe paralajmërues për popullin e tij në veçanti dhe njerëzimin në përgjithësi. Kjo thirrje zuri vend në zemrat e besimtarëve dhe ka pozitë të bekuar, kurse motivuesi i saj është Mëshirues i madh. Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) bëri thirrje për të besuar Allahun, Krijuesin e universit dhe Formësuesin e qiejve dhe të tokës, që nxit për

punë të mira dhe ndalon të keqen, e nderon njeriun dhe e nxit të marri dituri kudo qoftë ajo, edhe në Kinë, po ta llogarisim me largësinë e vendeve në atë kohë.

Pa dyshim se ajetet e para të Librit të fesë islame, Kur'anit Famëlartë, nxisin fort për arsimimin: **“Lexo me emrin e Zotit tënd, i Cili krijoi (gjithçka), e krijoi njeriun nga një droçkë gjaku! Lexo! Zoti yt është Bujari më i madh, i Cili, me anë të penës ia mësoi njeriut ato që nuk i dinte.”**¹

Islami akoma edhe sot e nxit shumë arsimimin dhe bën thirrje në shumë ajete të bekuara: **“I Gjithëmëshirshmi ua ka mësuar Kur'anin (robëve të Tij), ka krijuar njeriun dhe i ka mësuar atij të folurit e qartë.”**²

Pra, shkenca e të folurit, e të shprehurit është e krahasuar me krijimin e njeriut. Islami i lavdëron shumë dijetarët dhe shkencëtarët dhe bën dallimin në gjykimin për ta, ndërmjet njerëzve të tjerë të thjeshtë. Libri i bekuar thotë: **“A janë të barabartë ata që dinë dhe ata që nuk dinë?! Vetëm mendarët i pranojnë këshillat!”**³

Sa herë që njeriu e shton diturinë e tij, aq më shumë afrohet me Allahun e Madhëruar, duke e njohur më mirë dhe duke iu frikësuar Atij. Kur'ani e ka regjistruar këtë: **“Në**

¹ Sure “El Alak”, ajetet 1-5.

² Sure “Er Rrahman”, ajetet 1-4.

³ Sure “Ez Zumer”, ajeti 9.

të vërtetë, nga robtë e Tij, Allahut i frikësohen vetëm dijetarët, (që e dinë se) Allahu është vërtet i Plotfuqishëm dhe Falës.”⁴

Kur’ani Famëlartë i flet zemrës dhe mendjes së bashku dhe i nxit ato që të shikojnë me vëmendje çdo gjë që ka krijuar Allahu i Madhëruar, sepse pa dyshim, mendja më e drejtë dhe zemra e hapur, nëse i shikojnë me mirësi argumentet e Allahut, do të jenë më afër besimit dhe më afër devotshmërisë: **“Këta shembuj Ne ua paraqesim njerëzve, por ata nuk i kupton kush, përveç dijetarëve.”⁵**

Brenda intervalit të nxitjes së mendjes njerëzore në meditim dhe në të menduar, Allahu i Madhëruar na thotë: **“Me të vërtetë, në krijimin e qiejve dhe të Tokës dhe në ndërrimin e natës e të ditës, ka shenja për mendarët, për ata që e përmendin Allahun duke qëndruar në këmbë, ndenjor ose shtrirë dhe që meditojnë për krijimin e qiejve dhe të Tokës (duke thënë: ‘O Zoti Ynë! Ti nuk i ke krijuar kot këto - lartësuar qofsh (nga çdo e metë)! Prandaj na ruaj nga ndëshkimi i zjarrit.’.”⁶**

Islami i flet logjikës, mendjes dhe e nxit të meditojë në krijimin e universit dhe, nëse mundet, të arrijë deri në skajet e njohurisë dhe majat e shkencës. Libri i lavdishëm

⁴ Sure “El Fatir”, ajeti 28.

⁵ Sure “El Ankebut”, ajeti 43.

⁶ Sure “Ali Imran”, ajetet 190-191.

thotë: **“Me të vërtetë, në krijimin e qiejve dhe të Tokës, në këmbimin e natës me ditën, në anijet që lundrojnë nëpër det për t’u sjellë dobi njerëzve, në ujin që Allahu zbret prej qiellit, duke ngjallur përmes tij tokën e vdekur dhe duke shpërndarë gjithfarë gjallesash, në lëvizjen e erërave dhe në retë që qëndrojnë midis qiellit e Tokës, pra, në të gjitha këto, sigurisht që ka shenja për njerëzit me intelekt.”⁷**

Me të vërtetë, Libri i Islamit e orienton mendjen kah meditimi rreth çdo gjëje, që mund t’i vijë në mendje një njeriu të logjikshëm. Nuk ekziston as dyshimi më i vogël, që krijimi i qiejve dhe i tokës të fton në meditim rreth tyre, se ndryshimi i natës dhe i ditës të nxit në reflektim, përgatitja e përmbajtjes së ujit për anijen që ec mbi të dhe zbritja e shiut nga qielli, për ta ringjallur tokën e të mbijnë të mbjellat, të gjitha këto ta tërheqin shikimin, duke e vënë në lëvizje zemrën, mendjen dhe arsyen.

E nëse qytetërimi është bija e shkencës, shkenca është një qëllim, një objekt studimi, një objektiv, që çdo mysliman shkon drejt saj, nisur nga realiteti i Librit në të cilin ka besuar, si dhe mësimet e të Dërguarit të tij, i cili e ka udhëzuar atë. Atëherë, pra, nuk ekziston asnjë dyshim se dija, shkenca të shtyjnë drejt krijimit, formimit, shpikjes, meditimit dhe reflektimit. Nga të gjitha këto, duke nisur prej

⁷ Sure “El Bekare”, ajeti 164.

krijimit, shpikjes, meditimit dhe reflektimit, lind qytetërimi dhe buron dija, njohuria.

Ky libër “Themelimi i qytetërimit islam” flet për hapat e para që ndërmori Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) në përcjelljen e mesazhit islam në Gadishullin Arabik, që pastaj e përhapi atë në pjesë të ndryshme, duke mbërritur në ndërtimin e qytetërimit madhështor islam në një periudhë kohore shumë të shkurtër, duke e krahasuar me kohët që i duhet ndërtimit të qytetërimeve të tjera. Ai paraqet një listë të detajuar të fazave të ndryshme nëpër të cilat kanë kaluar myslimanët, për të arritur deri në periudhën kohore të Imam Khomeinit dhe ndërtimin e shtetit dhe sistemit islam.

Ai është një studim i thellë dhe i ri shkencor rreth themelimit të qytetërimit islam, që mbështetet në mendimin original të Imam Khameneit. Ajo nuk zhytet në mënyrë të ngurtë në ngjarje, si studimet provokuese historike, përkundrazi i analizon thellë ngjarjet dhe i ekzaminon ato jo vetëm nga porta e të tashmes, por edhe e të ardhmes.

Falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve!

PËRSHKRIMI I QYTETËRIMIT

NË FILLIM TË ISLAMIT

Themelimi i qytetërimit islam

Reflektimi në histori, është një faktor për ndërtimin e të ardhmes

Përgatitja e themelimit të qytetërimit islam

Rigjallërimi i një qytetërimi madhështor nga Saharaja

Propozimi i një modeli gjithëpërfshirës dhe të përhershëm: I Dërguari i Allahut ndërton modelin

Marrja e mesazhit hyjnor dhe zbatimi i tij

Mesazhi i lirisë, vigjilenca dhe lumturia

Zemrat e flakëruara të banorëve të Medines

Pritja e përzemërt e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) nuk është thjesht

nderim e respekt, megjithëse pritje të tilla të përzemërta, në mesin e popujve myslimanë, bëheshin në rastet e trofeve të luftës, madje ajo është e domosdoshme. Mirëpo çështja është më e thellë se kaq. Bota islame, veçanërisht në ditët e sotme, ka më tepër nevojë se kurrë për çdo ditë të kaluar më parë, për ringjalljen e përkujtimit të Profetit të Islamit, Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*).

Edhe njerëzimi ka nevojë për këtë emër të bekuar, për mësimet e tij të çmuara. Mirëpo, përpara se t'i kërkojmë gjithë njerëzimit ta bëjë këtë gjë, bota islame e ka për detyrë të identifikojë rishtazi pasurinë e tij shpirtërore. Të mos bëhen si ata popujt që kanë rënë për të fjetur të uritur, mbi pasuritë e saj materiale, të panjohura për ta, deri sa erdhën të tjerët, duke ua grabitur. Bota islame sot po vuan. Pavarësisht rezervave shpirtërore, kanë lindur probleme të shumta. Ndërkohë, këto rezerva, depozita të stërmëdha dhe pasuri pafund mund ta çlirojnë atë dhe t'i japin një ndihmë.⁸

Themelimi i qytetërimit islam

⁸ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në takimin me punonjësit e administratës publike, më 12.7.1998.

Në fillimet e Islamit, i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) shokët e tij, kalifët e mëdhenj, me mbështetjen tek Allahu i Madhëruar, arritën të themelonin një qytetërim madhështor historik, edhe pse ata ishin të paktë në numër, përballë forcave të mëdha. Mirëpo besimi ua shtoi atyre fuqinë dhe arritën të realizonin veprën më madhështore në histori, që zgjati me shekuj. Përse ne nuk mund ta bëjmë këtë gjë?

“Mos u ligështoni dhe mos u pikëlloni, sepse ju, gjithsesi jeni më të lartët, nëse jeni besimtarë të vërtetë.”⁹

Prandaj duhet ta përvetësojmë patjetër kushtin e besimit.¹⁰

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*), në një periudhë të shkurtër kohore, në kufijtë e dhjetë viteve, hodhi themelet e ndërtesës së një qytetërimi madhështor. Këtu bëhet e qartë madhështia e këtij Profeti. Shikoni, kanë kaluar njëzet e dy vite, që nga koha e revolucionit tonë, mirëpo ne nuk u larguam në dekadën e parë prej saj. Kjo është madhështia e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*). Kjo është forca e profecisë. Njerëzit i afroji afër vetes dhe i përdori ata në atë mënyrë, sa ia bënë të mundur atij të ndërtojë atë qytetërim, për një periudhë aq të shkurtër. Në

⁹ Sure “Ali Imran”, ajeti 139.

¹⁰ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në takimin me imamët e xhumave, në disa shtete, më, 22.2.1985.

fillimet e tij, nga një qytet i vetëm, që bashkonte disa mijëra individë, u ndërtua një qytetërim gjigant. Shekulli i katërt hixhri, ose shekujt dhjetë dhe njëmbëdhjetë të kalendarit diellor, janë një terr i vërtetë i shekujve të mesjetës në Evropë.

Në këtë shekull themelohej qeveria islame dhe qytetërimi islam, ku u shfaqën shumë modele, si: Ibn Sina (Avicena), Farabi, Khavarizmi e shumë personalitete të tjera. Në botë u shfaqën qeveri dhe forca politike të mëdha, të cilat, për fat të keq, shumica e tyre u sprovuan me korrupsion. Në atë kohë, ato bënë hapa prapa menjëherë, pasi, në të kundërt, nëse nuk do të ishin të korruptuara, nuk do të sprovoheshin me korrupsion dhe shkatërrim. Po të ndiqnin shembullin e qeverisë së mbrojtjes hyjnore, ky lulëzim do të zgjaste me shekuj. Në atë kohë ne morëm goditje.

Bërthama e të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) u rrit në këtë formë. Me kalimin e kohës dhe kjo ishte thelbësore, siç e thonë inxhinierët, u krijua një themel i fortë, ku mund të ndërtohej një ndërtesë madhështore mbi të. Shikoni, sa qeveri të mëdha islame kanë ekzistuar në shekullin e katërt, që nga

Lindja e largët e deri në zemër të Evropës, në Andaluzi, Spanja e sotme e deri në kufijtë e Afrikës.¹¹

Reflektimi në histori, është një faktor për ndërtimin e të ardhmes

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) dhe shokët e tij, përgjatë trembëdhjetë viteve, kanë hasur shumë vështirësi. Kanë gëlltitur shumë hidhërime, për të ngulur pemën e Islamit.

Nëse myslimani e shikon me vëmendje këtë të shkuar dhe e përjeton atë, qoftë edhe me disa çaste dhe lidhet fort me të ardhmen, atëherë ai do ta mësojë rrugën dhe qëllimin e jetës. Ai do të jetë i vetëdijshëm për rreziqet e rrugës, do ta shikojë me syrin e nënës errësirën e kësaj rruge dhe do ta përgatisë veten për t'iu bashkuar asaj rruge, do ta mposhtë dyshimin që lind nga frika prej armikut dhe ndjesinë e të qenit i dobët dhe përbuzjen para tij.¹²

¹¹ Fragment nga fjalim i udhëheqësit, në takimin me organet e Asamblesë Islamike të Studentëve Universitarë, më 7.11.2000.

¹² Deklaratë e udhëheqësit për haxhinjtë e Shtëpisë së Shenjtë të Allahut (Qabes), më 16.06.1991.

Përgatitja e themelimit të qytetërimit islam

Çfarë ka ngjarë në tokën e Shpalljes hyjnore?

Këtu ka ngjarë triumfi i Bedrit dhe disfata e Uhudit. Përvoja e hidhur e Hendekut dhe sprovimi i Hudejbijes. Këtu është fabrikuar singeriteti dhe xihadi i triumfit dhe është gjunjëzuar dashuria për pasurinë dhe babëzia, lakmia për pushtet. Këtu ka zbritur Kur'ani, ajet pas ajeti dhe janë vendosur tullat e kulturës, të qytetërimit dhe të jetës së bukur islame.¹³

Rigjallërimi i një qytetërimi madhështor nga Saharaja

Në histori ka ndodhur një dukuri, që, nëse duam ta analizojmë atë mbi bazë të krahasimeve të zakonshme historike, është e pamundur të bëhet. Një komb, që një herë e një kohë, ishte i privuar nga përparësitë e qytetërimit njerëzor, hodhi themelet e një ndërtese që formoi një nga qytetërimet më madhështore të njerëzimit. Kjo është rilindja islame.

Po cili e formoi qytetërimin? Me dy qytetërimet e lashta, greke dhe romake, Evropa e sotme jo vetëm mburret

¹³ Deklaratë e udhëheqësit për haxhinjtë e Qabes, më 6.6.1991.

me to, por edhe argumenton historinë dhe studimet e saj shkencore. Çdo hap i atyre të dyjave, ishte pasuese e hapit të kaluar. Si mund të rilindë nga shkretëtira një qytetërim gjigant? A është e mundur të ndodhë një gjë e tillë? Mirëpo një shembull i tillë ka ndodhur, duke iu referuar Islamit. Një pakicë shumë e vogël, e cila nuk dinte as shkrim e as këndim, themeloi këtë qytetërim. Si ndodhi, pra, që ky qytetërim arriti të mësonte dhe të lexonte libra të ndryshëm dhe të shpikte teoritë shkencore, të cilat janë vërtetuar në standardin më të lartë në ndeshjet e teorive shkencore të njerëzimit? Shikoni, çfarë rrugësh të gjata janë këto.¹⁴

Propozimi i një modeli gjithëpërfshirës dhe të përhershëm: I Dërguari i Allahut ndërton “modelin”

Vërtet, periudha kohore e Medines ishte një periudhë e themelimit të sistemit islam dhe ndërtimit të një modeli, nisur nga urtësia e Islamit, për të gjitha periudhat historike të historisë së njerëzimit dhe për të gjitha vendet.

Ky model, sigurisht që është i përsosur. Shembull të tillë nuk kemi parë në asnjë periudhë kohe të historisë. Mirëpo, po ta shikojmë këtë model të përsosur, ne mund të

¹⁴ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në takimin me komandantët e Gardës Revolucionare Islamike, më 20.9.1994.

gjejmë në të tregues të shumtë. Këta tregues, për sa u përket individëve të tjerë dhe myslimanëve, janë shenja që, nëpërmjet tyre, të menaxhohen sistemet dhe njerëzit. Por si mund të miratohet kjo dhe si mund t'i afrohen atij ata që vijnë pas tyre, pasi kjo varet nga përpjekjet e tyre.¹⁵

Marrja e mesazhit hyjnor dhe zbatimi i tij

Kjo krijesë e shenjtë, përgjatë misionit të tij si profet, u përball me këtë botë me një xhihad shumë të vështirë. Ai e nxori anën njerëzore të njeriut nga injoranca, mashtrimet, nga korrupsioni, nga errësira, nga grindjet dhe fanatizmat fisnore, si dhe paralajmëroi mizorinë e njerëzve ndaj njerëzve (njëri-tjetrit) dhe nënshtrimin ndaj njëri-tjetrit.

Ai bëri ndryshimin rrënjësor të gjendjes njerëzore, krijoi një atmosferë dhe situatë të mirë e të re në botë. E vetëkuptueshme se puna e vulës së profetëve nuk është reformimi i të gjithë botës. Jo, detyra e këtij njeriu madhështor ishte që ta merrte vetë këtë detyrë të posaçme dhe këtë model të saktë nga Shpallja hyjnore, që t'ia mësojë njerëzimit dhe njerëzit, përgjatë gjithë jetës së tyre, që ata të angazhohen me të, të marrin përgjegjësitë dhe të përfitojnë çast pas çasti. Të flasim për atë që ka apo jo përgjegjësinë. Ai

¹⁵ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në hytben e namazit të xhumasë, në Teheran, më 18.5.2001.

që humbet, është një diskutim tjetër. Ai njeri i madh e përçoi plotësisht mesazhin e tij, e kreu detyrën dhe u shpërngul afër mëshirës së Zotit të tij.¹⁶

Mesazhi i lirisë, vigjilenca dhe lumturia

Qëllimi i migrimit të të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) drejt Medines, ishte luftimi i padrejtësisë, i korrupsionit, i mizorisë, pa dallime, politike, ekonomike dhe sociale, të cilat në atë periudhë kishin mbuluar botën nga cepi në cep. Qëllimi i tij nuk ishte vetëm luftimi i jobesimtarëve të Mekës, por çështja ishte gjithëpërfshirëse, botërore.

I Dërguari i nderuar (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) bënte përpjekje për këtë synim dhe kudo që ekzistonte një situatë ndihmëse, mbështetëse, ai mbillte farat e mendimit dhe të besimit, me shpresën se këto farëra do të piqeshin në kohën e duhur.

Qëllimi ishte përcjellja e mesazhit të lirisë së njeriut, të vigjilencës dhe lumturisë të të gjitha zemrat. Kjo ishte e pamundur të bëhej pa formimin e sistemit të modelit dhe shembullit, prandaj Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i*

¹⁶ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në takimin me përfaqësues nga segmente të ndryshme të shoqërisë, më 5.9.1993.

Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!) migroi drejt Medines, për të formuar këtë sistem model.¹⁷

Zemrat e flakëruara të banorëve të Medines

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) migroi në Medine. Më parë, ky qytet njihej me emrin Jethrib dhe pas hixhretit të Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) u quajt “qyteti i Profetit”, njësoj si flladi i freskët i pranverës që kaploi Medinen dhe të gjithë e ndjenë atë, prandaj edhe zemrat i kushtuan vëmendje dhe u zgjuan nga gjumi letargjik.

Pasi Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) mbërriti në Medine, këtë dëshirë të zjarrtë dhe këtë fllad të butë e harmonik, e shndërroi në një stuhi në zemrat e njerëzve, duke ua ndryshuar ato. Papritur, ata ndjenë se besimet e tyre, emocionet dhe lidhjet fisnore, si dhe fanatizmat e tyre, u zhdukën dhe u shkrinë në personalitetin e këtij njeriu, në moralin dhe fjalët e tij. Nëpërmjet një porte të re, ata u njohën jo vetëm me të vërtetat e botës të së vërtetës, por edhe me njohuritë morale. Vetë ky ciklon i trondiste zemrat dhe shkaktonte një

¹⁷ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në hytben e namazit të xhumasë, në Teheran, më 18.5.2001.

revolucion në shpirt. Më pas u përhap në të gjithë qytetin, duke pushtuar mburojën natyrale të Mekës dhe në fund vuri këmbët në zonat e vështira, duke mbërritur jo vetëm në thellësitë e dy perandorive dhe dy shteteve të tyre të mëdha në atë periudhë, por edhe në çdo vend.¹⁸

¹⁸ Nga një fjalim i imam Khameneit, marrë nga dy hytbe të namazit të xhumasë, në Teheran, më 18.5.2001.

SHTYLLAT E FORMIMIT TË QYTETËRIMIT

Besimet dhe mendimet e vërteta

Edukimi i karaktereve - Parimet dhe themelet e njerëzimit

*Nga njerëz injorantë, të paditur, në personalitete madhështore,
dritëdhënëse*

Formimi i qelizave të trupit të ymetit islam

Rëndësia e kohës së rinisë në sistemin islam

Ndërtimi i kombit

Besimet dhe mendimet e vërteta

Sigurisht që formimi i një sistemi të tillë, ka nevojë për shtyllat e besimit ideologjik njerëzor. Së pari, duhet të ekzistojnë besime dhe mendime të drejta e të vërteta, me qëllim që ky sistem të ndërtohet mbi bazë të atyre mendimeve. I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*), në fazën e Shpalljes hyjnore, në Mekë, e cila zgjati për trembëdhjetë vite, i bëri të qarta besimet dhe mendimet, me modelin e fjalës së Teuhidit dhe respektimit të njeriut, si dhe njohurive të tjera islame.

Pas kësaj, gjithashtu, në Medinë dhe në të gjitha kohët dhe çastet e jetës së tij, deri kur ndërroi jetë, ai gjithmonë përsëriste këto mendime dhe njohuri të larta, të cilat janë bazat e këtij sistemi, duke ia mësuar këtij apo atij.¹⁹

Edukimi i karaktereve - Parimet dhe themelet e njerëzimit

Parimet dhe themelet e njerëzimit janë të domosdoshme për të ngritur këtë ndërtesë, sepse sistemi islam nuk ndërtohet mbi individin. I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) ngriti

¹⁹ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në hytben e namazit të xhumasë, në Teheran, më 18.5.2001.

dhe përgatiti shumë prej këtyre themeleve në Mekë. Atje ishte një grupim, xhemat, sahabët e të Dërguarit të bekuar (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) nga radhë të ndryshme.

Këta njerëz ishin produkt i përpjekjes dhe xhihadit të periudhës së vështirë kohore prej trembëdhjetë vitesh në Mekë. Gjithashtu, aty ishte edhe një grupim tjetër. Ata ishin individë që kanë qenë në Jethrib, para se Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) të migronte atje dhe dolën në pah kur dëgjuan për mesazhin e të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*). Këta individë ishin: Sa'd ibn Muadhi, Ebu Ejub Ensariu, etj.

Kur i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) mbërriti aty, filloi menjëherë me formimin e njeriut dhe ditë pas dite, në Medine, hynin menaxherë të denjë, njerëz të mëdhenj, trima, tolerantë, besimtarë, të fuqishëm, të ditur e të mençur, si të ishin shtylla të forta të kësaj ndërtese madhështore dhe ndriçuese.²⁰

²⁰ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në hytben e namazit të xhumasë, në Teheran, më 18.5.2001.

Nga njerëz injorantë, të paditur, në personalitete madhështore, dritdhënëse

Para se të shfaqej Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) dhe mesazhi i tij islam, kishte individë, si: Ebu Dherri, Mikdadi dhe Amari, që jetonin njësoj si pjesa tjetër e njerëzve, në errësirën e injorancës. Mirëpo, me lindjen e diellit të Islamit, nga Amari lindi një personalitet i madh, me vlera të larta që zgjati deri në fund të jetës së tij, afro nëntëdhjetë vite, gjithmonë në shërbim të Islamit, duke bërë vepra për Allahun dhe duke i duruar vështirësitë në rrugën e Tij. Islami ndërtoi edhe personalitete të tjera të mëdha, si: Mikdadi, Ebu Dherri dhe shumë të tjerë.

Çfarë lloj njerëzish ishin këta? Këta njerëz ishin beduinë, banorë të shkretëtirës, primitivë dhe injorantë.²¹

Formimi i qelizave të trupit të ymetit islam

Qeliza e parë e trupit të ymetit islam, u formua nga dora e fortë e Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) në ato ditë të vështira në Mekë. Ai ngriti shtylla të forta e të trasha, që duheshin për ndërtimin

²¹ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në takimin me familjarët e shehidëve, më 23.10.1991.

e ymetit islam. I pari i besimtarëve dhe personat e parë që kishin këtë dituri, këtë guxim, këtë dritë, duke e kuptuar mirë mesazhin e të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) u lidhën fort pas tij.

“Allahu ia hap zemrën për (të pranuar) Islamin atij që dëshiron ta udhëzojë, ndërsa atij që dëshiron ta lërë në humbje, (ia mbyll zemrën e) ia shtrëngon gjoksin si të jetë duke u ngjitur në qiell. Kështu, Allahu, i ndëshkon ata që nuk besojnë.”²²

Zemrat u përgatitën dhe portat u hapën drejt këtyre njohurive dhe urdhëresave hyjnore me duart e forta të të Dërguarit Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*). Këto mendje dhe dëshira shkëlqyen dhe ndriçuan e ditë pas dite u bënë më të forta.²³

Rëndësia e kohës së rinisë në sistemin islam

Akoma edhe sot nuk mund të pranohet që të lejojmë të shkojë kot qoftë një ditë apo një orë, nga jeta e një të riu fetar, besimtar, i gatshëm për punë dhe për luftë në rrugën e fesë së Allahut. Prandaj koha për një të ri me tipare të tilla,

²² Sure “El En’am”, ajeti 125.

²³ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në takimin me administratën dhe pjesëmarrësit e Konferencës së Unionit Islamik, më 22.8.2006.

kur Islami ka sukses të vërë në jetë sistemin e ri të ngritur mbi mendimin dhe të menduarit, si dhe vizionin universal përpara njerëzimit, nuk duhet të shpenzohet kot. Përkundrazi duhet të sigurohet qëllimi i përhapjes së Islamit, promovimi dhe njohja e tij.²⁴

Ndërtimi i kombit (ymetit)

Ndërtimi i kombit zgjati për dhjetë vite. Ky nuk ishte një ndërtim politik i tij, vetëm se një pjesë e saj ishte ndërtuar politikisht, por pjesa kryesore e saj ishte ndërtuar mbi edukimin e individëve: **“Është Ai që u solli të analfabetëve një të Dërguar nga gjiri i tyre, për t’u lexuar atyre Shpalljet e Tij, për t’i pastruar e për t’u mësuar Librin²⁵ dhe Urtësinë,²⁶ ndonëse ata më parë ishin vërtet në humbje të plotë.”²⁷**

Zemrat të pastrohen, të radhiten një e nga një, nën edukimin e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*).

²⁴ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në takimin “Meritorët e virtytit shkencor”, në Kum, më 24.1.1991.

²⁵ Kur’anin.

²⁶ Sunetin dhe rregullat fetare.

²⁷ Sure “El Xhumu’a”, ajeti 2.

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) ua mësonte njerëzve dijen, një e nga një: **“për t’u mësuar Librin dhe Urtësinë”**. Urtësia është shkalla më e lartë e dijes. Ai nuk u mësonte atyre vetëm rregullat, ligjet dhe Sheriatin, përkundrazi ua mësonte atyre edhe urtësinë dhe ua hapte sytë para të vërtetave të botës.

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) qëndroi në këtë situatë për një periudhë kohe prej dhjetë vitesh: nga njëra anë është politika, menaxhimi i qeverisë, mbrojtja e ekzistencës së shoqërisë islame, zgjerimi i rrethit të Islamit, hapja e rrugës përpara grupimeve që qëndronin jashtë Medines, për t’i futur gradualisht dhe një e nga një në oborrin hyjnor të Islamit dhe njohurive të Islamit, kurse në anën tjetër, ekziston, gjithashtu, edukimi i individëve një e nga një. Këto dy çështje kurrësi nuk mund të ndahen nga njëra-tjetra.²⁸

²⁸ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në takimin me administratën e shtetit dhe pjesëmarrësit e Konferencës së Unionit Islam, më 22.8.2006.

NJOHURITË THELBËSORE NË SISTEMIN E QEVERISË SË TË DËRGUARIT

TË ALLAHUT

*(Paqja e bekimi i
Allahut qoftë mbi të
e mbi familjen e tij!)*

Njohuria e parë: Qartësia

Njohuria e dytë: Drejtësia absolute dhe gjithëpërfshirëse

Njohuria e tretë: Adhurimi i plotë, pa asnjë ortakëri (shirk)

Njohuria e katërt: Pasioni dhe dashuria për Allahun

Njohuria e pestë: Rekomandimi i njerëzve dhe arsimimi i tyre

Njohuria e gjashtë: Xhiahadi dhe sakrifica në rrugë të Allahut

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*), për ndërtimin e qytetërimit islam, formoi një sistem mësimesh. Po i sqarojmë ato me radhë.

Njohuria e parë: Qartësia

Vetë kjo njohuri është ndalur te dija dhe marrja e dijes, duke e çuar shoqërinë islame në shekullin e katërt të hixhretit në shkallën më të lartë të zhvillimit shkencor. Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) nuk do ta lejonte kurrë dyshimin apo dykuptimësinë dhe për çdo çështje që kishte dykuptimësi, zbriste një ajet kur'anor për ta qartësuar dhe për ta ngritur lart atë.²⁹

Njohuria e dytë: Drejtësia absolute dhe gjithëpërfshirëse

Drejtësi në gjykim, qeverisje, drejtësi në marrëdhëniet e përgjithshme dhe jo personale; drejtësi në

²⁹ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në hytben e namazit të xhumasë, në Teheran, më 8.5.1998.

pasuritë e lidhura me të gjithë njerëzit dhe që duhet të ndahen mes tyre në bazë të drejtësisë.

Drejtësi në caktimin e kufijve hyjnorë, drejtësi në poste shtetërore, në shpërndarjen e përgjegjësisë, si dhe në pranimin e tyre. Sigurisht drejtësia është e pabarabartë. Mos ju duket çështje e dyshimtë. Ndonjëherë barazia bëhet e padrejtë. Drejtësi do të thotë: Të vësh çdo gjë në vendin e vet dhe çdokujt që i takon e drejta, t'i japësh hakun.

Në kohën e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) asnjë individ në shoqërinë islame nuk ka qenë jashtë kornizës së drejtësisë.³⁰

Prandaj, s'ka dyshim se ta shikosh me kujdes drejtësinë, t'i japësh shpërblimin drejtësisë, e gjitha kjo është ngarkim me përgjegjësi dhe duhet të konsiderohet patjetër si një tregues i sistemit islam.

Çdo gjë duhet të vendoset nën hijen e drejtësisë.

³⁰ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në hytben e namazit të xhumasë, në Teheran, më 8.5.1998.

* "Sahifetul Imam", vëll. 11, f. 1: "Qeveria e parë islame, u formua në dy periudha kohore. Herën e parë u formua në kohën e të Dërguarit të Allahut, kurse herën e dytë, kur Imam Ali bin Ebu Talibi drejtonte Kufen. Në të dyja këto qeveri, vlerat shpirtërore ishin ato që qeverisnin, d.m.th: u formua një qeveri e drejtësisë dhe udhëheqësi nuk linte mangët as sa masa e milingonave nga zbatimi i ligjit. Qeveria në këto dy periudha kohore ka qenë qeveri e ligjit."

Me të vërtetë, pretendimi për drejtësi dhe përpjekja pas saj me fjalë, është një çështje e lehtë, mirëpo në vendin e punës ajo përballlet me shumë pengesa të ndryshme. Një nga punët më të vështira për çdo qeveri dhe sistem drejtimi, është realizimi i drejtësisë në shoqëri d.m.th. të mbash drejtësi në komunitet. Drejtësia nuk ka të bëjë vetëm me drejtësinë ekonomike. Drejtësia, në të gjitha çështjet e jetës dhe problematikat e saj, është jashtëzakonisht e vështirë, prandaj detyra si shi'itë që jemi, është ta mësojmë mirë këtë mësim, që drejtësia nuk mund të tejkalohet dhe as të bëhet tregti me të, dhe asgjë prej interesave të ndryshme, njësoj qoftë, interesa individuale apo interesa të qeverisë apo shtetit islam, asgjë nuk mund të bëjë tregti me drejtësinë.³¹

³¹ Nga fjalimi i i udhëheqësit në hytбет e ditës së xhuma, në Teheran, më 14.1.2003.

* "Sahifetul Imam", vëll. 4, f. 214: "Ai që ka sadopak njohuri nga logjika e Kur'anit, e kupton se Kur'ani vazhdimisht e ka thirrur të Dërguarin e Allahut në luftimin e pronarëve të kapitaleve. Ata që kanë qenë në Hixhaz, në Taif dhe Mekë, ishin të pasur, njerëz me ndikim, të fuqishëm, mendjemëdhenj dhe autoritarë. Kur'ani i bëri thirrje të Dërguarit të Allahut, t'i luftonte ata që kundërshtonin idenë e bashkimit të njerëzve në një komb, interesat publike të njerëzve, duke i shfrytëzuar mizorisht. Kur'ani ftoi në edukimin e tyre."

Njohuria e tretë: Adhurimi i plotë, pa bërë asnjë ortakëri (shirk)

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) vuri në jetë një sistem, mësimet thelbësore të të cilit ishin një mënyrë shprehjeje e disa gjërave, adhurimi i plotë ndaj Allahut të Madhëruar, pa i bërë ortakëri Atij; d.m.th. adhurimi i Allahut në punën individuale, adhurimi në namaz, i cili obligon njetin e të afërmve në të, adhurimin në ndërtimin e shoqërisë, në sistemin e qeverisë, në sistemin e jetës së njerëzve, si dhe në lidhjet shoqërore midis njerëzve. E gjitha kjo, në thelb, ka adhurimin e Allahut, e cila, gjithashtu, ka detaje dhe një shpjegim të madh.³²

Shikojeni me vëmendje, Allahu e ka vendosur të dashurin e Tij, Profetin e bekuar (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*), në një provim shumë të vështirë. Në atë situatë, gjëja që ekspozohet më tepër në marrjen e goditjeve, ishte nderi dhe krenaria e vetë të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*). Çështja është përmendur në suren “El Ahzab”, ajeti 37: **“Ti (o i Dërguar) i the atij,³³ që Allahu dhe ti vetë i keni bërë mirësi: ‘Mbaje gruan tënde dhe frikësoju Allahut!’**

³² Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në hytben e namazit të xhumasë, në Teheran, më 8.5.1998.

³³ D.m.th. Zejd bin Harithit, djalit të birësuar të Profetit (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*).

Në të vërtetë, ti po fsheh në vetvete atë që Allahu do ta nxjerrë në shesh.”³⁴

Në këtë ngjarje, ishte e mundur që mendimet dhe ndjenjat e njerëzve të lëviznin kundër të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*). Situata ishte e nderë, akuzuese: **“Ti po u frikësohesh njerëzve, kur më e drejtë është t’i frikësohesh Allahut.”³⁵**

Allahu i Lartësuar i flet të Dërguarit të Tij (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) dhe i thotë që të mos u japë rëndësi fjalëve të njërit apo tjetrit, ndërkohë duhet të ruajë dhe të ketë frikë Allahun e Madhëruar. Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) u kujdes që Allahu të ishte në plan të parë. Këtë sprovim të madh e shumë të vështirë e kaloi me sukses.

Këtu citohet ajeti dhe përmendet se si dridhen trupat prej saj: **“...e të cilët kumtuan Shpalljet e Allahut dhe i frikësoheshin Atij e askujt tjetër përveç Tij.”³⁶**

Vërtet, një prej kërkesave apo nevojave të domosdoshme të përcjelljes së mesazheve të Allahut, është që një grupim të qëndrojë përballë dikujt, duke u nisur nga

³⁴ D.m.th. urdhrin që mori nga Zoti për t’u martuar me gruan e Zejdit, pasi ky ta ndante atë, në mënyrë që myslimanët ta dinë se është e lejuar martesë me gruan e divorcuar të bijve të adoptuar.

³⁵ Sure “El Ahzab”, ajeti 37.

³⁶ Sure “El Ahzab”, ajeti 39.

dyshimi apo keqkuptimi, apo propagandat armiqësore dhe tendencioze. Mënyra e përballjes është që të vësh një standard tek individ, që të ketë frikë prej llogarisë ndaj Allahut. Prandaj Allahu i Lartësuar, në fund të ajetit 39 të sures “El Ahzab”, thotë: **“Allahu mjafton si llogaritës.”**

Allahu është Llogaritësi i punëve. Ai do të gjykojë mes nesh, nëse ne kemi ecur siç duhet në rrugën e drejtë apo jo. Nëse nuk gjykon kështu, atëherë individ do të vendosë, nëse do të jetë me Allahun, se Allahu i Lartësuar vetë do të angazhohet me rregullimin e mendimit të njerëzve.

“Ai që rregullon marrëdhënien midis tij dhe Allahut, Allahu do t’ia rregullojë atij situatën me njerëzit.”³⁷

Allahu i Lartësuar do ta garantojë këtë aspekt të çështjes, njësoj sikurse bëri me çështjen e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) dhe e zbuloi të vërtetën.³⁸

Njohuria e katërt: Pasioni dhe dashuria për Allahun

Pasioni dhe dashuria për Allahun dhe dashuria e Allahut për njerëzit është një nga karakteristikat thelbësore

³⁷ “El Hurru El Amilij, Uesailu Shi’iati”, vëll. 15, f. 297.

³⁸ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në takimin me zyrtarët e autoritetit gjyqësor, më 28.6.2003.

të shoqërisë islame. Në Kur'anin Famëlartë thuhet: **“Allahu do të sjellë njerëz, që i do dhe që e duan; të përulur me besimtarët dhe të ashpër me femohuesit; që luftojnë në rrugën e Allahut dhe nuk i tremben qortimit të asnjë qortuesi. Kjo është mirësia e Allahut, të cilën Ai ia jep kujt të dojë. Allahu është Bujar i madh dhe i Gjithëditur.”**³⁹

Dhe: **“Pa dyshim, Allahu i do ata që pendohen fort (për gjynahet) dhe ata që pastrohen.”**⁴⁰

Dhe: **“Thuaju (o i Dërguar): ‘Nëse ju e doni Allahun, atëherë më ndiqni mua, që Allahu do t’ju dojë dhe t’jua falë gjynahet! Allahu është Falës i Madh dhe Mëshirëplotë.’”**⁴¹

Dashuria, dhembshuria, pasioni, dashuria për bashkëshorten, dashuria e fëmijëve, është aq e pëlqyeshme, saqë dëshiron ta puthësh birin tënd. Është e pëlqyeshme të përcjellësh dashuri te biri yt; është mustehab ta duash bashkëshorten dhe të jesh i dashur me të; është mustehab të tregosh dashuri për vëllezërit e tu myslimanë dhe t’i duash ata; është mustehab dashuria për të Dërguarin e Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*) dhe për Ehli Bejtin: **“përveç se dashurisë ndaj të afërmeve.”**⁴²

³⁹ Sure “El Maide”, ajeti 54.

⁴⁰ Sure “El Bekare”, ajeti 222.

⁴¹ Sure “Ali Imran”, ajeti 31.

⁴² Sure “Esh Shura”, ajeti 23; Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në hytben e namazit të xhumasë, në Teheran, më 8.5.1998.

Në kohën e kalifëve të udhëzuar (rashidine), kur myslimanët çliruan zonat perëndimore të botës islame, d.m.th. rajonet e romakëve, Sirisë së sotme, ata i trajtuan jehuditët dhe kristianët në atë mënyrë të denjë, sa që shumë prej tyre e përqafuan Islamin.

Në vendin tonë, në Iran, shumë njerëz u bënë myslimanë pa asnjë rezistencë dhe pa polemikë. Ata u dëshmuan armiqve: bujarinë, mëshirën e myslimanëve dhe kujdesjen ndaj tyre. Ne, gjatë gjithë jetës sonë, nuk kemi parë ditë më të mirë se kjo që jemi sot. Qeveria që udhëhiqte, ishte qeveri kristiane, por u bënte padrejtësi atyre. Kur erdhi Islami, ata e ndien mëshirën islame. Kjo është ajo që i mbetet historisë. Kjo është ajo që përcakton drejtimit e historisë. Kjo është ajo që ruan kujtimet e një mendjeje, një qytetërimi dhe një kulture.⁴³

Njohuria e pestë: Rekomandimi i njerëzve dhe arsimimi i tyre

Në Kur'an thuhet: **“Allahu u ka dhënë besimtarëve dhuratë të madhe, kur u solli një të Dërguar nga gjiri i tyre,**

⁴³ Fragment nga fjalimi udhëheqësit, në takimin me nëpunësit e administratës publike, më 15.10.2001.

i cili ua lexon Shpalljet e Tij, i pastron nga gjynahet dhe u mëson Librin (Kur'anin) e urtësinë (diturinë e thellë fetare), edhe pse më parë, me të vërtetë, ata ishin në rrugë krejt të gabuar.”⁴⁴

“...i pastron nga gjynahet dhe u mëson Librin (Kur'anin) e urtësinë (diturinë e thellë fetare)”, është degëzim i ekzistencës së diturisë për Librin dhe urtësinë e shenjtë të Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të dhe mbi familjen e tij!*).

“...i pastron nga gjynahet...”, është degë e ekzistencës së pastër, që është pastruar në maksimumin e pastërtisë së natyrës njerëzore. Me këtë forcë ai mund të përparojë drejt pastërtisë me anë të diturisë. Kjo është ajo që u mungonte prijësve të feve të ndryshme, si dhe njerëzve të mendimeve filozofike, sociale dhe politike.

Atyre u shkojnë shumë gjëra ndërmend. Në botën e imagjinatës kuptojnë çështje dhe ua hedhin njerëzve. Gjithashtu, prej tyre mësojnë njerëz, ose nuk mësojnë fare dhe kjo gjë është e huaj në biografinë e Profetëve.⁴⁵

Nëse një shoqëri dëshiron udhëzimin dhe gjetjen e moralit të vërtetë islam në të, atëherë s'ka dyshim se ajo

⁴⁴ Sure “Ali Imran”, ajeti 164.

⁴⁵ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në takimin me punonjësit e administratës publike, më 20.12.1995.

shoqëri ka nevojë për këtë rrugë. Ndoshta ajo që nënkuptohet me pastrimin, në disa ajete kur'anore, është vetë kjo çështje, ku fjala "juzek'kihim" përmendet ose para, ose pas fjalës "ue jual'limuhum", d.m.th: pastrimi i njerëzve, filtrimi dhe edukimi i tyre, njësoj si mjeku, i cili nuk i thotë pacientit të tij, bëj kështu, por mos bëj kështu. Përkundrazi, ai e vendos atë në një vend të veçantë, i parashtron dhe i jep atij që i nevojitet dhe e ushqen atë, si dhe ia ndalon gjërat që e dëmtojnë.

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*), gjatë njëzet e tri viteve të profecisë së tij e në veçanti dhjetë vitet e fundit, të cilat i jetoi në Medinë, e cila ishte periudha e qeverisjes së Islamit dhe formimit të qeverisë islame, përpigjej të realizonte këtë situatë dhe të hapte këtë rrugë.⁴⁶

Të gjithë profetët, nga i pari i tyre e deri te vula e profetëve, kanë përcaktuar qëllimin e tyre me arsimim, mësim dhe pastrim prej mëkateve: **"...u mëson Librin (Kur'anin) e urtësinë."**⁴⁷

⁴⁶ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në hytben e namazit të xhumasë, në Teheran, më 20.10.1989.

⁴⁷ Sure "Ali Imran", ajeti 164.

Ata i edukonin njerëzit, njësoj si me edukimin mendor dhe ideologjik, ashtu edhe me atë shpirtëror.⁴⁸

Shikojeni me vëmendje metodikën e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*), në të gjitha çastet e thirrjes së tij në Islam. Që në ditët e para, kur Islami ishte i huaj, i panjohur e deri te kulmi i forcës së Islamit, d.m.th: atë ditë kur ai çliroi Mekën dhe Taifin dhe e shndërroi të gjithë Hixhazin nën kontrollin e tij, ai luftoi i vetëm me botën e injorancës dhe mohimin e Krijuesit, së bashku. Në çdo rast, ai u bënte thirrje njerëzve për pastrimin e vetes të tyre nga gjynahet.⁴⁹

Njohuria e gjashtë: Xihadi dhe sakrifica në rrugë të Allahut

Pa dyshim se rënia shehid dhe sakrifica në rrugë të Allahut, në kohën tonë, ka më tepër vlerë se sa të gjitha kohërat e historisë islame. Rënia shehid dhe sakrifica në rrugë të Allahut, ishte një çështje me peshë shumë të madhe, mirëpo kjo punë e mirë dhe madhështore njëkohësisht, në

⁴⁸ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në hytben e namazit të xhumasë, në Teheran, më 2.1.1998.

⁴⁹ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në takimin me familjarët e shehidëve, më 23.10.1991.

disa situata dhe kohë, është akoma më madhështore, më e rëndësishme dhe më me tepër vlerë.

Po japim një shembull: sakrifica në fillimet e Islamit, kishte rëndësi të dyfishtë. Shkaku i kësaj është se Islami, në atë periudhë kohe, ishte si ai fidani i ri. Nëse nuk do të ekzistonin ato sakrifica, ndoshta armiqtë e Islamit do ta shkullnin me rrënjë atë.

Në kohën e Prijësit të dëshmorëve, Imam Hysejnit (*Paqja qoftë mbi të!*), ato sakrifica dhe rënia dëshmor kishte rëndësi të dyfishtë, sepse rezultatet e përpjekjeve të të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) në ato kohë, po shkonin drejt zhdukjes, kurse sakrifica e Hysejn ibn Aliut dhe shokëve të tij të mëdhenj, e parandaluan këtë çështje.⁵⁰

⁵⁰ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në takimin me familjarët e shehidëve, më 15.11.1989.

KARAKTERSTIKAT E SISTEMIT PROFETIK

Treguesi i parë: Besimi dhe ana shpirtërore

Treguesi i dytë: Paanshmëria dhe drejtësia

Miratimi i ligjit të drejtësisë shoqërore

Qëndrimi i paanshëm, që në çastet e para

Treguesi i tretë: Shkenca dhe njohuria

Treguesi i katërt: Kthjelltësia dhe vëllazëria

Treguesi i pestë: Përmirësimi i mënyrës së sjelljes dhe moralit

Treguesi i gjashtë: Lavdia dhe fuqia

Treguesi i shtatë: Puna, lëvizja dhe zhvillimi i vazhdueshëm

Tërësia e ligjeve dhe e rregullave për botën

Treguesi i parë: Besimi dhe ana shpirtërore

Nxitësi dhe motori i vërtetë, që vë në lëvizje sistemin profetik, është besimi që buronte nga mendjet dhe zemrat e njerëzve. Ky besim vinte në lëvizje duart, organet, fytyrat dhe qenien e tyre në drejtimin e vërtetë e të saktë. Atëherë treguesi i parë është fryrja e frymës së besimit dhe anës shpirtërore, si dhe forcimi i tyre tek individit; shfaqja e besimit dhe e mendimit të vërtetë tek ata. Me këtë qëllim e nisi i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) rrugën e tij në Mekë dhe e ngriti lart flamurin e tij në Medinë, nëpërmjet vënies së autoritetit dhe qeverisjes.⁵¹

Kështu pra, nëse njeriu e gjen rrugën e Allahut dhe mëson se si të bëjë vepra për hir të Allahut, atëherë ai do të shohë se kjo dashuri e madhe për punën, do t'ia lehtësojë shumë atij. Kështu u formua qytetërimi islam. Kur inxhinieri dëshiron ta projektojë ndërtesën, është besimtar; edhe punëtorët, kur duan t'i vendosin tullat njëra mbi tjetrën, janë besimtarë. Edhe udhëheqësi i saj, që qëndron ulur në vendin e kryesisë, është besimtar. Kështu është edhe ushtari i saj që qëndron në pararojë. Roja që ruan rrugët dhe rrugicat e saj ashtu është, po kështu është edhe dijetari i fesë

⁵¹ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në hytben e namazit të xhumasë, në Teheran, më 18.5.2001.

në mësimin e tij; udhëheqësi i tij politik kudo që të ulet dhe dëshiron të marrë një vendim politik është besimtar.

Përmbledhje: Që të gjithë punojnë për Allahun. A është e mundur që një popull dhe një vend i tillë, të tërhiqet nga jeta?! A është e mundur që një popull apo një vend i tillë, të ekspozohet ndaj poshtërimit më të ulët në dynja? A mundet dikush, pas kësaj, që të vazhdojë me kërcënime ndaj një populli të tillë?⁵²

Treguesi i dytë: Paanshmëria dhe drejtësia

Thelbi i punës bazohet mbi drejtësinë, paanësinë dhe dhënien e hakut atij që e meriton ta marrë, pa vërejtur asgjë tjetër.⁵³

Miratimi i ligjit të drejtësisë shoqërore

Synimi tjetër, për të cilin përpiquej i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*), ishte: shprehja e një atmosfere të shëndoshë dhe të pastër për

⁵² Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në takimin me komandantët e Gardës Revolucionare Islamike, më 20.9.1994.

⁵³ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në hytben e namazit të xhumasë, në Teheran, më 18.5.2001.

jetesën e njeriut dhe të jetës njerëzore, d.m.th. një botë, ku nuk ekziston padrejtësia, ku i dobëti nuk bëhet pre i të fortit, ku njerëzit e dobët nuk privohen nga drejtësia dhe nuk gjykon ligji i xhunglës. Kjo botë, është ajo që njihet dhe përkufizohet në terma kur'anore dhe në transmetime si "kist"-*"paanshmëri"* dhe *"adlun"-*"drejtësi"**, d.m.th. siguria e madhe e njerëzimit.

Ai themeloi një shoqëri të kujdesshme dhe të vetëdijshme, që kënaqet maksimalisht nga drejtësia sociale. Dikush mund t'i bëjë padrejtësi dikujt, por ky nuk është një standard i humbjes së drejtësisë së shoqërisë.

Pa dyshim se themeli i ekzistencës së drejtësisë shoqërore dhe mungesa e saj, është miratim i ligjshmërisë së drejtësisë shoqërore. Në shoqërinë ku ligji dhe sundimtari janë që të dy të drejtë, sundimtari është i drejtë dhe nijeti është një nijet i drejtë, atëherë edhe lëvizja e përgjithshme bëhet në drejtim të drejtësisë shoqërore.

Kjo rrugë mund të zgjidhet herët apo vonë, por mund të vazhdojë edhe më gjatë, mirëpo në përfundim do të arrijë drejt drejtësisë shoqërore. Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) e krijoi një situatë të tillë. Ai njeri madhështor nuk mund ta mbulonte apo të pranonte qoftë edhe padrejtësinë më të vogël. Ai na dha një model. Pasi ai kaloi nga kjo botë, pamë gjurmët e atij edukimi në periudha të gjata kohe në shoqëritë islame;

pamë dhe e dëshmuam në kohën e Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut (*Paqja e Zotit qoftë mbi të!*), atë drejtësi absolute, në personin e udhëheqësit të pastër të botës islame.⁵⁴

Qëndrimi i paanshëm, që në çastet e para

Pa dyshim se biografia e Profetëve është një mënyrë shprehje e ecjes në rrugë të drejtë dhe përparimit.

Që në fillim ka ekzistuar vërtetimi i parullave që ata hidhnin dhe praktikonin në veprat e tyre. Ky është bërë realitet në jetën e të Dërguarit tonë (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*), që në çastin e parë. Arsimimi, rekomandimi dhe ajo lëvizje është bërë për të mbajtur drejtësinë e për të qenë i paanshëm.

Kur erdhi koha, e përhapim dhe e shpallim atë në nivel të përgjithshëm ndaj njerëzve dhe lëvizim në drejtim të sistemit shoqëror, i cili ishte vetë sistemi i drejtë dhe e themeloi atë.⁵⁵

⁵⁴ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në takimin me punonjësit e administratës publike, më 20.12.1995.

⁵⁵ I njëjti burim.

Treguesi i tretë: Shkenca dhe njohuria

Thelbi i çdo gjëje në sistemin profetik është dituria, njohuria, ndërgjegjësimi dhe vigjilenca. Askush nuk lëviz nga njëri në krah në tjetrin, sipas rastit dhe t'i shndërrojë njerëzit nëpërmjet ndërgjegjes, njohurisë dhe aftësisë për diagnostikimin e çështjeve, në elemente aktive dhe jo pasive.⁵⁶

Islami e ka bërë obligim për të gjithë të mësuarit e dijes, kështu që çdo individ, pa asnjë përjashtim, duhet të mësojë detyrat e tij fetare dhe çdo gjë që e ndihmon njeriun, për të mësuar detyrat e tij fetare. Është detyrë të mësojë, që t'i paraprijë detyrimit. Po kështu, çdo gjë që i vjen në ndihmë njeriut për aktivitetet e jetës dhe kryerjes së detyrave të rëndësishme. Prandaj s'ka dyshim se të mësuarit do të vazhdojë deri në pafundësi.⁵⁷

Treguesi i katërt: Kthjelltësia dhe vëllazëria

⁵⁶ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në hytben e namazit të xhumasë, në Teheran, më 18.5.2001.

⁵⁷ Nga intervista e udhëheqësit, me revistën "Ajendeh Sazan"- (Ndërtuesit e të ardhmes), më 13.10.1986.

Debatet apo mosmarrëveshjet që burojnë nga motivimet imagjinare, personale dhe oportuniste, janë të urryera në sistemin profetik dhe ato luftohen. Atmosfera është një atmosferë sinqeriteti, vëllazërie dhe harmonie.⁵⁸

Në fillimet e para të Islamit, besimi i ndërsjellë mbizotëronte në atmosferën e shoqërisë islame dhe kjo falë begatisë së mësimëve të të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*).⁵⁹

Treguesi i pestë: Përmirësimi i mënyrës së sjelljes dhe moralit

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) i porosit njerëzit, i edukon ata, i pastron nga papastërtitë, ndyrësitë dhe mbeturinat e moralit. Ai ndërton një njeri me moral të lartë: “...i pastron nga gjynahet dhe u mëson Librin (Kur’anin) e urtësinë...”⁶⁰

Pastrimi është një nga shtyllat kryesore, d.m.th. i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi*

⁵⁸ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në hytben e namazit të xhumasë, në Teheran, më 18.5.2001.

⁵⁹ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në hytben e namazit të xhumasë, në Teheran, më 20.10.1989.

⁶⁰ Sure “Ali Imran”, ajeti 164.

familjen e tij!) e zbaton punën e tij edukative hap pas hapi dhe kështu e ndërton njeriun.⁶¹

Treguesi i gjashtë: Lavdia dhe forca

Lavdi dhe forcë do të thotë se shoqëria dhe sistemi profetik nuk merr goditje dhe nuk ka lidhje fare me pjesën e jashtme, nuk e ndjekin njerëz të fuqishëm, që të marrë vetë vendimet. Ai, nëse e sheh me interes dhe dobinë e saj, përpiket ta realizojë atë dhe të bëjë vepra konkrete.⁶²

Treguesi i shtatë: Puna, lëvizja dhe zhvillimi i vazhdueshëm

Në sistemin profetik, nuk gjen vend ndalimi, por puna, lëvizja dhe zhvillimi i vazhdueshëm. Ekziston një lëvizje, një punë dhe një zhvillim në një mënyrë konstante.

Nuk ndodh që të vijë një kohë e të thuhet se mbaroi çështja, tani të ulemi e të pushojmë pak. Kjo nuk ekziston fare.

⁶¹ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në hytben e namazit të xhumasë, në Teheran, më 18.5.2001.

⁶² I njëjti burim

Sigurisht se kjo punë është puna e kërkuesit të lumturisë dhe gëzimit. Nuk është puna e lodhshme që të orienton drejt përtacisë dhe mërziqjes. Ajo është puna që i jep njeriut kalitjen, forcën dhe entuziazmin.⁶³

Ka edhe një model tjetër, gjithashtu, që është çështja e krijimit të atmosferës së punës dhe seriozitetit në shoqëri, pasi nuk mjafton që i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) t'i urdhërojë njerëzit të punojnë dhe të jenë serioz. Ai gjallëronte metoda të ndryshme të shpirtit të punës dhe të seriozitetit te njerëzit. Ndonjëherë, kur shikonte ndonjë djalë të ri që rrinte pushim dhe nuk punonte, i thoshte: “Vërtet, Allahu nuk e do një djalë të ri që rri kot.”⁶⁴

Allahu nuk është i kënaqur me një të ri në moshë, që e shkatërron jetën e tij dhe e kalon atë pa punuar fare.⁶⁵

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) i kryente punët e tij duke i menaxhuar kohët e punës dhe punonte shumë shpejt dhe nuk lejonte që t'i ikte koha kot, në çfarëdolloj çështje qoftë ajo.⁶⁶

⁶³ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në hytben e namazit të xhumasë, në Teheran, më 18.5.2001.

⁶⁴ Nerakij, “Xhamiu Seaadati”, vëll. 1, f. 151.

⁶⁵ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në hytben e namazit të xhumasë, në Teheran, më 20.10.1989.

⁶⁶ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në hytben e namazit të xhumasë, në Teheran, më 18.5.2001.

Ai ka qeverisur për një periudhë kohe prej dhjetë vitesh. Nëse ne do të dëshironim ta dorëzonim këtë punë të kryer për dhjetë vite, me të gjitha përpjekjet dhe shërbimet në shoqërinë aktive për ta kryer atë, nuk do të mundemi ta kryejmë atë për një periudhë kohe njëqind vjeçare.⁶⁷

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) e filloi punën menjëherë sapo ai hyri në Medinë. Një ndër mrekullitë e jetës së tij fisnike është se ai nuk ka shkuar dëm asnjë çast të vetëm të kohës gjatë atyre dhjetë viteve. Ai nuk hezitoi asnjë çast, që të ndizte dritën e shpirtit, të udhëzimit, të mësimit dhe edukimit. Vigjilenca dhe gjumi i tij, shtëpia dhe xhamia e tij, mejdani i betejës së tij, të ecurit e tij nëpër rrugë dhe shkuarja e tij në treg, marrëdhënia e tij me familjen e vet, kudo që mundej, ishte një leksion. E çuditshme është begatia që ekzistonte në atë moshë fisnike. Një person i vetëm, ia nënshtroi të gjithë historinë mendjes së tij, la gjurmë në të. Ai bëri punë qeveritare, politike dhe publike vetëm dhjetë vite.

O Zot, lum ai për jetën e mbushur me begati e mirësi!⁶⁸

⁶⁷ I njëjtj burim.

⁶⁸ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në hytben e namazit të xhumasë, në Teheran, më 18.5.2001.

Tërësia e ligjeve dhe e rregullave për botën

Nuk ka dyshim se periudha e kohës së Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) në Medine është periudha e themelimit të sistemit islam dhe ndërtimit të modelit dhe shembullit të pushtetit islam për të gjitha kohët e historisë së njerëzimit dhe për të gjitha vendet. Sigurisht ky është një model i përsosur dhe nuk do të ketë shembull të tillë në asnjë periudhë kohe.

Po ta shikojmë me kujdes këtë model, ne mund të njihemi me tregues të shumtë. Këta tregues janë shenja dhe argumente të njerëzimit dhe të myslimanëve, nëpërmjet të cilave mund të qeverisen njerëzit dhe sistemet.

Kjo lindje, në raport me historinë e njerëzimit, është një dhuratë nga mëshira e Allahut. Kur’ani Famëllartë e ka shprehur ekzistencën e bekuar të të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) me **“mëshirë për botët”**.⁶⁹

Kjo mëshirë është e pakufishme dhe përfshin edhe edukimin, edhe pastrimin, edhe arsimimin, edhe udhëzimin e njerëzve në rrugën e drejtë, zhvillimin e tyre në lidhje me standardin e jetës së tyre materiale dhe

⁶⁹ Sure “El Enbija”, ajeti 107.

shpirtërore. Ajo nuk është e veçantë vetëm për njerëzit e asaj periudhe kohe, përkundrazi është e lidhur me të gjitha kohët: **“Ai do ta dërgojë atë edhe tek të tjerë (myslimanë) nga ata, të cilët ende nuk u janë bashkuar. Ai është i Plotfuqishmi dhe i Urti.”**⁷⁰

Rruga për të mbërritur në atë qëllim, është të punuarit me njohuritë hyjnore dhe ligjet e Islamit, që janë përcaktuar për njerëzimin.⁷¹

⁷⁰ Sure “El Xhumu’a”, ajeti 3.

⁷¹ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në takimin me punonjësit e administratës publike, më 20.12.2003.

UDHËHEQJA FETARE E POPULLIT

Udhëheqja fetare e popullit në qeverinë profetike

Sistemi islam është i ndërtuar mbi ligjet kur'anore dhe udhëzimin e Allahut

Votimi i popullit dhe zgjedhja e tij në kuadër të drejtësisë

Modeli qeveritar, bazuar mbi ekuilibrat e jurisprudencës

Filozofia e përgjegjësisë në sistemin islam

Ndryshimi midis pavarësisë popullore perëndimore dhe pavarësisë popullore fetare

E drejta e zgjedhjes së popullit, e ka burimin te ligji i Allahut

Caktimi i drejtuesit të komunitetit, mbi bazën e treguesve hyjnorë

Mbikëqyrja është veçori vetëm e Allahut të Lartësuar

Përmbajtja e vërtetë e Gadijrit

Udhëheqja fetare e popullit në qeverinë profetike

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) jetonte me njerëzit, i pyeste dhe u merrte mendimin atyre. Ai e përhapte dhe e forconte degën e kësaj feje nëpërmjet njerëzve. Ai i dërrmonte armiqtë e Allahut me duart e njerëzve. Kjo është një qeveri e popullit, me kuptimin e plotë të fjalës. Në këtë qeveri të tillë, populli punon, duke u nisur nga dashuria për udhëheqësit e vet.⁷²

Në logjikën e Islamit, menaxhimi i problemeve të njerëzve dhe shoqërisë bëhet nëpërmjet udhëzimit të ndriçimeve kur'anore dhe ligjeve të Allahut. Ligjet kur'anore, qiellore dhe hyjnore, popullit i dha pozitë dhe respekt. Populli është ai që e zgjedh dhe merr në dorë fatin e menaxhimit të vendit. Kjo udhëheqje popullore është një nga llojet më të larta të udhëheqjes, që bota e shikon dhe e dëshmon në ditët e sotme, sepse udhëheqja popullore bëhet brenda kornizës së ligjeve dhe udhëzimit të Allahut. Ajo është zgjedhja e popullit, mirëpo ajo është zgjedhja që ka mundur të gjejë pikëpamjen dhe rrugën e të vërtetave nëpërmjet udhëzimit me ligjet e Allahut, që janë të pastra nga çdo lloj mangësie dhe të metë.

⁷² Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në hytben e namazit të xhumasë, në Teheran, më 1.7.1983.

Në botë ekzistojnë struktura që njihen me emrin demokracia dhe udhëheqja popullore.

Demokracitë perëndimore janë shprehje e interesave të njerëzve pasanikë, kapitalistëve financiarë dhe dëshirat e tyre për të udhëhequr fatin e shoqërisë. Në ato qeveri mendimi i popullit ka vlerë dhe fuqi.

Nëse populli dëshiron diçka që është në kundërshtim me interesat e këtyre kapitalistëve dhe njerëzve me ndikim financiar dhe ekonomik, i lidhur me ndikimin politik, atëherë nuk ka asnjë siguri që këto organizata demokratike të plotësojnë vullnetin dhe dëshirën e popullit. Ekzistojnë struktura me lidhje të forta dhe gjykata drejtuese për të gjitha këto dëshira dhe demokraci. Në ish-republikat socialiste, të cilat e quanin veten e tyre vende demokratike, kjo strukturë ishte partia qeverisëse dhe jashtë kornizës së vullnetit të partisë qeverisëse, politikave dhe motivacionet e saj, mendimi i popullit nuk kishte ndikim dhe nuk merrej parasysh fare.

Sistemi islam është i ndërtuar mbi ligjet kur'anore dhe udhëzimin hyjnor

Sistemi islam dallohet, sepse kornizë janë rregullat dhe ligjet e shenjta hyjnore. Drita e udhëzimit hyjnor përhapet vullshëm në zemrat dhe mendjet e njerëzve, në veprat e tyre, duke i udhëzuar ata në rrugën e drejtë. Çështja e udhëzimit të njerëzve është një nga çështjet më të rëndësishme, prej të cilës janë verbuar sistemet politike në botë, në veçanti, sistemet qeverisëse perëndimore.

Ajo që nënkupton udhëzimi i popullit, është jo vetëm arsimimi dhe edukimi i mirë e i drejtë, por edhe udhëzimi i njerëzve drejt burimeve të pastra. Kjo është një çështje që përmban vullnetin e popullit, të orientuar drejt virtyeteve të moralit dhe i largon prirjet korruptive nga horizonti i zgjedhjes popullore, që ndonjëherë paraqiten nën adresimin e mendimit dhe vullnetit të popullit. Ju e vëreni sot se një nga devijimet më të shëmtuara, ato seksuale dhe të tjera ngjashëm me to, marrin natyrë ligjore në shumë vende demokratike perëndimore, duke i legjitimuar ato. Pastaj promovohet sikur ai është mendimi i popullit. Kjo tregon mungesë të elementit shpirtëror dhe të udhëzimit drejt besimit.

Votimi i popullit dhe zgjedhja e tij në kuadër të drejtësisë

Në sistemin islam, d.m.th. në udhëheqjen fetare të popullit, populli voton, vendos dhe delegon përgjegjësitë e drejtimit të çështjeve të vendit nëpërmjet zgjedhësve të tij. Mirëpo ky vullnet, ky votim dhe kjo zgjedhje, është nën hijen e udhëzimit hyjnor, kurrë nuk ecën jashtë rrugës së drejtësisë dhe kurrë nuk heq dorë nga rruga e drejtë. Çështja thelbësore në udhëheqjen fetare të popullit është se ai është dhuratë e Revolucionit Islamik të popullit iranien, përvojë e re e kohëve moderne. Mirëpo mund të vërehet me kujdes, të përcillet dhe të nxitet nga të gjithë ata që zemrat i kanë të etura për virtytet dhe shoqërinë e pastër njerëzore dhe ankohen prej mbeturinave dhe përhapjes së moralit të shëmtuar të njerëzimit.⁷³

Modeli qeveritar, bazuar mbi ekuilibrat e jurisprudencës

Është gabim i madh që sot, të përzihet udhëheqja fetare e popullit dhe kujdesi për të drejtën e popullit me

⁷³ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në ceremoninë e ekzekutimit të vendimit të presidencës së Republikës Islamike të Iranit, të presidentit Khatemij, më 2.8.2001.

sistemin qeverisës perëndimor. Kjo është udhëheqja e vërtetë popullore dhe rruga e shenjtë.

Antitezat e ekuilibrave të jurisprudencës, që kemi në duart tona, e kanë identifikuar me kualifikime këtë “profesion”, të drejtën e qeverisë dhe të sovranitetit, në mungesë të Imamit të pagabueshëm. Pa këto kualifikime, nuk do të ekzistonte kjo e drejtë dhe ky mandatim, autorizim, sepse origjina është mungesa e autoritetit të njërit ndaj tjetrit.

Kur një njeri dëshiron të ndërhyjë në çështjet e njerëzve të tjerë, këto kualifikime duhet të jenë të pranishme. Diagnostikimi i këtyre kualifikimeve dhe, gjithashtu, zbatimi i një qasje racionale dhe të sigurt, është përgjegjësi e personave që janë të aftë për këtë. Populli, në sistemin e Republikës Islamike, shpall në këtë mënyrë zgjedhjen dhe premtimin e tij.

Pa dyshim se pjesëmarrja e popullit dhe zgjedhja e tij nga njerëzit që i njohin këto kualifikime dhe kanë aftësinë e diagnostikimit të saj te personi dhe ata që janë përgjegjës për mbikëqyrjen dhe kontrollin e ekzistencës dhe mbijetesës së saj dhe ata që e dinë se çfarë ndodh, është një nga profesionet më të larta ekzistuese.⁷⁴

⁷⁴ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në takimin me organet e Këshillit të Udhëheqjes, më 14.3.2002.

Filozofia e përgjegjësisë në sistemin islam

Kur ne themi “populli”, kjo nuk do të thotë që njerëzit të votojnë dhe të zgjedhin një përgjegjës apo një zëvendës; prandaj nuk ka asnjë përgjegjësi për atë popull. Çështja nuk është e tillë, se, nëse dikush dëshiron të bëjë diçka për popullin, me qëllim që ata ta përzgjedhin atë përsëri.

Në Islam dhe në sistemin e Republikës Islamike, filozofia e komisionit për zgjedhjen e zyrtarëve është që ata të punojnë për popullin, të jenë përgjegjës për popullin, të jenë shërbëtorë të tij, i detyrohen atij dhe janë të besuarit e tij. Populli, në sistemin e Republikës Islamike, është boshti për personin që merr përgjegjësitë. Populli të jetë shqetësimi i tij më i madh dhe të mendojë për të në çdo çast: në çështjet e kësaj bote, të problemeve të tyre materiale apo shpirtërore, në vendosjen e drejtësisë midis njerëzve, në ringjalljen e çështjeve njerëzore të njerëzit apo të liria e tyre. Këto janë një pjesë e punëve kryesore të qeverisë.⁷⁵

⁷⁵ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në takimin me disa drejtues, nga sektorë të ndryshëm, për nder të përkujtimit të vdekjes së Imam Khomenit (*Allahu ia shenjtëroftë sekretet*), më 4.6.2001.

Ndryshimi midis pavarësisë popullore perëndimore dhe pavarësisë popullore fetare

Në realitet, Republika Islame është opozitë e të dyja rrymave evropiane, njësoj, qoftë rryma që mbizotëroi në Evropë në shekujt e mesëm dhe para shekullit të tetëmbëdhjetë, qoftë ajo rrymë që u përhap në Evropë si një kundërpërgjigje e të parës.

Ajo që mbizotëronte në Evropë më herët, ishte qeveria e trashëguar e gjenocidit, e mbështetur mbi mashtrimin dhe kontrollin e një pushteti. Një individ apo një grupim ekzekutonte zbatimin e urdhreve në një vend. Islami e kundërshton këtë gjë. Mirëpo çfarë u shfaq pas kësaj, ishte se ata filluan ta shohin të vërtetën, të kufizuar në përzgjedhjen e popullit, mendimin dhe vullnetin e tij. Kjo ekzistonte në kufirin minimal në poezitë dhe në shpalosjen e mendimit dhe të teorive, edhe pse, në realitet, nuk ndodhte kështu. Kjo gjë është në kundërshtim të plotë me Islamin.

E drejta e zgjedhjes së popullit, e ka burimin te ligji hyjnor

Nuk ka dyshim se e drejta e Allahut në Islam nuk është konkurruese e të drejtës së njerëzve dhe as në këmbim të tij.

Të gjitha të drejtat e njerëzve, sidomos e drejta e votës së popullit, e ka burimin prej ligjit hyjnor. Vlera e të gjitha të drejtave të popullit e kanë burimin te sundimi i Allahut dhe në atë që Allahu ka urdhëruar. Prandaj, në Kur'anin Famëlartë, në vendin ku bëhet padrejtësi dhe agresion ndaj të drejtave të njeriut, është përdorur e njëjta shprehje si te çështja e kamatës: **“Nëse nuk e bëni këtë, atëherë ju është shpallur luftë nga Allahu dhe i Dërguari i Tij.”**⁷⁶

Edhe pse kjo vepër është agresion ndaj të drejtave të njeriut, ajo është luftë dhe konflikt me Allahun.

Në një sure tjetër, çështja trajtohet sikur të ishte një çështje korrupsioni dhe fesadi në tokë: **“bëjnë shkatërrime në Tokë”**.⁷⁷

Kjo vepër është luftë kundër Allahut dhe të Dërguarit të Tij: **“luftojnë kundër Allahut dhe të Dërguarit të Tij”**.⁷⁸

⁷⁶ Sure “El Bekare”, ajeti 279.

⁷⁷ Sure “El Maide”, ajeti 33.

⁷⁸ Sure “El Maide”, ajeti 33.

Kjo do të thotë që të hedhësh poshtë të drejtat e njerëzve e t'i kundërshtosh ato, është të kundërshtosh dhe të luftosh Allahun dhe të Dërguarin e Tij, sepse ajo çfarë ka të bëjë me njerëzit në përgjithësi është detyrë nga Allahu. Allahu u ka dhënë njerëzve detyra përgjegjshmëri, sidomos ai që merr përsipër çështjet e njerëzve.

Pra, mund të thuhet se Republika Islamike nuk është një vrimë në ujë, ajo është një realitet, që mbështetet në mendimin e popullit. Allahu na ka urdhëruar t'i kushtojmë rëndësi mendimit të tij, zgjedhjes dhe vullnetit të tij në këtë aspekt.

Problemi ynë nuk është vetëm te sistemi i Republikës Islamike të Iranit, që njerëzit të na keqkuptojnë dhe besimi që kanë te ne, të humbë. Problemi ynë është, gjithashtu, përgjegjësi apo dispozitë e Sheriatit, edhe nëse njerëzit nuk e kuptojnë.

Nëse në një vend ne kryejmë një punë që ka sjellë si rezultat humbjen e të drejtave të njerëzve, edhe pse askush nuk e percepton se i është shkaktuar dëm të drejtave të njeriut, kurse propagandat janë të zhurmshme, atëherë s'ka dyshim se përgjegjësia që na jep Sheriati, do të mbetet përballja jonë.

Në skajet e largëta të trupit të madh të qeverisë, në gjatësinë dhe gjerësinë e saj, ku qeveria nuk është e kufizuar dhe e manifestuar te personi udhëheqës, që të gjithë janë pjesëmarrës në këtë udhëheqje fetare popullore, njësoj, qoftë Presidenti i Republikës apo ndonjëri prej tri fuqive

autoritare, qoftë deputetët e kuvendit, qoftë përgjegjësi, autoritari i çdo lloj aspekti apo fushe, detyra e të gjithëve është ruajtja e të drejtave të njerëzve për hir të Allahut. Këto të dyja janë të barabarta dhe të ndërlidhura me njëra-tjetrën.⁷⁹

Caktimi i drejtuesit të komunitetit, mbi bazën e treguesve hyjnorë

Çështja e Gadijrit dhe caktimi në postin e prijësit të besimtarëve si kujdestar i ymetit islam nga ana e Profetit të bekuar të Islamit, është një ngjarje shumë e madhe, e mbushur me plot kuptime. Në realitet, ajo është ndërhyrje e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) në çështjen e menaxhimit të shoqërisë. Kuptimi i kësaj lëvizjeje, që ndodhi në ditën e tetëmbëdhjetë të muajit Dhul Hixheh, të vitit të dhjetë hixhri, është se Islami i kushton një rëndësi shumë të madhe çështjes së menaxhimit të shoqërisë.

Çështja e menaxhimit, në sistemin islam, në shoqërinë islame, nuk lihet ashtu kot, pa marrë parasysh. Arsyeja është se menaxhimi i një shoqërie është një nga çështjet më ndikuese të shoqërisë. Caktimi i Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*), është

⁷⁹ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në takimin me organet e Këshillit të Ekspertëve të Udhëheqjes, më 14.3.2002.

manifestim i devotshmërisë, i diturisë, i guximit, i sakrificës dhe i drejtësisë midis sahabëve të Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*), i bën më se të qarta dimensionet e këtij menaxhimi. Është e qartë se ajo që ka rëndësi në optikën e Islamit, në pjesën e menaxhimit të shoqërisë, janë pikërisht këto çështje.

Madje edhe ata që e kundërshtuan Prijësin e besimtarëve, Imam Aliun (*Paqja qoftë mbi të!*), nuk kishin asnjë dyshim në diturinë e këtij njeriu gjigant, në vetëkontrollin e tij, në guximin, devotshmërinë dhe sakrificën e tij, për hir të drejtësisë dhe së drejtës.

Kjo ishte pika e ujdisë së myslimanëve, në tërësi dhe i të gjithë atyre që e njihnin Prijësin e besimtarëve, Imam Aliun (*Paqja qoftë mbi të!*). Kjo na nxjerr në pah çdo lloj menaxhimi, qeverisje dhe qeverie që shoqëria islame, nga pikëpamja e Islamit dhe e të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) duhet ta ndjekë si një objektiv i dëshiruar.⁸⁰

Mbikëqyrja është veçori vetëm e Allahut të Lartësuar

Shtet apo përkujdesje, do të thotë pushtet dhe administrim i shoqërisë islame. Sigurisht, kjo është një

⁸⁰ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në takimin me familjet Bakdashit, më 29.1.2005.

çështje e huaj për përkujdesjen, administrimin dhe qeverinë në shoqëri të tjera. Përkujdesja e shoqërisë, në Islam, është veçori e Allahut të Lartësuar: Krijuesit, Ideatorit, të Gjithëditurit të të mirave dhe Zotëruesit të çështjeve të njerëzve, Zotëruesit të të gjitha atomeve të botës së ekzistencës.

Askush nuk ka të drejtë të marrë mbi vete administrimin e çështjeve të njerëzve të tjerë. Vetë kjo ndjenjë, në shoqërinë islame, është diçka e pashembullt. Cili autoritet, cila shpatë e mprehtë, cila pasuri, cila forcë shkencore dhe udhëheqëse, ka të drejtë të vendosë për njerëzit? Islami askujt nuk i jep të drejtën të jetë zotëruesi dhe planifikuesi i fatit të njerëzve të tjerë.

Allahu i Madhëruar e vë në funksion këtë mbikëqyrje prej kanaleve të veçanta, d.m.th: kur zgjidhet me votim udhëheqësi islam dhe mbrojtësi i myslimanëve, qoftë mbi bazën e përcaktimit të personit, sikurse ndodhi, sipas besimit tonë, me Prijësin e besimtarëve, Imam Aliun (*Paqja qoftë mbi të!*) dhe të imamëve, qoftë mbi bazë të standardeve dhe kontrolleve. Kur atij i jepet pushteti që të administrojë çështjet e njerëzve, atëherë edhe kjo mbikëqyrje është mbikëqyrja e Allahut. Kjo e drejtë është e drejta e Allahut dhe ky autoritet dhe qeverisje hyjnore është në mesin e njerëzve. Ai njeri, sido që ka qenë dhe do të jetë, pa mbikëqyrjen hyjnore dhe autoritetin hyjnor, nuk ka asnjë të

drejtë mbi të tjerët. Vetë kjo është një çështje shumë e rëndësishme dhe domethënëse për fatin e shoqërisë islame.

Ndërsa, për sa i përket personit që ngarkohet me këtë mbikëqyrje prej Allahut të Lartësuar, ai e ka për detyrë të realizojë dhe të shpalosë një model të dobët, në dritë dhe në hije të asaj mbikëqyrje hyjnore, ose të themi, le të bëhet pjesë e saj. Karakteristikat e përkujdesit hyjnor janë autoriteti, mençuria, drejtësia, mëshira dhe shembuj të ngjashëm me to. Kështu personi apo aparati drejtues, që merr përsipër menaxhimin e çështjeve të njerëzve, pikësëpari, duhet të jetë manifestues i autoritetit, i drejtësisë, i mëshirës dhe i urtësisë hyjnore.

Kjo karakteristikë është dallimi midis shoqërisë islame dhe gjithë shoqërive të tjera, të cilat menaxhohen me forma të tjera. As injoranca, as epshet psikologjike, pasionet, as tendencat dhe qëndrimet personale, të bazuara në interes personal apo një grupimi, nuk ka asnjë të drejtë që jetën dhe çështjet e njeriut, t'i kenë nën pushtetin apo kontrollin e tyre. Prandaj, drejtësia, dituria, feja dhe mëshira duhet të jenë komanduese dhe udhëheqëse në shoqërinë dhe sistemin islam. Egoizmi nuk duhet të ketë vend. As dëshirat dhe pasionet e tepërta nuk kanë vend në fjalën dhe veprën e çdo

personi. Personaliteti njerëzor nuk duhet të udhëhiqet nga këto gjëra.⁸¹

Përmbajtja e vërtetë e Gadijrit

Ajo që mbetet përherë përgjatë historisë, në formën e një ngjarjeje, që njerëzimi do të mund të marrë leksion prej tij, është përmbajtja që ekziston në ngjarjen e Gadijrit.

Njësoj sikur Allahu të lëshojë një urdhër special dhe në bazë të këtij urdhri, Profeti i nderuar cakton një person si “kujdestar”. Ky kujdestar është personi që i përmbush këto karakteristika. Zbatimi i këtij urdhri shumë të rëndësishëm është jo vetëm një leksion i madh, por edhe pjesë e rëndësishme e Islamit. Rëndësia e përmbajtjes së vërtetë të Gadijrit përmendet në Kur’an: **“O i Dërguar! Trego atë që të është shpallur nga Zoti yt! Në qoftë se nuk e bën këtë, atëherë nuk e ke përcjellë Mesazhin e Tij.”**⁸²

Cila është e vërteta e Gadijrit dhe e vërteta e këtij emërimi që mbart këtë vlerë kaq të rëndësishme?

Për këtë çështje ka shumë dimensione: njëra prej tyre është: Drejtimi i çështjeve të njerëzimit është një çështje

⁸¹ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në një takim me administratën shtetërore, më 11.7.1990.

⁸² Sure “El Maide”, ajeti 67.

hyjnore dhe jo njerëzore dhe ndryshon nga të gjitha çështjet e tjera njerëzore. Nga ky aspekt, një pjesë e njerëzve mund ta shfrytëzojnë çështjen dhe shumë prej konflikteve t'i lidhin me vullnetin e Allahut. Sigurisht ky shfrytëzim mund të bëhet në raport me shumë të vërteta të botës. Një pjesë e ka shfrytëzuar dhe ka përfituar nga vetë çështja e profecisë. Ata pretendonin se ishin profetë dhe i devijuan njerëzit nga rruga e drejtë. Kjo nuk shërben si provë, me qëllim që të tejkalojmë me lehtësi këtë dimension kaq gjigant. Vetë kjo formon një pikë, që menaxhimi i çështjeve të shoqërisë, rruga dhe fati i njerëzimit, si dhe shqetësimi i tij, që të ndërtojë të ardhmen, janë të lidhura me lëndën e vullnetit dhe emërimit hyjnor.⁸³

Në ditën e Gadijrit, kjo lëvizje e madhe, siç përmendet nga transmetimet e marra prej Profetit të bekuar (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*), kishte disa dimensione. Sigurisht, një nga dimensionet e saj ishin virtytet e Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*). Edhe njerëzit e njihnin dhe i kishin parë nga afër këto virtyte tek ai njeri gjigant. I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) i vlerëson shumë këto virtyte. Mbi bazë të atyre vlerave, ai përcaktoi përkujdesjen dhe pushtetin e dimensionit të të Dërguarit. Dihet se ai që të

⁸³ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në takimin me administratën publike, më 26.4.19970.

mundëson të ulesh në fronin e qeverisë së myslimanëve, është ai që i ka ato vlera.

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) nuk e kishte të nevojshme t'i sqaronte virtytet e Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të!*), pasi njerëzit i njihnin ato.

Ky është njëri nga dimensionet e realitetit të Gadijrit, d.m.th. miratimi dhe zbatimi i këtyre virtyteve. Ekzistenca e këtyre virtyteve dhe vlerave i referohet qeverisë dhe moralit të shoqërisë islame. Ky dimension është shumë i rëndësishëm. Është e qartë se qeveria islame, sipas Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) dhe Shpalljes hyjnore, është në ndjekje të vlerave dhe jo në ndjekje të çështjeve të tjera. Vetë kjo është parim islam.⁸⁴

⁸⁴ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në takimin me administratën publike, më 1.7.1991.

LIDHJA MES NJERËZVE DHE UDHËHEQËSVE

Vilajeti është lidhja më e fortë me njerëzit

Vilajeti hyjnor është një lidhje me njerëzit

Lidhja e përhershme e prijësit të besimtarëve me popullin

Qeveria e vërtetë popullore në kohën e ardhjes së imam Mehdiut

Vilajeti është lidhja më e fortë me njerëzit

Vilajeti ka një kuptim të çuditshëm. Rrënja e kuptimit të fjalës *“el vilajetu”* është shprehje e afërsisë së dy gjërave me njëra-tjetrën. Le të supozojmë se dy litarë të trashë janë lidhur me njëri-tjetrin aq fort, saqë është e pamundur të ndahen me lehtësi. Kjo në gjuhën arabe quhet *“el vilajetu”*.

“El vilajetu” do të thotë: lidhje dhe bashkim i dy sendeve, si dhe afrimi i tyre duke u lidhur fort. Të gjitha kuptimet që u përmendën për fjalën *“el vilajetu”*, kanë kuptimin e dashurisë së përhershme si dhe të udhëheqësisë. Në gjuhën arabe ekzistojnë shtatë apo tetë kuptime. Secili prej tyre ekziston në një formë të kësaj afërsie midis dy skajeve të vilajetit.

“El vilajetu”, me kuptimin e dashurisë, sepse ai që dashuron dhe ai që dashurohet, që të dy, kanë lidhje dhe bashkim shpirtëror me njëri-tjetrin (forcojnë njëri-tjetrin) dhe është e pamundur ndarja e tyre.

Islami e përmend qeverinë me fjalën *“el vilajetu”*, kurse personi që qëndron në krye të qeverisë, përkufizohet me emrin *“el vaali”*–*“udhëheqës”*, *“mbrojtës”*, d.m.th. fjalë që rrjedhin nga fjala *“el vilajetu”*. Çfarë do të thotë kjo?

Kjo do të thotë se personi që ulet në krye të pushtetit dhe ata që kanë në dorën e tyre pushtetin e vilajetit, kanë një lidhje të fortë dhe një vazhdimësi që nuk ndërpritet dot. Ky

është kuptimi i kësaj çështjeje. Kjo na interpreton neve filozofinë politike të Islamit për temën e qeverisë, pushtetit.

Cilado qeveri që nuk është e tillë, ajo nuk përkujdeset për popullin, d.m.th. nuk është pushteti për të cilën Islami ka firmosur. Nëse supozojmë se ka persona në krye të pushtetit që s'kanë asnjë lidhje me njerëzit, atëherë ky nuk është vilajet; nëse ka persona që lidhjet e tyre me njerëzit i kanë prej frikës dhe jo prej dashurisë dhe harmonisë, atëherë kjo nuk është vilajet.

Nëse një grup vjen në krye të pushtetit nëpërmjet grushtit të shtetit, atëherë kjo nuk është përkujdesje. Nëse dikush ulet në fronin e pushtetit nëpërmjet formës së trashëgimisë dhe prejardhjes trashëguese dhe atij personi i mungojnë virtytet dhe kushtet e vërteta që kushtëzojnë marrjen e pushtetit, atëherë ajo nuk është përkujdesje. Vilajeti ekziston, kur ekziston lidhja e fortë dhe e afërt e udhëheqësit me njerëzit që ka nën kujdes, që është i dashur.

Kështu ka qenë jeta dhe qeverisja e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*).

“Allahu u ka dhënë besimtarëve dhuratë të madhe, kur u solli një të Dërguar nga gjiri i tyre.”⁸⁵, d.m.th: personi është në mesin e tyre; ai do të marrë përsipër përgjegjësinë

⁸⁵ Sure “Ali Imran”, ajeti 164.

e udhëheqjes dhe të pushtetit. Ky është thelbi i çështjes së pavarësisë islame.⁸⁶

Vilajeti hyjnor është një lidhje me njerëzit

Pra, sikurse thamë, përveç atyre kuptimeve realiste ekzistuese, qeveria islame është një qeveri kujdestare. Kujdestari do të thotë: qeveri që perifrazohet me këtë shprehje të dashur dhe të përshtatshme me personalitetin e njeriut. Meqë për anëtarët e komunitetit dhe anëtarët e njerëzimit, në Islam, ka rëndësi llogaria politike e Islamit, në realitet, populli është gjithçka. Populli kujdeset jo vetëm për personalitetin, vullnetin dhe interesat e tij, por edhe për të gjitha çështjet e tij në sistemin politik të Islamit. Kur plotësohen këto kushte, përkujdesja hyjnore merr kuptimin e saj, nëpërmjet një pjesëmarrje dhe angazhimi të tillë të popullit.

E vërteta e vilajetit hyjnor është lidhja e fortë me popullin.

Lidhja e përhershme e Prijësit të besimtarëve me popullin

⁸⁶ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në takimin me administratën shtetërore, më 26.4.1997.

Në lidhje me këtë çështje, ne shikojmë Prijësin e besimtarëve, Imam Aliun (*Paqja qoftë mbi të!*), i cili është pamja e jashtme e shtetit (udhëheqjes) dhe certifikimi i plotë i mbikëqyrësit, i kujdestarit për njerëzit. Ai, në asnjë moment, nuk është kushtëzuar nga lidhja me njerëzit, komunikimi dhe harmonia me ta, edhe kur, praktikisht, ishte përjashtuar nga vendimmarrja dhe njerëzit u larguan prej qeverisjes së tij. Praktikisht, qeveria u mor prej tij. Bie në sy: përkujdesi, udhëheqja, autoriteti. Sigurisht, përkujdesja shpirtërore ka qenë e pranishme tek imamati shi'it dhe duhet të ekzistojë në të gjitha situatat. Ajo nuk është e lidhur me përkujdesjen e dukshme, sipërfaqësore. Në atë kohë, Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), ishte një prej individëve të popullit dhe pjesë e tij. Ai as nuk u shua, as nuk u vetizolua dhe as nuk u distancua nga njerëzit. Kur ai e mori në dorë qeverisjen, ishte një qeveritar popullor, me plot kuptimin e kësaj fjale.⁸⁷

Qeveria e vërtetë popullore në kohën e ardhjes së imam Mehdiut

⁸⁷ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në takimin me nëpunësit e administratës, më 26.4.1997.

Mësimi tjetër i rëndësishëm që përfitohet, është se qeveria e Mehdiut të premtuar, që do të vijë, është qeveria popullore, me plot kuptimin e saj të fjalës.

Çfarë do të thotë fjala “popullor”? Kjo fjalë do të thotë: i mbështetur në besimin e popullit, vullnetit dhe mbështetësve të tij. Imami i kohës nuk do ta mbushë i vetëm botën me drejtësi. Imami i kohës mbështetet te të gjithë individët e popullit, për të ndërtuar ndërtesën e drejtësisë hyjnore në çdo cep të botës, duke formuar një qeveri popullore njëqind për qind. Mirëpo kjo qeveri popullore ka ndryshim nga të gjitha qeveritë e sotme popullore, edhe pse pretendojnë se janë popullore dhe demokratike, ashtu si është ndryshe qielli me tokën.

Ajo që sot në botë, emërtohet si demokraci dhe udhëheqje popullore, është diktaturë e vjetër, por që ka veshur rroba të reja, d.m.th: diktatura e partive. Edhe pse ekziston konkurrenca, kjo konkurrencë midis partive dhe popullit, në këtë aspekt është e prishur, e shkatërruar. Udhëheqja popullore në periudhën kohore të Imamit të kohës, Imam Mehdiut, d.m.th. udhëheqja fetare popullore, është e ndryshme nga metodika dhe programet e sotme qeverisëse.⁸⁹

89 Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në takimin me përfaqësues nga segmente të ndryshme të shoqërisë, më 20.6.2002.

FAKTORËT E ZHVILLIMIT TË QYTETËRIMIT ISLAM

*Sekreti i zhvillimit të Islamit në periudhën e injorancës
(xhahilijetit)*

Besimi me zemër është faktori i zhvillimit të myslimanëve

Mos dhënia përparësi vetes dhe interesave personale

Qëllimet kryesore janë: shpirti dhe Islami

Qëndrueshmëria dhe përballja e sinqertë

Të bësh durim ndaj vështirësive rraskapitëse

Sekreti i vazhdimit të lëvizjes islame

Uniteti i fjalës

Të veprosh për të kundërshtuar, është gabim

Zemrat janë drejtuar kah uniteti

Vuajtjet e botës islame

Si u gjet qytetërimi islam?

Çlirimi nuk bëhet me shpatë, por me “armën” e mëshirës

Sekreti i zhvillimit të Islamit në periudhën e injorancës (xhahilijetit)

Në vitet e kaluara, kur ngrihej çështja e dërgimit të Profetit dhe kujtimet këtij dërgimi madhështor, populli ynë, lëvizjen, rilindjen e përgjithshme të tij dhe ngritjen në revolucion, e konsideronte vazhdimësi e dërgimit madhështor profetik. Më e pakta gjë që mund të pyetej dhe që vinte në mendjet e individëve, njerëzit e virtytshëm dhe të mendimit, ishte: Cili ishte sekreti i zhvillimit të Islamit në ditët e çuditshme të dijes dhe përhapjes së injorancës, e cila mbushi të gjithë botën? Cili faktor fuqizoi Islamin? Si u themelua qytetërimi islam, deri në periudhën e degjenerimit të pushtetit politik të Islamit? Si mundi që kultura e botës, e vuri nën ndikimin e saj e njëkohësisht zhvilloi shkencën dhe promovoi kulturën islame? Këto janë përvoja shumë të çuditshme në histori. Po cili është shkaku i kësaj? Kjo është një temë studimi shumë e gjatë, që shkrimtarët dhe hetuesit, edhe pse kanë punuar shumë me këtë temë, përsëri ka nevojë të punohet për këtë gjë.⁸⁹

⁸⁹ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në takimin me nëpunësit e administratës, më 6.11.1999.

Besimi me zemër është faktori i zhvillimit të myslimanëve

Pa dyshim se një nga elementet e zhvillimit të Islamit, ka qenë mbështetja e fortë tek Allahu i Lartësuar dhe zbatimi i ligjeve hyjnore: **“I Dërguari beson në atë (Kur’anin) që i është shpallur nga Zoti i tij e po ashtu dhe besimtarët: të gjithë besojnë në Allahun, engjëjt e Tij, librat e Tij dhe të Dërguarit e Tij.”**⁹⁰

Vetë i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) dhe besimtarët e parë të Islamit, e besuan sinqerisht mesazhin e Islamit. Ata besuan thellësitë e sloganeve të Islamit dhe të vërtetat të tij, si dhe shpëtimin e njerëzimit nga thellësitë e errëta të padijes. Ky besim është faktori më i rëndësishëm.^{91*}

⁹⁰ Sure “El Bekare”, ajeti 285.

^{91*} “Sahifetul Imam”, vëll. 8, f. 102: “Mos kini frikë kur thonë: ‘Ata u kthyen pas, mohuan. Ata janë prej atyre që i tërheqin njerëzit drejt epokës së gurit. Pendohuni!’ Nuk jemi ne ata që duam t’i tërheqim njerëzit drejt qytetërimit, me kuptimin e vërtetë të tij. Të mos ju frikësojë juve fjala që thonë. Asnjë forcë nuk mund t’i bëjë ballë Islamit, që nëpërmjet një grushti të vogël njerëzish, ka mposhtur një grup shumë të madh dhe fuqi të mëdha.”

“Sahifetul Imam”, vëll. 10, f. 285-286: “Lufta në rrugë të Allahut të Lartësuar ka probleme. Problemet më të mëdha kanë qenë problemet që ka hasur i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) dhe myslimanët e parë të Islamit. Ata, me forcën e besimit në zemër, arritën, që në më pak se një gjysmë shekulli, të themelonin

Myslimanët e parë të Islamit, me forcën e besimit, çliruan Iranin dhe vendet romake, madje edhe popujt që i sulmonin muslimanët, thjesht sapo i shihnin, ky besim hynte në zemrën e tyre. Shpata përdorej për të larguar mënjane pengesat dhe udhëheqësit autoritarë nga rruga. Në të kundërt, shumica e njerëzve, në çdo vend qofshin, e kanë sfiduar atë. Dy perandoritë më të mëdha të asaj kohe, romake dhe perse, u bënë pjesë e sistemit dhe e shtetit islam.⁹²

Mosdhënia përparësi vetes dhe interesave personale

Faktori tjetër që ndodhet në krye të kësaj lëvizje, është se ata besimtarë nuk i jepnin fare rëndësi vetes të tyre, duke iu referuar personit në lidhje me përfitimet dhe interesat materiale. Ky është një faktor shumë i rëndësishëm. Të gjitha këto pohime dhe rekomandime i shikojmë në hadithet e Profetit të bekuar (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*), në transmetimet e librit “Nehxhul Belaga” dhe të imamëve të mëdhenj. Asketizmit në dynja dhe mosdhënia rëndësi bukurive të saj

dhe të ndërtonin Islamin, përafërsisht, në atë pjesë të tokës, që në atë kohë ishte e banuar.

⁹² Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në hytben e namazit të xhumasë, në Teheran, më 18.5.2001.

nga vetë personi, është faktor që ka ndikuar shumë në zemrën e tyre.

Sigurisht, armiqtë e Islamit dhe ata të devijuarit në mendime, kanë menduar se Islami, duke bërë thirrje në asketizëm, ka bërë thirrje për braktisjen e kësaj dynjaje, me kuptimin e pamjes së jashtme të botës së ekzistencës dhe dukurive të jetës. Ndërkohë që nuk ka qenë kjo çështja. Përkundrazi, ajo që nënkuptohej, ishte bota e keqe dhe bota e përbuzur dhe ç'ka nënkupton ajo, unë dhe ju, si një objektiv i vetes sonë, i interesave tona materiale dhe përpjekja jonë për të ndjekur pas këtë botë. Kjo është gjëja që të çon drejt shkatërrimit, belasë, si dhe është thelbi i të gjitha fatkeqësive.⁹³

Kreu i qëllimet është interesi personal apo Islami?

Ajo që ne presim, është që udhëheqësit e botës islame, qofshin këta bashkëkohorë apo fetarë, të mos vënë në plan të parë dhe të mos i japin shumë rëndësi interesave të tyre personale.

Ajo që ne presim nga popujt tanë dhe udhëheqësit e kohës sonë, nuk është ajo që ndodhi në zemrat tona përmes

⁹³ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në takimin me administratën publike, më 6.11.1999.

sjelljes së të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*). Jo, pasi ka një dallim shumë të madh.

Ajo që ne presim nga vetja jonë, sikurse e presim, gjithashtu, edhe nga të tjerët në botën islame, është që të mos vendosin në krye të qëllimeve, interesat e tyre. Fjalën “unë” të mos e vendosin para gjithë çështjeve të tjera, por në pararojë të vënë Islamit dhe realizimin e forcës së Islamit, efikasitetin, sublimimin dhe përsosjen e tij. Nëse realizohet kjo, atëherë, pa asnjë dyshim do të rikthehet një pjesë e madhe e fuqisë së brendshme dhe fuqisë së Islamit tek ymeti islam. Këtu, çështja më e rëndësishme ishte çështja e ekzistencës së imamit tonë të madh. Ai personalitet mori përsipër barrën e përgjegjësisë së kujdesit ndaj popullit, besimit të tij, bindjes së tij, dashurisë dhe lëvizjes së tij madhështore dhe përcjelljes së çështjeve. Ai hoqi dorë nga vetja e tij, duke u bërë një asket. Angazhimin dhe përgjegjësinë e bëri boshtin e veprimeve dhe të lëvizjeve të tij, prandaj pati shumë sukses.⁹⁴

⁹⁴ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në takimin me administratën shtetërore, më 6.11.1999.

Qëndrueshmëria dhe përballja e sinqertë

Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), sikurse përmendet edhe në librin “Nehxhul Belaga”, ka thënë: “Me të Dërguarin e Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) kemi luftuar kundër baballarëve, bijve, vëllezërve dhe farefisit të tyre. Kjo vetëm ka forcuar besimin tonë, dëgjueshmërinë, ndjekjen e rrugës së drejtë, përjetimin e dhimbjeve.”⁹⁵

“Kur Allahu vërejti vendosmërinë tonë, armikut i dërgoi poshtërimin, kurse neve ndihmën e Tij.”⁹⁶

“Sikur të mos ndodhte kështu, asnjë shtyllë e fesë nuk do të mund të ngrihej, njëkohësisht, nuk do të lulëzonte druri i besimit.”⁹⁷

Të gjitha këto zhvillime janë arritur për shkak të sinqeritetit dhe besimit të myslimanëve dhe themelimit të shoqërisë islame. Qytetërimi islam dhe lëvizja e sotme madhështore historike është e tillë. Gjithashtu, detyra e popullit tonë dhe e myslimanëve në çdo vend të botës është

⁹⁵ “Nehxhul Belaga”, Hytbeja 55.

⁹⁶ I njëjti burim.

⁹⁷ I njëjti burim.

që të flasin në emër të Islamit anembanë botës, që ta mësojnë mirë këtë mësim prej Ali ibn Ebu Talibit.⁹⁸

Të bësh durim ndaj vështirësive rraskapitëse

Myslimanët kanë duruar dhe kanë bartur shumë probleme në kohën e të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*). Ju keni mësuar për fatin e banorëve të Safas dhe keni dëgjuar se ata i vidhnin rrobat njëri-tjetrit. Ata shkonin në luftë dhe vritnin njëri-tjetrin, vetëm për një kokërr hurmë. Personi i parë e thithte kokrrën e hurmës për t'u forcuar nga sheqeri i asaj kokrre, pastaj, ai e nxirrte nga goja e tij për t'ia dhënë një tjetri për ta thithur nga ana tjetër, për t'u forcuar edhe ai. Edhe pas kësaj, ia jepte një personi të tretë, për ta gëlltitur.

Kështu jetonin ata. Kështu i kalonin vështirësitë. Në këtë mënyrë e vuanin privimin. Në fillim të problemit, presioni dhe trysnia atyre u vinte nga të gjitha drejtimet.

⁹⁸ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në hytben e namazit të xhumasë, në Teheran, më 5.4.1991.

* "Sahifetul Imam", vëll 1, f. 21: "Qëndrimi në këmbë për Allahun, bëri të mundur që Vula e profetëve, Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*), jo vetëm të triumfojë i vetëm ndaj zakoneve, dokeve dhe besimeve të injorancës, por edhe të largojë adhurimin e putave dhe në vend të tyre të vendosë Njësimin dhe devotshmërinë. Ai e solli atë të shenjtë në vendin e quajtur "kabe kausejni eu edna"- "afër sa dy harqe ose më afër".

Fillimi i problemit nuk ka qenë pesë apo gjashtë muajt e parë apo viti i parë. Pesë apo gjashtë muajt e jetës së çdo udhëtimi, konsiderohet fillimi i problemit dhe jo jeta e një populli dhe as jeta e një historie të re. Vërtet dhjetë apo njëzet vitet e një populli llogariten vetëm si disa ditë.

Në kohën e të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*), njerëzit kanë hasur shumë vështirësi, por, pasi ai i forcoi themelet, të gjitha këto përlëshje, sakrifica, ky sinqeritet dhe “mbarështimet” çuan në vazhdimin e kësaj lëvizje. Migrimi i të Dërguari të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) u bë sjellje e myslimanëve në më shumë se gjysmën e botës. Kështu ka qenë situata në atë kohë dhe kështu vazhdon të jetë edhe në ditët e sotme.⁹⁹

Sekreti i vazhdimit të lëvizjes islame

Kjo lëvizje është e vazhdueshme. Shikoni, pasi kanë kaluar katërmbëdhjetë shekuj, Islami akoma vazhdon të ndriçojë. Të gjitha këto sillen rrotull në orbitën e asaj

⁹⁹ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në takimin me familjarët e shehidëve, më 15.11.1989.

ekzistence madhështore dhe atyre betejave. Ato e bënë këtë lëvizje të vazhdueshme.¹⁰⁰

Uniteti i fjalës

Qëllimi i kësaj kumtese nuk është mburrja, por përkujtimi i të vërtetës, që ka sjellë qytetërimi islam: Islami dhe dijet e tij të qarta për jetën, vazhdon të jetë akoma në duart tona dhe na paralajmëron: **“O ju që keni besuar! Bindjuni Allahut dhe të Dërguarit kur ju thërret drejt asaj që ju jep jetë.”**¹⁰¹ **“Dhe ta dini se Allahu ndërhyr midis njeriut dhe zemrës së tij dhe se tek Ai do të mbledheni të gjithë!”**¹⁰²

Islami ka vërtetuar se ai ka të drejtën për t’i ofruar ymetit islam zhvillimin kulturor e shkencor, fuqinë dhe autoritetin politik. Kushti i realizimit të këtij qëllimi të madh, është besimi, xhihadi, shmangia e përçarjes. Kur’ani na përgëzon dhe na thotë: **“Mos u ligështoni dhe mos u pikëlloni, sepse ju, gjithsesi jeni më të lartët, nëse jeni besimtarë të vërtetë.”**¹⁰³

¹⁰⁰ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në takimin me administratën shtetërore, më 6.11.1999.

¹⁰¹ D.m.th. drejt besimit.

¹⁰² Sure “El Enfal”, ajeti 24.

¹⁰³ Sure “Ali Imran”, ajeti 139.

Dhe: **“Ata që luftojnë për çështjen Tonë, sigurisht, Ne do t’i udhëzojmë drejt udhëve Tona. Vërtet, Allahu është me punëmirët!”**¹⁰⁴

Pa dyshim se ne jemi seriozë në lidhje me çështjen e unitetit, sikurse e kemi përkufizuar kuptimin e unifikimit të myslimanëve.

Unifikim i myslimanëve nuk do të thotë braktisje dhe përçarje e myslimanëve ndaj ideve të tyre teologjike dhe doktrinare, përkundrazi s’ka dyshim se uniteti i myslimanëve është në dy kuptime të tjera, ku duhet të vërtetohen që të dyja.

E para: Medh’hebet e ndryshme islame (shi’itët dhe synitë, ku secili ka nëngrupime të ndryshme teologjike dhe doktrinare) të jenë të unifikuara, bashkëpunuese dhe në frymën e mirëkuptimit në përballjen me armiqtë e Islamit.

E dyta: Grupimet e ndryshme islame të përpiqen të afrohen me njëri-tjetrin dhe të mirëkuptohen mes tyre, si

¹⁰⁴ Sure “El Ankebut”, ajeti 69; Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në ceremoninë e hapjes së takimit të tetë të udhëheqësve të shteteve islame, më 9.12.1997.

* “Sahifetul Imam”, vëll. 7, f. 66: “Sekreti i triumfit të myslimanëve, në fillimet e Islamit, ka qenë uniteti i fjalës dhe i forcës së besimit. Forca e besimit ndikoi që një ushtri e vogël, e pafuqishme, të mposhtë perandoritë e mëdha të botës dhe një grup i vogël, prej tridhjetë individësh, nën komandën e Khalid ibn Velidit, të mposhtin ushtrinë e Romës, të përgatitur e të përbërë prej gjashtëdhjetë mijë njerëzish.”

dhe të bëjnë një krahasim ndërmjet medh'hebeve të ndryshme të jurisprudencës islame dhe të pajtohen mes tyre. Ka shumë fetva të dijetarëve dhe fukahave (dijetarë të jurisprudencës) që, nëse i vihet pika e studimit të jurisprudencës dhe asaj shkencore, nëpërmjet një ndryshimi të lehtë mund të bëhet përafrimi i fetvave të dy medh'hebeve (shi'it dhe syni).¹⁰⁵

Të veprosh për të kundërshtuar, është gabim

Me të vërtetë, situata e myslimanëve, për sa i përket antagonizmit dhe konflikteve, realisht është për të ardhur keq. Pa dyshim se shumica e forcave shkencore dhe intelektuale të myslimanëve janë shpërdoruar përgjatë historisë, duke pasur konflikte me njëri-tjetrin. Askush të mos dyshojë në këtë çështje. Nëse dikush e harxhon mundin dhe djersën e vet për të vërtetuar medh'hebin e tij, atëherë unë nuk e kundërshtoj fare atë person. Çdo shi'it dhe syni, dhe cilido besimtar i çdo grupimi, besimi apo rryme, ka të gjithë të drejtën e tij të vërtetojë rrugën e vet. Ky është tjetër hulumtim. Ne nuk e kundërshtojmë këtë gjë. Ajo që ne e kundërshtojmë dhe e refuzojmë, është përpjekja për të

¹⁰⁵ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në takimin me pjesëmarrësit e Konferencës së Unitetit Islam, më 16.10.1989.

luftuar me palën përballë, përbuzja dhe mohimi i ekzistencës së saj. Kjo gjë është shumë e gabuar.¹⁰⁶

Zemrat janë drejtuar kah uniteti

Shikojini disa shtete islame, që pretendojnë se ndjekin Islamin dhe e promovojnë atë. Një pjesë e tyre janë pa turp, sa e konsiderojnë dhe e reklamojnë veten e tyre sikur janë themeluesit e Islamit, sahabët dhe promovuesit e tij, ndërkohë që ata janë burimi i korrupsionit dhe i degjenerimit; janë burimi i të ndaluarave dhe i mëkateve të mëdha. Kjo është ajo që shikojnë popujt e botës.

Largpamësit myslimanë i kuptojnë fare mirë këto çështje dhe e dinë mirë se në këtë situatë, nëse nuk ngrihet lart dija e unitetit islam, zemrat e myslimanëve do të drejtohen drejt vendit që sundon realisht Islami, ku stafi dhe standardet janë tërhequr nga Islami, personeli qeveritar është udhëheqës dhe përgjegjës për popullin. Këtë panoramë e shpjegon shumë mirë ajeti kur'anor: **“(Allahu i ndihmon edhe) ata, të cilëve, nëse u japim pushtet në tokë, kryejnë faljet, japin zekatin, urdhërojnë kryerjen e**

¹⁰⁶ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në takimin me pjesëmarrësit në konferencën e afrimitetit ndërmjet medh'hebeve islame, më 23.9.1991.

veprave të mira dhe pengojnë atë që është e mbrapshtë. Tek Allahu është fundi i të gjitha çështjeve.”¹⁰⁷

Vërtetet popujt nëpër botë e shikojnë këtë gjë dhe zemrat e tyre janë drejtuar kah Irani islam.¹⁰⁸

Vuajtjet e botës islame

Bota islame gëzon fuqi të pallogaritshme në të gjitha fushat e jetës njerëzore, por në të njëjtën kohë ajo ankohet dhe vuan nga shumë probleme. S’ka dyshim se nevoja për dije, seriozitet dhe bashkëpunim, për të arritur një jetë më të mirë në qytetërimin islam dhe nevoja për unitet dhe ndërgjegjësim në rrugën e përballjes së rreziqeve dhe armiqësive, nevoja për sinqeritet dhe besnikëri, për të tërhequr mëshirën dhe begatitë hyjnore, janë të qarta, d.m.th. të gjitha këto nevoja, janë burim pranimi për të gjithë.¹⁰⁹

¹⁰⁷ Sure “El Haxhxh”, ajeti 41.

¹⁰⁸ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në takimin me pjesëmarrësit e Konferencës së Unionit Islamik, më 16.10.1989.

¹⁰⁹ Mesazh falënderimi nga udhëheqësi, me rastin e mbajtjes së tryezës së tetë të Organizatës së Konferencës Islamike, më 12.12.1997.

Si u gjet qytetërimi islam?

Pyetja kryesore që bëhet tani, është: Si u gjet qytetërimi islam?

Një pjesë ka thënë se ky qytetërim e ka prejardhjen nga qytetërimi persian, kurse një pjesë tjetër ka hedhur mendimin se ajo ka ardhur prej qytetërimit romak. Këto janë mendime injorante dhe foshnjore.

Le të supozojmë se dhjetëra libra u futën në qytetërimin islam nga qytetërimi të tjera. Po a mund të ndërtohet një qytetërim me dhjetëra libra? Po a mund të lindë qytetërimi islam nëpërmjet përkthimit të gjurmëve greke, romake dhe indiane? Kurrsesi jo, sepse esenca e qytetërimit islam ka lindur vetvetiu. Sigurisht nga qytetërimi i gjallë përfitojnë edhe të tjerët.

Pyetja që bëhet, është: Prej nga erdhi kjo botë e banueshme, ky përdorim i dijes, ky zbulim i të vërtetave i shkallës së parë në botën e ekzistencës; vetë bota e lëndës, e cila është vërtetuar nga dora e myslimanëve? Prej nga erdhi kjo zgjuarsia, ky intelekt, aktivitetet e mëdha shkencore, themelimi i universiteteve gjigante të standardeve botërore të asaj kohe, si dhe formimi i dhjetëra shteteve të pasura e të fuqishme në atë periudhë kohe?

Ajo udhëheqje politike ka qenë e pashembullt përgjatë gjithë historisë.

Vërtet ju, përgjatë historisë nuk do të gjeni pushtet tjetër, përveç pushtetit politik islam, nga zemra e Evropës deri në thellësi të Gadishullit Indian, që është bërë një shtet i vetëm dhe qeverisja e tij është një pushtet i përhershëm.

Periudha e kohës së shekujve të mesëm në Evropë ka qenë një periudhë e injorancës dhe e mjerimit. Evropianët i quajnë shekujt e mesëm si “periudha e errët”. Këta shekuj të mesëm janë po ato periudha kohe, ku Evropa ka qenë në kohë të errëta. Ishte një periudhë kohe, ku shkëlqente dija dhe shkenca në vendet islame dhe njëra prej tyre ishte Irani. Shumë studime janë bërë dhe shumë libra janë botuar për shekullin e katërmëdhjetë të hixhretit, shekulli i shkëlqimit të dijes. Çfarë e solli në jetë një pushtet politik të tillë, një forcë të tillë diturie e shkencore, një botë të organizuar dhe të sistemuar si kjo, një përdorim i tillë për të gjitha forcat e gjalla njerëzore, konstruktive dhe frymëzues? Pa dyshim se këto çështje erdhën si rezultat i mësimave dhe i njohurive të Islamit. E thjeshtë, kjo është çështja.¹¹⁰

¹¹⁰ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në takimin me Gardën Revolucionare Islamike, më 20.9.1984.

Çlirimi nuk bëhet me shpatë, por me “armën” e mëshirës


Luftërat përfundojnë, mirëpo përvojat mbesin akoma. Te ngjarjet e mëdha ka mësim për popujt. Ky mësim do të mbetet përgjithmonë në shpirtin e njerëzimit, ku një qytetërim, me gjithë këtë shkëlqim dhe me gjithë këtë pretendim, del i dështuar nga dritarja e provimit. Punët që ata ushtrojnë, janë: ndezja e luftërave, e padrejtësisë dhe sundimi i saj, mendjemadhësia, dalldia, sjellje të pahijshme. Nisja e luftërave është kërcënim për paqen, vrasja e njerëzve të pafajshëm, shpenzimi i tepërt i pasurisë publike në ndezjen e zjarrit të luftërave dhe kjo nën pretendime të rreme.

Këto janë përvoja të një qytetërimi. Krahasojeni këtë me qytetërimin islam.

Në kohën e kalifëve të udhëzuar, kur myslimanët çliruan shumë rajone perëndimore të botës islame, d.m.th: rajone të vendeve të Romës, Siria e sotme, ata i trajtuan çifutët dhe të krishterët në ato zona me një mënyrë që rezultoi në fund me përqafimin e Islamit nga një pjesë e madhe e tyre.

Në vendin tonë, në Iran, shumë njerëz u bënë myslimanë pa bërë asnjë lloj rezistence. E gjitha kjo, sepse ata e panë me sytë e tyre bujarinë e myslimanëve, mëshirën e tyre dhe se si sillen me armiqtë, prandaj erdhën dhe e përqaftuan Islamin.¹¹¹

¹¹¹ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në takimin me punonjësit e administratës publike, më 15.10.2001.



EPOKAT E QYTETËRIMIT ISLAM

Bota islame, nga Andaluzia deri në Kinë

Faktori i triumfit të revolucionit të Islamit të parë

Përfitimi prej mësimëve hyjnore

Bota islame, nga Andaluzia deri në Kinë

Produkti i parë politik njerëzor i Islamit ishte ymeti islam, i cili nisi prej Medines së Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*), duke ecur përpara, me hapa gjigante drejt zhvillimit sasior dhe cilësor, me një mënyrë të paimagjinueshme dhe mitologjike.

Nuk kaloi as një gjysmë shekulli nga lindja e kësaj dukurie të bekuar, kur ajo dha ndikimin në afërsisht gjysmën e zonës së tri qytetërimeve të mëdha të vjetra, fqinje të tyre, d.m.th: Iranit, vendet Romake dhe Egjiptit. Pas një shekulli, mundi të formonte një qytetërim të ndritshëm, një shtet të fortë e të fuqishëm në mesin e botës, duke arritur deri në Lindje, afër murit të madh kinez. Në anën tjetër, deri në brigjet e Oqeanit Atlantik. Në veri, deri në fund të Siberisë dhe në jug, deri në jug të brigjeve të Oqeanit Indian. Me të vërtetë dy shekujt, të tretë dhe të katërt hixhri dhe ato pas tyre, janë të zbukuruar me një qytetërim vezullues, begatitë shkencore dhe kulturore të të cilave vazhdojnë akoma edhe sot, pas njëmijë vitesh dhe shihen qartë në qytetërimin e kohës moderne.

Historianët perëndimorë, kur flasin për historinë e shkencës dhe të qytetërimit, këtë studim gjigant e të pashembullt më parë, për sa i përket diturisë, kulturës dhe

qytetërimit, e vendosin në një lëvizje të vetme, në kutinë e tërësisë dhe të neglizhencës dhe arrijnë menjëherë në rrugën e dijes prej Greqisë dhe Romës antike, me epokën e Rilindjes. E vërteta është se shekujt e mesëm, për Perëndimin dhe Evropën, përfaqësonin vetëm periudhën e errët, të injorancës dhe të frikës.

Për sa i përket botës islame, të zgjeruar dhe të shtrirë disa herë më shumë në sipërfaqe se sipërfaqja e Evropës, d.m.th: nga Andaluzia e deri në Kinë, konsiderohej si periudha e ndritur shkencore e Rilindjes dhe e zhvillimit të Islamit.¹¹²

Kjo është e vërtetë, sepse gjithçka që Evropa ka sot, e ka humbur shkëlqimin e saj përpara qytetërimit islam. Kjo vazhdoi deri në shekullin e katërt, të pestë dhe të gjashtë të hixhretit.

Sigurisht, pas kësaj, Islami bëri hapa prapa për vite me radhë, deri sa erdhi epoka e Rilindjes.¹¹³

¹¹² Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në ceremoninë e hapjes së Samitit të tetë të udhëheqësve të shteteve islame, më 9.12.1997.

* “Sahifetul Imam”, vëll. 8, f. 516: “Ata që duan ta turpërojnë Islamin, thonë se Islami është në konflikt me të gjitha qytetërimet. Kjo është analogji. Islami nuk lufton asnjë civilizim. Islami themeloi një qytetërim dhe ky qytetërim u orientua drejt gjashtëqind apo shtatëqind zonave e rajoneve të banuara.

¹¹³ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në takimin me udhëheqësit e Gardës Revolucionare Islamike, më 20.9.1994.

Faktori i triumfit të revolucionit të Islamit të parë

Cili ishte faktori që ndikoi në triumfin e revolucionit të Islamit të parë? Kjo është gjëja që ne mund ta kuptojmë qartë. A triumfoi, sepse ishte i lidhur me Allahun? A triumfoi feja islame ndaj armiqve dhe kundërshtarëve të saj, si dhe ndaj atyre fuqive të mëdha që ishin në konflikt me të në atë periudhë kohe, sepse ishte i vërtetë?

Për t'iu përgjigjur pyetjeve, ne themi: Jo, që të jetë feja hyjnore dhe mendimi dhe besimi të jetë i drejtë, jo domosdoshmërisht ky besim duhet të jetë triumfues në fushën e jetës. Argumenti për këtë është i qartë.

Vetë kjo fe, e cila triumfoi në periudhën e kohës së Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*), ajo qeveri dhe ai sistem, që e udhëhoqi dhe e menaxhoi jetën e njerëzve me ardhjen e të Dërguarit të Allahut në Medinë, është zhdukur. Pas një periudhe kohe, besimi, feja, vetë ligjet dhe vetë forma e qeverisë, u tretën. Nëse e shikoni periudhën e kohës së Emevitëve, atëherë do të shihni se gjëja që ka ekzistuar në atë kohë, është Islami. Islami ishte po ai, Kur'ani nuk ka ndryshuar; ligjet islame ishin ligjet vetë. Mirëpo këto ligje, në periudhën e kohës së Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) arritën të thyejnë e të shkatërrojnë kështjellat e

inJORANCËS, arritën të fshijnë, të heqin putat e kurejshëve, të arabëve dhe ndyrësitë e tyre, si dhe doli triumfues ndaj sunduesve mizorë. Pavarësisht kësaj, Kur'ani, Islami, ligjet dhe rregullat, pas një periudhe kohe, prej një shekulli, është i mposhtur. I mposhtur nga kush? I mposhtur nga ato puta dhe kështjella.

Në fillim, Islami rrëzoi me forcë të madhe dy perandoritë e mëdha, atë romake dhe perse, por pas një periudhe, prej një shekulli, po ta shikoni, do të shihni se vetë dy perandorët, Kisra dhe Çezari, qeveria djallëzore vetë e persëve dhe ajo romake, iu nënshtruan Islamit, shoqërisë islame dhe popujve myslimanë.

Emri nuk përbën ndryshim, pavarësisht nëse emri abasit është i besueshëm, apo Harun Rashidi, apo Velidi e të tjerë, apo Anushiravuni, apo Khosrov Pervez, apo Jezid Xherrad, apo Herkuli.

Kështu, pra, vetëformimi i asaj qeverie, për të cilën Islami erdhi për ta luftuar dhe e rrëzoi, u rikthye dhe u rrit, u zhvillua pas një periudhe kohe, prej një shekulli në vendet islame. Në të njëjtin mjedis, ku Islami lindi, hapi sythat e tij dhe u zhvillua, sundoi dhe në realitet, e fshiu Islamin. Pra, nuk është vetëm e drejta e Islamit dhe qenia hyjnore e tij, ajo që e bëri Islamin të ecë përpara, paska qenë edhe një gjë tjetër, në harmoni me të. Ajo është dëshira, vullneti i njerëzve dhe lufta e tyre. Ishte përpjekja që njerëzit e besuan

Islamin, e shfaqën haptazi ditën kur u dërgua Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*). Por kjo përpjekje, kjo luftë dhe kjo dëshirë u bë inekzistente, pas njëqind vitesh, madje pas pesëqind vitesh. Ky është shkaku që Islami u mposht.¹¹⁴

Përfitimi prej mësimëve hyjnore

Vëllezër të dashur! Ky popull nuk ka qenë i prapambetur nga aspekti i dijes, i kulturës, i zhvillimit intelektual, shkencor dhe social. Këtë çështje e kanë imponuar fuqitë mizore e gjakatare përgjatë gjithë kohëve. Këtë e bënë për të mbështetur sunduesit e korruptuar dhe e bënë popullin iranian të mbetet prapa padrejtësisht dhe rrejshëm ndaj karvanit të qytetërimit dhe shkencës njerëzore, si dhe zhvillimit shkencor. Islami erdhi dhe e ringjalli këtë popull dhe e mësoi të njohë fuqitë e tij.


Allahu i Lartësuar dërgoi te ky popull një mësues që u flet atyre me gjuhën e profetëve, i zgjoi ata nga gjumi dhe ua mësoi të drejtën dhe fuqinë e tyre. Ua bëri të mundur që ta kuptojnë se populli, nëse zgjedh të jetë përkrahës dhe mbështetës, atëherë çdo mrekulli e madhe do shfaqet prej tij dhe nga dora e tij. Ky popull u zgjua nga gjumi letargjik. Çështja zgjati për një periudhë prej dhjetë vitesh, deri sa

¹¹⁴ Zinxhiri i hulumtimeve të Revolucionit Islamik, më 20.4.1979.

arriti që njëri pas tjetrit nëpërmjet përfitimit prej mësimeve hyjnore, të zgjidhë prangat magjike që armiqtë u kishin hedhur në duar, këmbë dhe qafë.

Vendet u zhvendosën nga aspekti shkencor dhe urban dhe palosën një pjesë të madhe të aspektit moral dhe vlerave fetare.¹¹⁵

¹¹⁵ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në takimin me pjesëmarrësit në manovrat e mëdha “Ruga e Kudsit”, më 23.4.1997.



QENDRAT E QYTETËRIMIT ISLAM

Mungesa e besimit e brezit aktual te qytetërimi islam

Dituria dhe shkenca e Evropës i detyrohet qytetërimit andaluzian

Mungesa e besimit e brezit aktual te qytetërimit islam

Libri “Qytetërimi islam në shekullin e katërmbëdhjetë hixhri”, me autor Adem Metzi, na tregon se e gjithë bota islame, në thelb, ka qenë tregu i diturisë së botës, kurse Irani ka qenë qendra kryesore e saj, d.m.th: Esfehani, Veriji, Shirazi, Khorasani, Herati, Mervi, etj, kanë qenë kryeqytetet e botës së dijes në botë dhe kulmi i saj. Mirëpo brezi i sotëm, është për të ardhur keq. Ata nuk e dinë këtë gjë. Mungesa e kësaj dijeje nuk është me kuptimin se ata nuk kanë njohuri për temat që unë kam propozuar.

Si është e mundur, që të mos e dinë, kur kanë dëgjuar me qindra herë dhe të gjithë e përsërisin nëpër libra, kurse hadithet kanë thënë në çdo vend dhe e kanë përmendur këtë? Ata nuk e besojnë këtë gjë. Përveçse e mohojnë me gjuhë, ekziston edhe një situatë mungese besimi e brezit të sotëm, në lidhje me familjet e tyre, si dhe brezit të mëparshëm, që lidhet me të kaluarën e Iranit. Shkaku i kësaj është se qytetërimi perëndimor dhe kjo teknologji e zhurmshme ka ardhur dhe i ka mbushur mjediset aq shumë,

sa askush nuk merr nismën t'i hedhë një sy pemës së tij familjare.¹¹⁶

Iraku ka qenë kryeqyteti i një prej qytetërimeve të vjetra dhe kryeqyteti madhështor i qytetërimit islam.¹¹⁷

Dituria dhe shkenca e Evropës i detyrohet qytetërimit andaluzian

Myslimanët në jug të Evropës dhe në Spanjë, deri në jug të Francës, themeluan një qytetërim islam. Ky vend u bë djepi i qytetërimit. Dija u përhap në Evropë nga qytetërimi andaluzian, në shekujt e parë të Islamit. Në lidhje me zhvillimin e dijes në ato vende, ka shumë tregime, që vetë perëndimorët i pranojnë. Kurse sot, ata përpiqen ta grisin atë copë letër nga historia, deri në fshirjen e emrit të myslimanëve pothuajse tërësisht. Mirëpo, vetë ata, me duart e tyre, e kanë shkruar këtë histori. Sigurisht që kjo është e regjistruar edhe në historitë tona.¹¹⁸

¹¹⁶ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në takimin me organet e komisionit shkencor, në radion e Republikës Islamike të Iranit, më 4.2.1992.

¹¹⁷ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në takimin me njerëzit e virtutshëm të shkencës dhe dijes, në Kum, më 24.1.1991.

¹¹⁸ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në takimin me rininë e rajonit të Sistanit dhe Pluteshstanit, më 25.2.2003.

Edhe populli ynë, me cilësinë e një populli mysliman, ka një rol të rëndësishëm jo vetëm në qytetërimin industrial dhe shkencor, por edhe në shndërrimin thelbësor të historisë së njerëzimit. Përse? Sepse Islami themeloi, pa asnjë dyshim, një qytetërim që ka përfshirë pjesën më të madhe të botës në atë kohë, e pakta tre apo katër shekuj. Ishte vetë ky qytetërim që ka eksportuar dije te popujt e tjerë, të cilat kanë mundur të themelimin e qytetërimit të kohës së sotme. Nuk ka asnjë dyshim për këtë.

Nga vetë gjuhët e perëndimorëve, sot përhapet lajmi se shekujt e mesjetës në Evropë, kanë qenë periudha e errësirës. Kjo çështje është e rëndësishme, pasi errësira e ka burimin nga Evropa dhe jo nga Irani apo Lindja e Mesme dhe vendi islam në atë kohë. Errësira e shekujve në Evropë, ishte shkëlqim i qytetërimit në Iran. Më e ndritura e kohës ishte periudha e kohës së Ibn Sinës (Avicena).

Po a mund të jetojë në errësirë një vend, kur në të është gjallë Ibn Sina? Po vendi ku jeton Farabei, a është në errësirat e injorancës? Po ai vend ku janë dijetarë, poetë dhe autorë librash të një niveli madhështor, a bie vallë në gropën e errësirës? Shikojini me vëmendje shkrimtarët dhe poetët e shekujve të katërt, të pestë dhe të gjashtë hixhri, krahasuar me kohët më të errëta të shekujve të mesëm në Evropë, çfarë njerëzish ishin ata?

Numëroni nga Firdusi e deri te Hafidhi dhe shikoni çfarë ndodhte në Iran në atë periudhë kohe. Numëroni që nga Ibn Sina e deri tek i madhi Nesirudin Tuzi, dyqind vite, shikoni se çfarë njerëzish kollozë ekzistonin në Iran, filozofë, poetë apo shkrimtarë. Njëri prej tyre ishte Bajhakiu.

Ky vend ishte një vend i zhvilluar, në të gjitha dimensionet kulturore e shkencore, jo vetëm në dimensionin edukativ dhe tregimit të historisë së bilbilit, luleve apo shembujve ngjashëm me to, por edhe në fushat e llogaritjes, sporteve, yjeve, mjekësisë dhe të gjitha shkencave të tjera që bota ka zhvilluar.

Pra, populli ynë ka luajtur një rol të rëndësishëm në ato periudha kohe. E thënë ndryshe: Populli ynë ka pasur një rol thelbësor e të rëndësishëm në shndërrimin e botës dhe zhvillimin e saj, deri në situatën që është sot, për nga aspekti shkencor dhe industrial. Ky popull ka formuar një hallkë të rëndësishme të këtij zinxhiri.¹¹⁹

¹¹⁹ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në takimin me bordin e drejtuesve, përgjegjësit, profesorët dhe të diplomuarit, në universitetin e shkencave strategjike, në varësi të ushtrisë, më 26.12. 1994.

FAKTORËT E DOBËSIMIT TË QYTETËRIMIT ISLAM

Kushtet e lartësimit

Islami ka vërtetuar se ka të gjithë fuqinë e tij, që ta çojë ymetin e vet drejt përmirësimit, të dijës, qoftë ajo shkencore, qoftë kulturore. Gjithashtu, ka fuqinë edhe për sundimin politik. Kushti i vetëm për të realizuar këtë qëllim të madh, është: besimi, xhihadi dhe shmangia e përçarjes.

Kur'ani Famëlartë thotë në ajete: **“E mos u dobësoni (fizikisht) dhe mos u dëshpëroni (shpirtërisht) derisa ju jeni më të lartit, po qe se jeni besimtarë të sinqertë.”**¹²⁰

Dhe: **“E ata të cilët luftuan për hir Tonë, Ne me siguri do t'i oriejtojmë rrugës për te Ne, e nuk ka dyshim se Allahu është në krahun e besimtarëve.”**¹²¹

Dhe: **“Dhe respektojeni Allahun dhe të Dërguarin e Tij, e mos u përçani mes vete, e të dobësoheni e ta**

¹²⁰ Sure “Ali Imran”, ajeti 139.

¹²¹ Sure “El Ankebut”, ajeti 69.

humbni fuqinë (luftarake). Të jeni të durueshëm se Allahu është me të durueshmit.”¹²²

Nuk ka dyshim se dobësimi i këtyre tri faktorëve e ka çuar ymetin islam sot deri në këtë situatë, që është për të ardhur keq. Në dy shekujt e kaluar, jo vetëm armiq të këmbëngulës dhe të armatosur, por edhe një pjesë e qeverive të padenja myslimane, kanë përkrahur këta faktorë, kushtet e ndryshme historike dhe politike dhe kanë ndikuar shumë që të shfaqej kjo situatë. Ja ku jemi ne sot, prapa pasardhësve tanë.¹²³

Politika e bërjes së Iranit model si Andaluzia

Politika e sotme është politika e bërjes së Iranit, e ngjashme me Andaluzinë. Tema që unë po ju propozoj juve, nuk është në formën e një këshille, përkundrazi ajo është një temë thelbësore, që diskutohet dhe debatohet me njerëzit më të mirë të popullit, që jeni ju rini. Unë nuk po ju drejtohem vetëm juve, si të vetmit, pasi këtë fjalë do ta dëgjojë e gjithë rinia e vendit në tërësi. Brezi i rinisë në vend, i cili përbën gjysmën e popullit dhe shumicën e banorëve në vende të tjera, e ka për detyrë, pra, duhet t’i njohë pengesat

¹²² Sure “El Enfal”, ajeti 46.

¹²³ Fjalimi i udhëheqësit, në takimin e tetë me udhëheqësit e vendeve islame 18.9.1376 sipas kalendarit iranian.

ekzistuese përpara dëshirave të tij të mëdha, çështjeve të larta dhe qëllimeve të shenjta, të cilat janë burimi i pranimit të tij dhe të denja për të.

Kur evropianët deshën t'ia merrnin mbrapsht Andaluzinë myslimanëve, filluan të zbatojnë procedura afatgjata. Në atë kohë nuk ekzistonin akoma sionistët, mirëpo armiq të Islamit dhe qendrat e vendimmarrjes ishin aktive kundër Islamit. Këta ndërmorën shkatërrimin dhe degjenerimin e rinisë. Në këtë fushë ata kishin në dispozicion motive të ndryshme: Kristianizmin, si fetaren, ashtu edhe politiken.

Një nga veprat që kryen, ishte shkatërrimi i rinisë. Në këtë fushë ata kishin motivime të ndryshme: të krishtera, fetare apo politike. Ata i bënë vakëf vreshtat e rrushit që të shpërndanin verën e saj falas tek rinia. E nxitën me forcë rininë, që të shkonte drejt grave dhe bijave të tyre, me qëllim që t'i ndotnin me pasionet e shfrenuara.¹²⁴

¹²⁴ Fjalimi i udhëheqësit, në takimin me të rinjtë e Qarkut të Sistanit dhe të Pluteshstanit 6.12.1381 sipas kalendarit iranian.

Dobësimi i besimit dhe dhënia përparësi pasionit

Nëse nuk i qëndron përballë pushtimit moral, karakterit, ndjekjes së pasioneve dhe prirjes drejt egoizmave të ndryshme, t'i luftosh këto probleme, besimi do të largohet prej teje dhe do të jesh bosh nga brenda. Kur të të merret besimi, edhe zemra do të jetë e boshatisur, kurse nga pamja e jashtme, do të jesh besimtar. Një njeri i tillë e ka emrin hipokrit. Nëse Zoti na i zbraz zemrat tona prej besimit, kurse dukja e jashtme do të ishte pamje prej besimtari, atëherë e kemi humbur lidhjen tonë me Zotin, edhe pse gjuhët tona vazhdojnë akoma të shqiptojnë të njëjtat fjalë besimi që thuheshin më parë. Kjo është hipokrizi dhe është një çështje shumë e rrezikshme.

Kur'ani Famëlartë thotë: **“Pastaj përfundimi i atyre që punuan keq, ka qenë e keqja e madhe (Xhehenemi), ngase i mohonin Shpalljet e Allahut dhe talleshin me to.”**¹²⁵

Pra, fundi i atyre që vepruan punë të këqija, do të jetë më i keqi. Po cili është më i keqi? Më i keqi është ai që përgënjeshton argumentet e Allahut.

Në një vend tjetër thuhet: **“Prandaj, Ai ua lidhi hipokrizinë në zemrat e tyre, deri në ditën kur do të dalin**

¹²⁵ Sure “Er Rrum”, ajeti 10.

para Tij, sepse e shkelën premtimin dhënë Allahut. Ata e kishin zakon gënjeshtren."¹²⁶

Ata nuk e kanë zbatuar detyrën e madhe, shpenzimi në rrugë të Allahut, sepse e thyen premtimin që i patën dhënë Allahut dhe në zemrat e tyre u shfaq hipokrizia. Ky është rreziku i madh për ymetin e Islamit. Kurdo që ta shikoni shoqërinë islame që ka devijuar përgjatë historisë, dijeni mirë se devijimi ka filluar prej këtu. Mund të vijë ndonjë armik i jashtëm, mund të të rrëzojë, të të mundë apo të të shpartallojë, por ai kurrsesi nuk mund të të anulojë apo të të zhvleftësojë. Në fund, besimi mbetet dhe ngrihet lart në një vend tjetër dhe lulëzon, ndërsa, kur mposhtet ushtria e armiqve të brendshëm të njeriut, duke e zhveshur dhe duke e boshatisur brendinë e tij, atëherë ai do ta humbasë rrugën e drejtë. Ky është burimi i tij. I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) e ka luftuar fort këtë armik.¹²⁷

Përgjatë këtyre njëzet viteve, në Republikën Islamike të Iranit, ne kemi ecur përpara dhe jemi zhvilluar. Kemi arritur t'i japim përparësi jo vetëm përgjegjësisë dhe qëllimeve, por edhe dobësimit të vetvetes sonë, pasioneve tona. Mirëpo, kudo që ndodhte ndonjë konflikt, ne merrnim goditje. Personat që ishin në atë kohëi njohin detajet e

¹²⁶ Sure "E Teube", ajeti 77.

¹²⁷ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në hytben e namazit të xhumasë, në Teheran, më 28.2.1980.

çështjeve. Përgjatë tetë viteve të luftës së imponuar, ata e njohin mirë këtë çështje me detaje. Në atë kohë sundonte shpirti i përgjegjësisë. Edhe pse mirësia dhe bujaria ishin të pakta, ne përparuam. Aty ku shfaqej mirësia, skutat e ligësisë fillonin të lulëzonin. E tillë është edhe sot çështja.¹²⁸

¹²⁸ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në takimin me nëpunësit e administratës publike, më 15.8.1978.

SHMANGIA NGA THEMELET E FESË DHE MENAXHIMI I SHOQËRISË

Ndarja e fesë nga politika

Kthimi i shikimit të moraleve islame në politikë

Ndryshimi i standardeve dhe dobësimi i vlerave

Parandalimi i konvertimit të standardeve hyjnore

Mbjellja e konfliktit dhe përçarja e unitetit të rreshtit

Mosmarrëveshja: Helmi shkatërrues i popujve

Ndarja e fesë nga politika

Një pjesë e njerëzve e konsiderojnë Islamin thjesht një çështje individuale dhe e kanë hequr atë nga politika.

Sot, në shumë shoqëri islame, në enciklopeditë sulmuese të botës perëndimore, mendjemadhe dhe kolonizuese, propagandohet shumë që Islami nuk ka punë me politikën.

E kanë zhveshur Islamin nga politika, kur ndërkohë, e para gjë që bëri Profeti i Islamit (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*), në fillimin e hixhretit të tij, ishte politika. Edhe kur e çliroi veten prej vështirësive të Mekës, ai u angazhua me politikë. Kështu formimi i shoqërisë islame, i qeverisë islame, formimi i sistemit islam dhe i ushtrisë islame, bashkë me mesazhet që dërgoi te sunduesit e mëdhenj të botës, edhe hyrja në fushën e madhe njerëzore të politikës në atë periudhë kohe, është një politikë. Si mund të ndahet feja nga politika? E si mundet politika të komentojë, të interpretojë, të shpjegojë dhe të formohet nëpërmjet një menaxhimi apo drejtimi tjetër pos drejtimit islam?

“E bënë Kur’anin në pjesë (duke i besuar ca pjesë dhe duke i mohuar të tjerat)...”¹²⁹

Një pjesë e njerëzve e ndajnë në disa pjesë Kur’anin.

Ti i shikon ata ta besojnë një pjesë të Librit dhe ta mohojnë një pjesë tjetër¹³⁰, i besojnë çështjet që lidhen me adhurimin në Kur’an dhe nuk i besojnë çështjeve politike që janë brenda tij.

“Ne i çuam të Dërguarit Tanë me prova të qarta dhe bashkë me ta zbritëm Librat (e shenjtë) dhe peshoren (e drejtësisë): që njerëzit të veprojnë drejt. Ne e zbritëm hekurin, në të cilin ka (material për) luftë të fuqishme dhe dobi (të tjera) për njerëzit, me qëllim që Allahu të njohë ata që e ndihmojnë Atë dhe të Dërguarit e Tij, pa e parë Atë. Me të vërtetë, Allahu është i Fortë dhe i Plotfuqishëm.”¹³¹

Çfarë është drejtësia? Është vendosja e drejtësisë sociale në shoqëri. Po cili e zbaton këtë çështje? Formimi i një shoqërie, të shoqëruar me drejtësinë e vërtetë, është një punë politike; është puna e përgjegjësve, e qeveritarëve të një shteti. Ky është qëllimi i profetëve, jo vetëm i Profetit

¹²⁹ Sure “El Hixhr”, ajeti 91.

¹³⁰ Fragment nga komenti i ajetit 150 të sures “En Nisa”: **“Ne disa i besojmë e disa nuk i besojmë”**.

¹³¹ Sure “El Hadid”, ajeti 25.

Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të mbi familjen e tij!*), por edhe i Isait, Musait, Ibrahimit. Të gjithë Profetët e tjerë kanë ardhur për hir të politikës dhe formimit të sistemit islam. Ndonjë grupim mund të distancohet në krahun e kapitullit të shenjtërisë dhe të thotë: “Ne nuk merremi me politikë! A është feja e ndarë nga politika?” Ndërkohë, propagandat e fëlliqura perëndimore gjithmonë promovojnë për këtë çështje dhe thonë: “Ndajeni fenë nga politika! Ndajeni fenë nga shteti!”

Nëse ne jemi myslimanë, atëherë feja dhe shteti janë të ndërthurura me njëri-tjetrin, jo si dy gjëra që bashkojnë njëra-tjetrën. Feja dhe shteti, që të dyja janë një trup i vetëm.

Feja dhe shteti në Islam burojnë nga i njëjti dhe i vetmi burim, që është Shpallja hyjnore. Kështu, pra, janë ato të dyja, Kur’ani dhe Islami.¹³²

Kthimi i shikimit të moraleve islame në politikë

Një pjesë e njerëzve, nga njëra anë, e veçojnë fenë nga politika, kurse një pjesë tjetër, nga ana tjetër, konsiderojnë se Islami është ai që nxit politikën dhe rolet politike luhen

¹³² Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në takimin me nëpunësit e administratës dhe pjesëmarrësit e Konferencës së Unionit Islamik, më 31.5.1385 sipas kalendarit iranian.

me angazhimin e saj. Ata bëjnë një sy qorr ndaj moralit dhe ndjenjave shpirtërore, dashurisë, virtytit dhe bujarisë, të cilat janë qëllimet më madhështore të Shpalljes së profetëve. Ky është një miratim i ajeteve të bekuara: **“E bënë Kur’anin në pjesë** (duke i besuar ca pjesë dhe duke i mohuar të tjerat)...”¹³³

Dhe: **“Ne disa i besojmë e disa nuk i besojmë.”**¹³⁴

S’ka dyshim se përmbledhja e Islamit në shprehje politike të ndritshme dhe të rrjedhshme, hutimi dhe pavëmendja e zemrës së përulur, bërja një sy qorr nga dhikri (përkujtimi i Allahut), ndaj pastërtisë, ndaj ndjenjave shpirtërore, ndaj nënshtrimit të Allahut, ndaj lutjes së Allahut, ndaj lidhjes me Allahun, nga të qarët nga frika prej Allahut, nga kërkimi i mëshirës hyjnore, nga durimi, bujaria, mikpritja, amnistia nga vëllazëria dhe lidhja e gjakut dhe aderimi i pastër me politikën, gjithashtu, në emrin e Islamit, është shmangie. Kurrresi nuk ndahet prej saj.¹³⁵

Qëkur ymeti islam e ndau fenë nga shteti dhe moralin nga menaxhimi i shoqërisë, ai është sprovuar me

¹³³ Sure “El Hixhr”, ajeti 91.

¹³⁴ Sure “En Nisa”, ajeti 150.

¹³⁵ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në takimin me administratën shtetërore dhe pjesëmarrësit e Konferencës së Unionit Islamik, më 31.5.1385 sipas kalendarit iranian.

mungesë barazie. Që prej asaj dite, sunduesit dhe mbretërit, nën emrin “kalifë”, ngritën flamurin e Islamit në Bagdad, në Sham, në këtë cep të botës apo andej. Fatkeqësisht, poshtë atij flamuri, futën pasionet psikologjike, epshet, qëllimet personale, mendjemadhësinë, kryeneçësinë e mbretërve, kursimin e parave dhe grumbullimin e pasurive, duke i ruajtur ato nëpër magazinat e tyre. Me të gjitha këto, u krijua mjedisi i degjenerimit të botës islame.

Megjithatë Profeti i bekuar (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*), bashkë me sahabët dhe mbështetësit e tij luftëtarë, ka qenë në lëvizje, që Islami të përparojë me shpejtësi. Kur ideologjia politike e shkencore e Islamit, përparonte me shpejtësi, në dy shekujt, të katërtin dhe të pestin hixhri, falë aftësisë së Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*), farërat e dobësimit, të degjenerimit, të korrupsionit dhe hipokrizisë, po shpërndareshin nëpër dysheme. Familjet sunduese, që ishin po të njëjtat fara që ishin rritur dhe ishin zhvilluar, paralizuan ymetin islam. Ja këtu, tani ne po i ndjejmë rezultatet e tyre me gjithë ekzistencën dhe qenien tonë.¹³⁶

¹³⁶ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në takimin me nëpunësit e administratës dhe pjesëmarrësit e Konferencës së Unionit Islamik, më 31.5.1385 sipas kalendarit iranian.

Ndryshimi i standardeve dhe dobësimi i vlerave

Çfarë ngjarje ka ndodhur në historinë e shoqërisë islame dhe çfarë embrioni është futur në trupin e kësaj shoqërie! Kjo shoqëri ka mbajtur mbi krye një personalitet, si i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*), që nuk ishte njeri i zakonshëm. Ky i Dërguar sundoi për dhjetë vjet me forcën vetëpërrjashtuese njerëzore, nëpërmjet lidhjes me burimin e Shpalljes hyjnore të përhershme, urtësisë së pafundme dhe shembullit të pandërprerë që ai i shijonte. Disa vite më pas, triumfoi rishtazi mbi këtë shoqëri, sundimi i Ali ibn Ebu Talibit (*Paqja qoftë mbi të!*). Qendra e kësaj qeverie madhështore ishte Medina dhe Kufja. E pra, gjysmë shekulli pas vdekjes së të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) dhe njëzet vite pas rënies shehid të Prijësit të besimtarëve, Imam Aliut (*Paqja qoftë mbi të*), vritet një njeri si Imam Hysejini (*Paqja qoftë mbi të*), në po të njëjtën gjendje, në po të njëjtën shoqëri dhe në po të njëjtën njerëz.¹³⁷

Kur humbasin standardet dhe vlerat dobësohen, kur format e jashtme bëhen bosh, kurse dashuria për këtë botë dhe dashuria për pasuri i mposht njerëzit, që kanë kaluar

¹³⁷ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në takimin me Gardën Revolucionare Islamike, më 5.10.1974.

një jetë të mbushur me madhështi dhe vite të tëra pakujdesie ndaj bukurive të botës dhe kanë arritur të ngrenë lart simbolin e madhësisë, është koha kur njeriu bëhet sikurse nami i klerikëve të lartë në botën e kulturës dhe të njohurive; besnik ndaj njohurive hyjnore islame.

Ai njeri i porsaardhur në Islam, që thotë atë që kupton ai vetë dhe jo atë që thotë Islami, atëherë dëshirat e disave do të orientohen drejt asaj që ai thotë dhe thënia e tij do të paraprijë fjalën e atij që ka dije prej myslimanëve.¹³⁸

Parandalimi i konvertimit të standardeve hyjnore

Ata që janë të kujdesshëm, nuk duhet të lejojnë ndryshimin e standardeve hyjnore në shoqëri. Nëse tjetërsohet standardi i devotshmërisë, është e qartë se gjaku i njeriut të devotshëm, sikurse Hysejn ibn Aliu, do të derdhet. Nëse truri dhe mendja angazhohet me çështjet e kësaj bote, në mashtrim dhe gënjeshtër, duke mos u shqetësuar për vlerat islame si standard, atëherë është e qartë se një njeri si Jezidi, do të ulet në kolltukun e qeverisë, kurse një njeri si Ubejdullah ibn Zijadi, do të jetë personaliteti i parë në Irak.

¹³⁸ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në hytben e namazit të xhumasë, në Teheran, më 18.2.1377 sipas kalendarit iranien.

Shqetësimi më i madh i Islamit ka qenë ndryshimi i këtij standardi. E gjithë pasuria jonë, gjithashtu, ka qenë përballja e ashpër dhe me forcë ndaj standardeve të kota, të prishura, gabimeve materialiste dhe konvertimi i tyre.¹³⁹

Ky është shirku, të cilin myslimanët, nëpërmjet deklaramit të pafajësisë dhe naivitetit, angazhohen dhe duhet ta pastrojnë prej saj mjedisin e tyre dhe Islamin. Ajo që të bën të ndjesh keqardhje, është se hutimi i myslimanëve dhe braktisja e Kur'anit për vite e vite, ka bërë dhe i ka lënë hapësirë shtrembëruesve dhe në emër të fesë, të fusin çdo fjalë boshe dhe të kotë në mendje, si dhe të mohojnë shumicën e bazave të fesë, duke i mveshur shirkut rrobat e Teuhidit dhe mohimin e përmbajtjeve të ajeteve kur'anore me shumë lehtësi.¹⁴⁰

Mbjellja e konfliktit dhe çarja e unitetit të rreshtit

Këta që ju i shikoni në sezonin e Haxhit, që ecin me nxitim pas shpërndarjes së farërave të përçarjes dhe ndezjen e zjarrit të fitnes, si dhe promovimit të mendimeve të tyre imagjinare, trilluese e të fosilizuara, janë vetë këto

¹³⁹ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit në takimin me të mobilizuarit, më 22.4.1371 sipas kalendarit iranian.

¹⁴⁰ Deklaratë e udhëheqësit për haxhilerët e shtëpisë së shenjtë të Allahut, Qabes, më 14.4.1368 sipas kalendarit iranian.

instrumente, njësoj e kanë ditur apo jo, të cilat i ekzekutojnë këto relike, besimin e singertë në zemrat e besimtarëve dhe i shuajnë ato plotësisht.¹⁴¹

Mosmarrëveshja: Helmi shkatërrues i popujve

Prej një kohe shumë të gjatë, fuqitë e mëdha ishin të angazhuara në përgatitjen e terrenit për shfaqjen e konflikteve kombëtare, sektare, rajonale dhe politike në radhët e popullit tonë. Për çdo popull, nuk ka faktor më shkatërrues se sa konflikti dhe përçarja. Konflikti është helmi më i rrezikshëm për popujt, qytetërimin dhe revolucionet. Në qoftë se popujt më të mirë nuk do të sprovoreshin me përçarje dhe konflikt, nuk ka asnjë dyshim se të gjitha fuqitë e tyre jetësore, jo vetëm që nuk do të ekzistonin më, por, përkundrazi, vendet do përfundonin në shkatërrim.¹⁴²

Kombi i madh islam, është përballur abuzivisht përgjatë shekujve me sfida. Ne u larguam nga Islami dhe u angazhuam me gjëra që Islami vetë na ka paralajmëruar prej

¹⁴¹ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në takimin me punonjësit e angazhuar për dërgimin në Haxh, më 25.10.1381 sipas kalendarit iranian.

¹⁴² Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në takimin me kategori të ndryshme të popullit, në Azerbaxhan, më 30.3.1368 sipas kalendarit iranian.

tyre. Përgjatë gjithë kësaj historie të gjatë, ne jemi angazhuar me luftëra të brendshme dhe kjo është bërë nga dora e fuqive mizore. Rezultati ishte që ymeti i madh islam përgjatë shekujve abuzivë, pas shekujve të parë të Islamit, nuk ka mundur të arrijë objektivin dhe qëllimin që priste prej tyre i Dërguari i Islamit (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) dhe Islami fisnik për të cilin ato të dyja brohoritnin. Megjithatë, edhe pse Allahu i Lartësuar ka ruajtur për ne, vendet islame, pasuri të madhe materiale, që ne të zhvillohemi, në fushën e shkencës, të industrisë dhe shumë treguesve të tjerë të zhvillimit, kemi mbetur në pjesën e vendeve të prapambetura. Nuk ishte kjo ajo që kishte përgatitur Islami për ne, përkundrazi, ky është produkt i asaj që na bënë veprat tona të këqija, morali, hutimi dhe pakujdesia jonë, myslimanëve.

“E çka të ndodhë ndonjë e keqe është nga vetë ti.”¹⁴³

Jemi ne ata që e kemi çuar veten tonë në këtë gradë, si rezultat i pakujdesisë dhe hutimit përgjatë gjithë kohës, deri sa arritëm në këtë situatë që jemi sot.¹⁴⁴

¹⁴³ Sure “En Nisa”, ajeti 79.

¹⁴⁴ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në takimin me punonjësit në çështjen e haxhit më 25.10.1381 sipas kalendarit iranian.

INJORIMI I MADHËSHTISË SË YMETIT ISLAM

Jurisprudenca islame është trashëgimia më e rëndësishme islame

Qytetërimi perëndimor është ushqyer nga qytetërimi islam

Jurisprudenca islame është trashëgimia më e rëndësishme islame

Sigurisht, te studiuesit është e qartë se repertori i rëndësishëm i jurisprudencës islame, e bazuar mbi medh'hebin e Ehli Bejtit, është një nga trashëgimitë e kulturës dhe qytetërimit islam, me më shumë produktivitet dhe rëndësi, që i ka dhënë Islamit dhe njerëzimit qindra gjurmë dhe fakte shkencore dhe që zënë një pozitë shumë të lartë. Ato kanë pasuruar bibliotekat e enciklopedive islame, duke ia shtuar edhe më shumë vlerën. Paraardhësi ynë punëmirë, me luftën e tij të pandërprerë e të pashembullt, pavarësisht kokëfortësisë dhe mundësive të pakta, i ka shtuar çdo gjë kësaj trashëgimie me shumë vlerë. Ka përgatitur jo një libër, por shumë libra, që sot mallëngjehen të gjitha institucionet dhe seminarët shkencore botërore dhe dëshirojnë shumë të njihen me çështjet e jurisprudencës së Ehli Bejtit.¹⁴⁵

¹⁴⁵ Një mesazh rreth krijimit të institucionit të rrethit të enciklopedive të jurisprudencës islame, ndjekëse e Ehli Bejtit, më 2.11.1369 sipas kalendarit iranien.

Qytetërimi perëndimor është ushqyer nga qytetërimi islam

Pas një periudhe kohe, qytetërimi perëndimor filloi të ngjisë përsëri shkallët, duke përfituar nga koleksionet.

Ai është ushqyer nga qytetërimi islam. Po t'i shikojmë me vëmendje librat e asaj periudhe, burimet e tyre, do të kuptojmë shumë. Dijetarët më të shquar u angazhuan të ndjekin gjurmët islame, ta përkthejnë Islamin.¹⁴⁶

¹⁴⁶ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në takimin me komandantët e Gardës Revolucionare Islamike, më 29.6.1373 sipas kalendarit iranien.

RINDËRTIMI I QYTETËRIMIT ISLAM

Ndërtimi i qytetërimit mbi themelin e qytetërimit profetik

Toka e Shpalljes hyjnore, themelimi i qytetërimit islam

Revolucioni Islamik ndoqi rrugën e Profetit më të madh, Profetit Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!)

Qëllimi: Ta jetosh jetën e mirë islame

Revolucioni Islamik bëri që Islami origjinal muhamedan të zërë vendin e Islamit amerikan

Të durosh të gjitha fatkeqësitë, për hir të Islamit

Një lëvizje brenda kufijve, për një mesazh botëror

Revolucioni ynë është një ditë e re, për të gjithë popujt myslimanë

Themelimi i qytetërimit, mbi themelet e kulturës dhe të dijes

Qëllimi është: Forcimi i fesë së Allahut

Ndërtimi i qytetërimit mbi themelin e qytetërimit profetik

Për dërgimin me Shpallje të Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*), Kur'ani Famëlartë, thotë: **“Është Ai që e ka çuar të Dërguarin e Vet me Udhëzimin dhe Fenë e vërtetë, për ta ngritur atë mbi të gjitha fetë. Allahu mjafton si dëshmitar!”**¹⁴⁷

“Për ta ngritur atë mbi të gjitha fetë”, kjo sifjali nuk lidhet me kohën, por na tregon dhe na paraqet pikëpamjen. Njerëzimi duhet të ecë drejt lirisë shpirtërore, lirisë sociale, reale dhe të arsyeshme. Kjo çështje ka filluar dhe vazhdimësia e saj është në dorën tonë, të njerëzve.¹⁴⁸

Toka e Shpalljes hyjnore, themelimi i qytetërimit islam

Këtu, ka zbritur Kur'ani Famëlartë në ajete, një e nga një dhe ka vendosur shtyllat e ndërtesës së kulturës dhe qytetërimit dhe të jetës së mirë islame. Myslimanët, duke e parë me vëmendje këtë të kaluar dhe mënyrën e saj të

¹⁴⁷ Sure “El Fet’h”, ajeti 28.

¹⁴⁸ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në takimin me administratën publike.

jetesës, çast pas çasti, do të realizojnë një lidhje të fortë me të ardhmen. Ata e njohin modelin e jetës dhe qëllimin e saj. I kuptojnë rreziqet e rrugës dhe e shikojnë syhapur të nesërmen e rrugëtimit. Ata e përgatisin veten e tyre me moralin e saj dhe e mposhtin dyshimin që lind nga ndjenja e dobësisë, nga përbuzja dhe frika prej armiqve.¹⁴⁹

Revolucioni Islamik ndoqi rrugën e Profetit më të madh, Profetit Muhamed *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!)*

Revolucioni Islamik në Iran, nën udhëheqjen e çliruesit të madh të kohës, Imam Khomejni *(Allahu ia shenjtëroftë sekretet)*, ndoqi rrugën e Profetit më të madh, Vulës së Profetëve, Krijesës më të dashur tek Allahu i Madhëruar, Muhamed Mustafasë *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!)*. Ai u shfaq në formën e një revolucioni të shkëlqyer. Nëse ky Revolucion nuk do të ngrihej mbi themele të vërteta dhe logjike do të ishte njësoj si vullkani që shkakton tërmet në të gjitha anët dhe çdo gjë rreth tij do të ndikohej dhe do të prekej nga nxehtësia e tij, njerëzit dhe vendet.¹⁵⁰

¹⁴⁹ Deklaratë e udhëheqësit për haxhilerët.

¹⁵⁰ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, me rastin e përvjetorit të parë të vdekjes së Imam Khomenit, më 10.3.1369 sipas kalendarit iranien.

Qëllimi: Ta jetosh jetën e mirë islame

Prapa të gjitha veprimeve dhe përpjekjeve që bëri populli iranian, nën udhëheqjen e Imam Khomenit (*Allahu ia shenjtëroftë sekretet*) e deri në triumfin e revolucionit dhe të gjitha përpjekjet e tjera që u zhvilluan pas triumfit të revolucionit në këtë vend, synimi ka qenë realizimi i një jete të mirë islame.

Islami i ka përcaktuar njeriut modelin e jetës së përshtatshme dhe harmonike. Sikur vetëm këto kushte të plotësohen, njeriu mund të arrijë lumturinë dhe përsosjen.¹⁵¹

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) ka bërë thirrje dhe ka ftuar në këto çështje, për të cilat njerëzimi ka nevojë në të gjitha fazat e historisë së jetës. S'ka dyshim se slogani i qeverisë islame sot, është liria e mendimit, zhvillimi shkencor, kujdesi për të drejtat e njeriut dhe dëshirat e njerëzimit, mëshira dhe respekti midis njerëzve. Kjo është motoja e Islamit dhe e mesazhit të tij, që bota përpiqet dhe i shkon pas çështjeve.¹⁵²

¹⁵¹ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në takimin me përfaqësues nga segmente të ndryshme të shoqërisë, në sesionin e dhjetë ditëve të fexhrit, më 12.11.1368 sipas kalendarit iranian.

¹⁵² Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në takimin me përgjegjësit dhe zyrtarët e administratës publike, më 2.7.1382 sipas kalendarit iranian.

Revolucioni Islam bëri që Islami origjinal Muhamedan të zërë vendin e Islamit amerikan

Në Revolucionin Islamik të Iranit, Islami i Librit (Kur'ani) dhe Syneti, zuri vendin e Islamit të mitologjisë. Islami i xhihadit dhe i rënies dëshmor, zuri vendin e Islamit të shpërfilljes, të robërimit dhe poshtërimit. Islami i adhurimit dhe maturisë (mendjes së shëndoshë), zuri vendin e Islamit të kapur dhe injorancës. Islami i dynjasë dhe Ahiretit, zuri vendin e Islamit të dashurisë së kësaj bote dhe murgërisë. Islami i dijes dhe i shkencës, zuri vendin e Islamit të epokës së gurit dhe hutimit. Islami i fesë dhe i politikës, zuri vendin e Islamit të shpërbërjes dhe indiferencës. Islami i qëndrimit në këmbë dhe i veprave, zuri vendin e Islamit të dobësisë dhe depresionit. Islami i individit dhe i shoqërisë, zuri vendin e Islamit ceremonial (protokollar) dhe atij jofunksional (pa asnjë efekt). Islami që shpëton dhe ndihmon njerëzit e dobët, zuri vendin e Islamit kukull në duart e fuqive të mëdha. Në përfundim: Islami i vërtetë muhamedan, zuri vendin e Islamit amerikan.

Nuk ka dyshim se paraqitja e Islamit me këtë mënyrë, me këtë realitet dhe seriozitet, ka çuar në një stuhi zemërimi tek ata që shpresat e tyre i kanë lidhur me zhdukjen e Islamit në Iran dhe në të gjitha vendet islame, ose nuk prisnin gjë tjetër prej Islamit bosh, për nga përmbajtja, duke i kthyer

njerëzit në budallenj dhe të hutuar. Prandaj ju i shikoni ata se, që prej ditës së parë të triumfit të revolucionit e deri më sot, nuk kanë kursyer asnjë rast për ta sulmuar dhe për ta goditur, për të komplotuar dhe për t'i bërë dëm me paramendim Republikës Islamike dhe qendrës botërore Islame, d.m.th. Iranit.¹⁵³

Të durosh të gjitha fatkeqësitë, për hir të Islamit

Kjo rilindje popullore dhe ky revolucion i pashembullt doli në pah, pesëmbëdhjetë vite pas luftës. Kjo “thertore” e madhe u shfaq përgjatë dymbëdhjetë viteve të zgjatjes së këtij sistemi sundues. Shumë njerëz të mirë ranë dëshmorë. Populli duroi të gjitha fatkeqësitë, të këqijat dhe torturat, vetëm për hir të Islamit. Ky populli sakrifikues dhe Imami i madh, e vlerësonin lumturinë me ndjekjen e vërtetë të Islamit dhe shikonin se vërtetësia e Islamit është rruga e çlirimit nga sundimi i djajve, i mizorëve dhe i zullumqarëve.

¹⁵³ Një mesazh me rastin e përvjetorit të parë të vdekjes së Imam Khomenit (*Allahu ia shenjtëroftë sekretet*), më 3.10.1369 sipas kalendarit iranian.

* “Sahifetul Imam”, vëll. 5, f. 204-205: “Islami vetë ishte prej themeluesve të qytetërimit të madh në botë. Çdo vend që punon me ligjet e Islamit, do të bëhet, pa asnjë dyshim, një nga vendet më të përparuara. Ne shpresojmë që, nëpërmjet triumfit tonë, t’ia vërtetojmë këtë gjë botës.”

Ata kërkuan kënaqësinë e Allahut në ndjekjen e sundimit të Islamit.

Nuk ka dyshim se popujt e singertë e të dhembshur myslimanë në të gjithë botën islame, jo vetëm e kanë vlerësuar, por akoma e vlerësojnë këtë revolucion, një revolucion që ka lidhje dhe mbrohet për hir të Islamit. Prej këtui, s'ka dyshim se një nga përgjegjësitë më të rëndësishme të Republikës Islamike të Iranit është zbatimi i Islamit në jetën e njerëzve, si dhe shndërrimi i shoqërisë islame në një shoqëri model.¹⁵⁴

Një lëvizje brenda kufijve, për një mesazh botëror

Vëllezër të dashur! E dashur rini! Me të vërtetë, çështja e ndërtimit të një sistemi dhe qytetërimit islam dhe një historie të re, në lidhje me këtë popull, është një çështje shumë serioze. Merreni këtë çështje më me seriozitet! Ndonjëherë, dikush mund të bëjë ndonjë revolucion në filan vend dhe vjen një qeverisje e re. Ky sistem nuk do të rrijë që të zhduket në vetëm pak ditë apo t'ia dorëzojë dikujt tjetër, që gjithçka të rikthehet në gjendjen e mëparshme. Në disa raste, situata është e tillë dhe nuk i përmend të gjitha këto

¹⁵⁴ Një mesazh i udhëheqësit, me rastin e përvjetorit të parë të vdekjes së Imam Khomenit (*Allahu ia shenjtëroftë sekretet*), më 10.3.1369 sipas kalendarit iranian.

çështje. Ajo që ka ndodhur në Iran, është një lëvizje madhështore, për standardin botëror.

Revolucioni ynë është një ditë e re, për të gjithë popujt myslimanë

Ky ishte një mesazh botëror. Po cili është argumenti për këtë? Argumenti është se, kur populli iranien dhe udhëheqësi ynë i madh u ngritën për këtë kauzë, myslimanët në të gjithë anët e botës e ndjenë se kjo ditë është dita e triumfit të revolucionit, është dita e festës së tyre (bajramit të tyre) dhe një ditë e re ka nisur për ta, edhe pse ata nuk kishin fare lidhje me kauzën. Të gjithë, në të katër anët e botës, e ndjenë se një erë e re e historisë së tyre sapo ka filluar. Kjo është ajo që ne kemi dëshmuar nga afër. Unë e kam prekur vetë këtë realitet përgjatë viteve të kaluara në shtete të tjera dhe e kam dëgjuar nga gjuha e dhjetëra personave. Këto çështje nuk janë me të thënë, me të supozuar apo sipas një analize, ato janë vërtetë një realitet, që ka ndodhur vërtet.

Çdo person dhe çdo mysliman, në çdo vend të botës, kur triumfoi ky revolucion dhe kur Imami doli hapur në shesh dhe, kur u ngrit lart flamuri i Islamit dhe dëshmia “La ilahe il’la Allah” - “Nuk ka tjetër Zot veç Allahut”, atëherë e kanë ndier triumfin. Nga ky tubim i madh, një miliard

muslimanë, në katër anët e botës, një pjesë vazhduan me këtë lloj ndjenje, shkuan pas tij dhe ndoqën rrugën e luftës dhe të përplasjes. Ndodhi që këto ngjarje u zhvendosën në shtete të ndryshme nga dora e lëvizjeve islame. Një pjesë hoqën dorë nga çështja. Edhe pse ne ishim të pranishëm brenda kufijve tanë dhe nuk kishte asnjë ndërhyrje nga jashtë, ky mesazh u përhap kudo, pasi është mesazh botëror. Gjithashtu, edhe këtu sot, përgjegjësia bie mbi ta, por populli iranian ka ngritur krye, duke vepruar maksimalisht deri më tani.¹⁵⁵

Themelimi i qytetërimit, mbi themelet e kulturës dhe të dijes

Ne vërtet, jemi në procesin e zhvillimit, të ndërtimit dhe në fillimet e themelimit të një qytetërimi. Ajo që unë dua t'ju them juve, është se kauza jonë nuk është që të shpëtojmë jetën dhe shpirtat tanë. Çështja është se populli iranian është në procesin e gjetjes së një qytetërimi. Shtylla kryesore e qytetërimit nuk ngrihet mbi industrinë, teknologjinë apo shkencën, përkundrazi, ajo ngrihet mbi kulturën, mendimin dhe njohuritë, si dhe në përsosjen mendore të njeriut.

Kjo është ajo që i ofrohet një populli dhe, gjithashtu, e miraton edhe shkenca. Ne vërtet jemi në këtë rrugë dhe në

¹⁵⁵ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në takimin me studentët e universiteteve, më 11.8.1373 sipas kalendarit iranian.

këtë drejtim. Ne kemi vendosur ta kryejmë këtë gjë. S'ka dyshim se vetë rrugëtimi historik i popullit iranien është në procesin e gjetjes së saj tij.¹⁵⁶

Qëllimi është: Forcimi i fesë së Allahut

Për hir të ringjalljes rishtazi të fesë, Islami, Imami ynë ka zgjedhur rrugën që vetë i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) e zgjodhi, d.m.th. rrugën e revolucionit. Thelbi i revolucionit është zhvillimi dhe përparimi.


Përparimi i synuar, i barabartë, i vazhdueshëm, i cili nuk njeh lodhje dhe është i mbushur me besim dhe sinqeritet. Në revolucion, nuk mjaftohesh vetëm me fjalë, me shkrime dhe shpjegime, përkundrazi, s'ka dyshim se morali dhe përparimi, si dhe dërgimi i vetvetes drejt qëllimit, është aksi dhe thelbi i tij.

Të folurit dhe të shkruarit, gjithashtu, që të dyja, janë në shërbim të këtij rrugëtimi dhe vazhdojnë kështu deri në arritjen e qëllimit, d.m.th. në forcimin e fesë së Allahut dhe zhdukjen e sundimit të mizorëve djallëzorë: **“Është Ai që e ka çuar të Dërguarin e Vet me Udhëzimin dhe Fenë e**

¹⁵⁶ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në takimin me studentët e universiteteve, më 11.8.1373 sipas kalendarit iranien

vërtetë, për ta ngritur atë mbi të gjitha fetë. Allahu mjafton si dëshmitar!”¹⁵⁷

¹⁵⁷ Sure “El Fet’h”, ajeti 28; Mesazh me rastin e përkujtimit të parë të vdekjes së Imam Khomenit (*Allahu ia shenjtëroftë sekretet*), më 10.3.1369 sipas kalendarit iranian.



QËLLIMET E MËDHA TË QYTETËRIMIT ISLAM

Ndërtimi i njeriut të përsosur dhe zbatues i modelit islam

Shkencës i është bashkuar morali

Zhvillimi i shkencës dhe lulëzimi i ekonomisë

Ndërtimi i njeriut të përsosur dhe zbatues i modelit islam

Islami ishte rilindje dhe lëvizje shpirtërore. Morali dhe synimi më i lartë i Islamit, është ndërtimi i njeriut të përsosur dhe zbatues i modelit islam.¹⁵⁸

Shkencës i është bashkuar morali

Ne, në qytetërimin islam, në qeverisjen e begatë të Republikës Islamike, e cila ecën në drejtimin e atij qytetërimi, kemi vendosur si qëllim dhe objektiv këtë çështje, që të kemi përparim në shkencë, e shoqëruar me anën shpirtërore. Duke parë ndjeshmërinë dhe alergjinë tonë perëndimore, ndaj angazhimit tonë me moralin, na kanë quajtur me emrin “fetarë fanatikë dhe të prapambetur në epokën e gurit”. Ata, dashurinë tonë për bazat e moralit dhe të anës njerëzore, e konsiderojnë si kundërshtim të të drejtave të njeriut. Në të vërtetë, arsyeja është, sepse kjo rrugë është në kundërshtim me metodën e tyre.

¹⁵⁸ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në mbledhjen e Bankës Islamike për Zhvillim, më 25.6.1383 sipas kalendarit iranien.

* “Sahifetul Imam”, vëll. 13, f. 452-453: “Të gjithë e kanë për detyrë të zgjasin dorën e ndihmës. Kjo çështje është e rëndësishme, pasi qytetërimi juaj, Islami juaj, ana juaj njerëzore, çdo gjë, ju përket juve. Ju jeni ndjekësit e tij, jeni të lidhur me të, prandaj përsosini këto gjëra.”

Ata e kanë zhvilluar shkencën. Me të vërtetë, që kjo është një çështje e rëndësishme, mirëpo ajo (shkenca) ishte e ndarë nga morali dhe ana shpirtërore dhe ndodhi ajo çfarë ndodhi.

Ne duam që shkenca të zhvillohet në mënyrë të barabartë me moralin. Universiteti, sikurse është qendër e dijes, të jetë qendër e fesë dhe e moralit. Të diplomuarit e universiteteve shkencore, në vende të ndryshme, janë sikurse të diplomuarit e seminareve akademike. Ai diplomohet si fetar prej aty. Kjo është ajo që ata (perëndimorët) as nuk e pranojnë, por as nuk e dëshirojnë një gjë të tillë.¹⁵⁹

Zhvillimi i shkencës dhe lulëzimi i ekonomisë

Edhe pse Islami ishte rilindje dhe lëvizje shpirtërore dhe morale, kurse qëllimi më i lartë i tij është shprehje e ndërtimit të njeriut të përsosur dhe zbatues i modelit islam, nuk ka asnjë dyshim se përparimi shkencor dhe lulëzimi ekonomik janë, që të dyja, prej qëllimeve të Islamit; prandaj, ju vëreni se Islami është shfaqur në pikën më të varfër të botës dhe në vendet më të prapambetura. Mirëpo, nuk

¹⁵⁹ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në takimin me infermierët, më 19.6.1376 sipas kalendarit iranian.

kaluan as pesëdhjetë vite nga jeta e tij, ai arriti të vërë nën kontroll më shumë se pesëdhjetë për qind të botës së sotme.

Nuk kaluan më shumë se dy shekuj nga jeta e këtij qytetërimit, deri sa bota islame u bë kulmi i qytetërimit njerëzor, duke përmendur këtu dijen dhe shkenca të tjera, si dhe zhvillimet ndërrurbane dhe ekonomike. Kjo gjë nuk do të ndodhte, nëse nuk do të ishin begatitë e mësimëve të Islamit, pasi Islami nuk ka bënë thirrje, që të kujdesemi vetëm për anën shpirtërore dhe të mbetemi të pavëmendshëm ndaj kryqëzimit të jetës sociale të njeriut. Ne e kemi për detyrë t'i marrim të gjitha masat e duhura, për hir të pavarësisë së ymetit islam dhe për hir të lavdisë së tij. Një nga pikat më të rëndësishme është çështja e ekonomisë.

Në bazë të kësaj, pa dyshim se të punosh për zhvillimin e aspekteve ekonomike të botës islame dhe lulëzimin e saj, është prej qëllimeve dhe objektivave të Islamit.¹⁶⁰

Puna kryesore e shtetit islam është zhvillimi i shkencës dhe i dijeve, sepse, pa pasur dije dhe shkencë, nuk shkohet kurrkund. Gjithashtu, edhe propaganda e mendimit të lirë, është e rëndësishme dhe njerëzit duhet të mendojnë në një atmosferë të lirë.

¹⁶⁰ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në mbledhjen e Bankës Islamike për Zhvillim, më 25.6.1393 sipas kalendarit iranian.

Liria e të shprehurit është ndjekëse e lirisë së mendimit. Kur ekziston liria e të menduarit, edhe liria e të shprehurit në një mënyrë natyrale bëhet e zekistente.

Vërtet, liria e të menduarit, në thelb, ia mundëson njeriut të meditojë për lirinë, kurse në një atmosferë jo të lirë të të menduarit, nuk ka asnjë mundësi përparimi. Në thelb, nuk do të ketë ndonjëherë ndonjë vend për mendimin, për shkencën, për aspektet e mëdha të zhvillimit njerëzor. Me të vërtetë, çdo përparim që ne kemi bërë në studimet teologjike dhe filozofike, ka qenë nën hijen e bisedimeve, të polemikës, të hulumtimit dhe ekzistimit të mendimit ndryshe. Problemi me të cilin ne gjithmonë përballëhim, për pjesët kulturore, është se ata, si një shtet islam, nuk e kanë kryer mirë rolin e tyre në sheshin e përplasjes ideologjike. Patjetër që duhet të ekzistojë konflikti intelektual në fund dhe jo, praktikisht, të përfundojë përplasia intelektuale në këtë formë. Ne e dëshmojmë këtë me thënien e Sa'diut: "Lëshojmë qenin të lirë dhe lidhim shkëmbin. E marrim armën nga dora e atyre që kanë të drejtë, që janë me të vërtetën dhe nga njerëzit e mendimit, që ne besojmë në vërtetësinë e tyre dhe u shtrijmë dorën njerëzve mashtrues, në atë mënyrë që ata godasin fort kokat e rinisë sonë."¹⁶¹

Le të zhvillohet një mendim i pjekur në shoqëri. Nga përvoja, kemi arritur në përfundimin se kudo që shfaqet

¹⁶¹ Përkthim i një vjershe të Sa'di Shirazit, poet i shquar iranian.

fjala e vërtetë mbi turmën, logjika dhe harmonia e saj, kurrë, asnjë fjalë nuk do të mund të qëndrojë përballë tij për ta kundërshtuar.¹⁶²

¹⁶² Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në takimin me ministrat e qeverisë, më 8.6.1384 sipas kalendarit iranian.

* "Sahifetul Imam", vëll. 6, f. 343: "Të gjithë ne jemi të angazhuar dhe përgjegjës për ta ruajtur këtë çështje. Ne kemi arritur deri këtu me Rilindjen Islame dhe i mposhtëm fuqitë. Ne, nëpërmjet kësaj rilindje, duhet të ndërtojmë që tani, d.m.th. ne duhet të ecim përpara të gjithë së bashku, që të formojmë një qytetërim të vërtetë dhe jo si qytetërimi i Muhamed Rida Shahut. Të ndërtojmë një qytetërim hyjnor, si qytetërimi i të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*). Ky qytetërim nuk nxit përçarje ndërmjet shtresave njerëzore, të bardhit apo të ziut. Të gjithë janë njësoj të barabartë me devotshmëri: 'Me të vërtetë, më i miri ndër ju, është ai më i devotshmi.' Peshorja është devotshmëria; peshorja është të qenit i njerëzishëm."

MIRËQENIA DHE URBANIZIMI

Bota e denjë për njeriun

Shpenzimi në dynja për Ahiretin

Dynjaja parë nga pikëpamja e Islamit

Sistemi islam nuk mjafton për rindërtimin e jetës ekonomike

Falënderimi për mirësinë e madhe hyjnore

Realizimi i drejtësisë dhe formimi i shoqërisë së drejtë dhe të hapur

Bota e denjë për njeriun

Bota e organizuar dhe e ndriçuar me mësimet e vyera të Profetëve të Allahut dhe me argumentet hyjnore të Tij, është bota e denjë për njeriun. Bota është e përfshirë nga urbanizimi, mirëqenia dhe përparimi shkencor dhe industrial. Gjithashtu, ajo përfshin forcën politike dhe përsosjen shpirtërore; është bota që njerëzit e ndiejnë se janë në krah të njëri-tjetrit; kanë qetësinë, sigurinë dhe rehatinë, duke bërë që të çelin në të filizat njerëzore. Është ajo gjëja që nuk ekziston në botë prodhuesi i qytetërimit material, sepse, njerëzit, në botën materiale, janë sikurse ujqërit, që duhet të kenë frikë nga njëri-tjetri. Populli iranian është i vendosur, që ta bëjë ekzistuese një botë të tillë, për veten e vet, qoftë nga aspekti material, qoftë nga aspekti shpirtëror. Kjo është një luftë shumë afatgjatë.¹⁶³

Shpenzimi në dynja për Ahiretin

Në historinë e Islamit shohim se njeriu që ndërtonte, ka qenë më asketi i krijesave të Allahut. Kështu, Prijësi i besimtarëve, Imam Aliu (*Paqja qoftë mbi të!*), me duart e veta e hapte pusin dhe ndërtonte kanalin. Kur uji dilte sa qafa e devesë si burim uji, dilte prej pusit, ulej buzë tij dhe

¹⁶³ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në takimin e një grupi pjesëmarrësish, në manovrat ushtarake të rrugës së Kudsit, më 3.2.1376 sipas kalendarit iranian.

shkruante: “Këtë ujë e lë vakëf për fukarenjtë dhe e kam bërë sadaka.”

Kur ai bënte ndonjë vepër publike, e shpenzonte atë në rrugë të Allahut. Ai ishte ndër njerëzit që shpenzonte më shumë, në ndërtim, në shpërndarje të pasurisë, kurse nga aspekti shpirtëror ishte më i miri ndër ta dhe njeriu me pozitën më të lartë. Kjo çështje është rezultat i edukimit dhe tregues i programit material dhe shpirtëror të Islamit.¹⁶⁴

Dynjaja, parë nga pikëpamja e Islamit

Dynjaja, për nga pikëpamja e Islamit është paraqitëse dhe urë kalimi për në Ahiret. Islami nuk e refuzon këtë botë, nuk i nënçmon kënaqësitë e kësaj bote. Ai dëshiron që njeriu të jetë aktiv në fushën e jetës në vepra, me të gjithë forcat dhe instinktet e tij. Mirëpo, të gjitha këto së bashku, duhet të jenë në shërbim të lartësisimit të shpirtit dhe gëzimit të tij shpirtëror, që jetesa në këtë botë të jetë më e mirë, më e këndshme. Në një botë të tillë, nuk ka vend padrejtësia, as injoranca dhe grabitja. Kjo është një çështje e vështirë që kërkon shumë mund. I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i*

¹⁶⁴ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në takimin me dijetarët e fesë, më 26.2.1375 sipas kalendarit iranian.

Allahut qoftë mbi të mbi familjen e tij!) e filloi me këtë lloj lufte, që në ditën e parë.¹⁶⁵

Sistemi islam nuk mjafton për rindërtimin e jetës ekonomike

Vendi ynë sot ka shumë nevojë që atmosfera e tij e përgjithshme të jetë e tillë, që të urdhërojë për vepra të mira, ku të instalohet e drejta, e vërteta dhe drejtësia dhe të tentohen anët shpirtërore, morali i mirë.

Sistemi islam nuk mjafton për rindërtimin e jetës ekonomike dhe materiale për njerëzit. Kjo është një nga detyrat e pashmangshme islame. Mirëpo, në krah të kësaj pune është, gjithashtu, jo vetëm kryerja e veprave të mira, por edhe forcimi i frymës fetare, instalimi i moralit islam, shpirtit të vëllazërisë dhe sinqeritetit midis njerëzve në përgjithësi, si dhe ringjallja e frymës së lavdisë dhe pavarësisë. Shpirti që konverton besimin e popullit në poshtërim, përbuzje dhe ofendim, është një nga detyrat islame.

Profeti i Islamit (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të mbi familjen e tij!*) ndikonte në çdo lëvizje. Ai qetësonte dhe

¹⁶⁵ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në takimin me administratën zyrtare, më 2.7.1382 sipas kalendarit iranian.

ndryshonte zemrën e kujtdo që takonte, qoftë nën hijen e stabilizimit të sistemit islam, ashtu edhe nëpërmjet edukimit individual. Ndryshimi i njerëzimit, është thelbi i të gjitha shndërrimeve në botë.¹⁶⁶

Sot, ne kemi për detyrë të përpiqemi dhe të derdhim djersë me çfarë kemi mundësi për t'u përgatitur fizikisht dhe shpirtërisht për menaxhimin e çështjeve të vendit, duke i ngarkuar njerëzit me punë drejt jetës islame. Jetë islame nuk do të thotë t'i japësh rëndësi anës shpirtërore, duke lënë mënjanë atë materiale, sikurse ajo nuk do të thotë të kujdesesh më shumë për anën materiale, përpos principeve bazë dhe moralit.

Po kështu është edhe ana tjetër e çështjes, d.m.th. një shoqëri angazhohet vetëm me aspektet shpirtërore dhe ka lënë pas dore shkencat dhe dijen, përparimin shkencor, zbulimet dhe shpikjet shkencore, arritjen akademike ndërmjet bijve të vatanit dhe ndërtimin e njeriut, që mund ta bëjë jetën të përshtatshme dhe në harmoni me nevojat e njerëzimit.

Edhe pavëmendja, hutimi për lehtësinë dhe shpejtësinë që kërkon bota sot, do të jetë, gjithashtu, krahu tjetër i thyer i saj. Askush të mos e imagjinojë se Islami anon kah izolimi dhe kufizimi i çdo gjëje për çështjet shpirtërore

¹⁶⁶ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në tubimin kulturor, në kampin ushtarak (uluvij'june), më 21.8.1380 sipas kalendarit iranien.

dhe të moralit dhe se ai (Islami) nuk i jep rëndësi çështjeve materiale. Jo, kurrsesi jo, ky është devijim dhe është i madh sa përmasat e devijimit të parë. Islami e ka refuzuar shumë qartë vetizolimën ndaj dynjasë dhe jetës.¹⁶⁷

Falënderimi për mirësinë e madhe hyjnore

Këto zemra janë në dorë të Allahut. S'ka dyshim se kujdesi i njerëzve, pjesëmarrja e tyre, prania dhe vendosmëria e tyre, dëshira dhe vullneti i tyre, janë prej mirësive të mëdha hyjnore, që na janë dhurua neve. Ne e kemi për detyrë të falënderojmë për këto gjëra. Falënderimi për këto, bëhet nëpërmjet përpjekjeve tona dhe mundësive tona, në rrugën e rregullimit dhe përsosjes së problemeve të jetës, si rrjedhim, duke forcuar besimin fetar te njerëzit.¹⁶⁸

Realizimi i drejtësisë dhe formimi i shoqërisë së drejtë dhe të hapur

Drejtësia sociale është një nga çështjet e duhura në atmosferën e politikës së brendshme. Pa realizimin e

¹⁶⁷ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në takimin me studentët e universiteteve, më 24.9.1372 sipas kalendarit iranian.

¹⁶⁸ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në takimin me administratën publike, më 20.3.1380 sipas kalendarit iranian.

drejtësisë sociale, nuk do të ekzistojë shoqëria jonë islame. Nëse dikush mendon se feja e vërtetë hyjnore, nuk është vetëm feja islame, që mund të vërtetohet pa qenë nevoja e miratimit të drejtësisë sociale në të, me kuptimin e saj real dhe të gjerë, atëherë ai person le ta dijë mirë se është në dyshim.

Nuk ka asnjë dyshim se qëllimi i Profetëve është instalimi i drejtësisë së vërtetë: **“Ne i çuam të Dërguarit Tanë me prova të qarta dhe bashkë me ta zbritëm Librat (e shenjtë) dhe peshoren (e drejtësisë): që njerëzit të veprojnë drejt.”**¹⁶⁹

Profetët kanë ardhur që të vënë drejtësinë. Sigurisht, vënia e drejtësisë është një nga stacionet në rrugë dhe nuk është objektivi përfundimtar, mirëpo, kur ata erdhën, puna e parë e tyre ishte vënia e standardit të drejtësisë, si dhe çlirimi i njerëzve nga e keqja e padrejtësisë, nga shtypja e mizorit dhe e zullumqarëve. Edhe qëllimi i qeverisë së mbrojtësit të kohës sonë (*Allahu e shpejtoftë ardhjen e tij fisnike!*) në fundin e kohës (afër Kiametit), gjithashtu, do të jetë instalimi i drejtësisë hyjnore.¹⁷⁰

¹⁶⁹ Sure “El Hadid”, ajeti 25.

¹⁷⁰ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në takimin me punonjësit zyrtarë, më 9.11.1368 sipas kalendarit iranian.

RRUGA E MBËRRITJES DREJT QYTETËRIMIT ISLAM

Rruga që zgjidhet me devotshmëri

Rilindja dhe revolucioni islam

Qëllimi kryesor është: Ringjallja rishtas e Islamit

Vetëm sundimi i Islamit

Morali dhe rruga e kërkuar për guvernatorët myslimanë

Zyrtarët duhet të bëhen myslimanë

Kuptimi i qeverisë islame

Karakteristikat e shtetit islam

Begatitë e shtetit islam

Shteti islam është premisa e formimit të botës islame

Ne mund t'i forcojmë shtyllat e qytetërimit islam

Rruga që zgjidhet me devotshmëri

Qeveria islame lind nga shteti islam. Kur ekziston shteti islam, lind qytetërimi islam. Në kohën kur kultura islame do të përfshijë të gjithë atmosferën e njerëzimit, të gjitha këto janë një operacion që do ekzistojë nëpërmjet vetëkontrollit dhe devotshmërisë, individuale dhe të bashkësisë, ymetit.¹⁷¹

Rilindja dhe revolucionin islam

Ne duam formimin e atij sistemi dhe qeverie që mund të realizojë këto objektiva: Përhapja e parimeve hyjnore dhe ndjekjen e tyre.

Ky është një proces shumë i gjatë dhe i mbushur me vështirësi. Fillimi i tij nis me revolucionin islam. Revolucionin që ne synojmë, nuk është në kuptimin e luftës dhe përleshjes apo shkaktimin e trazirave e të tjera ngjashëm me të. Revolucioni bëhet, kur zhduken themelet e gabuara dhe në vend të saj vendosen shtyllat e të vërtetës. Ky është hapi i parë.¹⁷²

¹⁷¹ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në hytben e namazit të xhumasë, në Teheran, më 28.5.1384 sipas kalendarit iranian.

¹⁷² Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në takimin me punonjës të administratës publike, më 12.9.1379 sipas kalendarit iranian.

Kur revolucioni bëhet fakt i kryer, pas saj vjen menjëherë formimi i sistemit islam.

Sistem islam do të thotë zbatim i projektit inxhinierik dhe dizajnit islam në një vend. Njësoj sikurse u bë, kur u zhduk nga vendi ynë sistemi trashëgues individual mbretëror tiran, klientelist dhe aristokrat dhe vendin e tij e zuri sistemi qeverisës fetar, popullor dhe me devotshmëri, me zgjedhje të lira.

Në këtë mënyrë të përgjithshme, realizohet ajo që e ka përcaktuar vetë kushtetuta, d.m.th. sistemin islam.

Ne kemi vendosur dhe kemi themeluar një sistem qeverisës islam, bazat e të cilit janë personalizuar. Themelet e qeverisë janë të qarta. Përgjegjësit dhe udhëheqësit duhet të jenë tre ekzekutivët me detyra të përcaktuara. Detyrat që u janë dhënë në përgjegjësi qeverive, janë të përcaktuara dhe të njohura.¹⁷³

Qëllimi kryesor është: Ringjallja rishtas e Islamit

Ne i kemi dhënë besën Allahut të Lartësuar, që të ndjekim rrugën e Imam Khomenit (*Allahu ia shenjtëroftë*

¹⁷³ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në takimin me punonjës të administratës publike, më 12.9.1379 sipas kalendarit iranien.

sekrete), që është rruga e Islamit, e Kur'anit dhe rruga e fuqizimit të myslimanëve. Politika: "Jo Lindjes dhe jo Perëndimit", është mbrojtja e njerëzve të dobët nëpër botë dhe atyre që u është bërë padrejtësi, mbrojtja e unitetit të ymetit të madh islam dhe marshimit të tij, tejkalimi i shkaqeve të konfliktit dhe përçarjes ndërmjet myslimanëve në nivel botëror; xihadi për hir të formimit të qytetit të preferuar islam; mbështetja dhe varësia partiake e shtresave të privuara dhe të varfra; kërkimi i të gjitha shkaqeve dhe potencialeve për të rikthyer urbanizimin e vendeve sipas standardit të brendshëm.

Justifikimi i saj është formimi i vijave kryesore të programit të saj. Synimi kryesor, pas gjithë këtyre çështjeve, është ringjallja rishtas e Islamit, si dhe rikthimi vlerave të larta të Kur'anit. Ne të mos lëvizim as fijen e flokut ndaj këtij qëllimi.¹⁷⁴

Vetëm sundimi i Islamit

Armiqtë, nëpërmjet përgatitjes së terrenit dhe mashtrimit propagandues, përpiqen të jenë të kujdesshëm ndaj emrit të qeverisë islame dhe sistemit qeverisës islam. Ndoshta disa mendjelehtë mendojnë se më e mira në këtë

¹⁷⁴ Fragment nga deklarata për haxhilerët e Bejtullahit, më 14.4.1368 sipas kalendarit iranian.

çështje do ishte heqja e emrit të qeverisë islame në deklaratat tona publike, me qëllim që të mos shkaktojmë ndjeshmërinë e Amerikës dhe vendeve perëndimore. Këshilla ime për ju është tërheqja serioze ndaj këtij mendimi, që është e kundërta e interesit islam. Kujtoni qëllimin e formimit të sistemit islam, qëllimin e sundimit të Kur'anit dhe Islamit. Mos i lakmoni armiqtë nëpërmjet refrenit të emrit "Islami i shenjtë", as mos turbulloni dhe as mos e bëni të paqartë këtë çështje.¹⁷⁵

Morali dhe rruga e kërkuar për guvernatorët myslimanë

Pasi erdhi sistemi sundues islam, radha i erdhi formimit të qeverisë islame, në kuptimin e saj të vërtetë. Thënë me një shprehje më të qartë, u formua sjellja e udhëheqësve, si dhe metoda që do të ndjekin ata.

Meqenëse kjo, në pamje të parë, nuk është në dispozicion, duhet të ekzistojë gradualisht nëpërmjet përpjekjes. Drejtuesit dhe njerëzit e shtetit e kanë për detyrë ta ndjekin dhe të zbatojnë vetë kushtet që lidhen me përgjegjësin islam; ose do të vijnë në pushtet njerëz të tillë, nëse ata ekzistojnë, ose, nëse ata janë të paplotësuar, të ecin

¹⁷⁵ Fragment nga deklarata për haxhilerët e Bejtullahit, më 26.3.1370 sipas kalendarit iranian.

vetë në drejtim të përsosjes dhe të përparojnë. Kjo është faza e tretë, që ne shprehemi me formimin e qeverisë islame.

Sistemi islam ka ardhur më parë. Tani qeveria duhet të bëhet islame. Qeveri, në kuptimin e saj të përgjithshëm, nuk do të thotë organet e këshillit të ministrave, d.m.th. janë tri fuqi: zyrtarët e vendeve, udhëheqësi dhe masa.¹⁷⁶

Zyrtarët duhet të bëhen myslimanë

Hapi tjetër që është edhe më i vështiri i këtyre çështjeve (formimi i revolucionit islam dhe sistemit islam), është formimi i qeverisë islame, jo në kuptimin e këshillit të ministrave, por me kuptimin e grupit të punonjësve në qeveri, d.m.th. unë dhe ju. Në kuptimin e vërtetë të fjalës. Ne e kemi detyrë që të bëhemi islamë brenda këtij sistemi islam. Kjo është faza më e vështirë, se sa ato të mëparshmet.

Kuptimi i qeverisë islame

Faza tjetër e sistemit islam, është qeveria islame. Ne, gjithashtu, e kemi zgjedhur këtë rrugë, marrjen e përgjegjësisë për çështjet e vendit, njëri pas tjetrit, prej

¹⁷⁶ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në takimin me zyrtarët e administratës publike, më 12.9.1379 sipas kalendarit iranien.

zyrtarëve besimtarë, ministra dhe deputetë të mirë, kryetarë shteti besimtarë.

Mirëpo qeveria islame, e cila ka fuqi për të realizuar qëllimet e popullit iranian dhe revolucionit të madh, është shteti që brenda tij nuk ekziston ryshfeti, as korrupsioni administrativ. I thotë jo favoreve, i thotë jo neglizhencës dhe shpërfilljes, i thotë jo mungesës së kujdesit për popullin, i thotë jo përparësisë së pronës private, i thotë jo grabitjes së thesarit të shtetit, si dhe çështje të tjera që janë të domosdoshme për shtetin islam.¹⁷⁷

Ne nuk mund të pretendojmë se jemi një qeveri islame, sepse jemi neglizhentë dhe mospërfillës. Detyra jonë është të ndërtojmë veten tonë dhe të ecim përpara; detyra jonë është të edukojmë veten tonë në fillim. Sigurisht, nëse në krye të qeverisë qëndron imami ynë i pagabueshëm, prijësi i besimtarëve, fjala, vepra dhe rruga e të cilit është model, puna bëhet edhe më e lehtë për punonjësit e sistemit, sepse modeli i përsosur ekziston në mesin e tyre dhe udhëzimi ekziston në të gjitha çështjet e tij.

Ju nuk keni një person të tillë, që ta shikoni me këtë optikë dhe të jetë një model për ju. Mirëpo normat janë në

¹⁷⁷ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në hytben e namazit të xhumasë, në Teheran, më 28.5.1384 sipas kalendarit iranian.

dispozicionin e të gjithëve ne dhe të gjithë ne sot, pa përjashtim, jemi përgjegjës.¹⁷⁸

Karakteristikat e shtetit islam

Faza e katërt, pas kësaj, është shteti islam. Nëse qeveria bëhet islame, në kuptimin e vërtetë të fjalës, në atë moment, edhe shteti bëhet islam, në kuptimin e vërtetë të fjalës. Vendoset drejtësia, i jepet fund diskriminimit, gradualisht zhduket varfëria, realizohet fuqia e vërtetë e popullit dhe në marrëdhëniet ndërkombëtare ngrihet në pozitë të lartë. Ky është vendi islam.¹⁷⁹

Begatitë e shtetit islam

Ne jemi një popull islam. Ne, me vendosmëri të palëkundur, arritëm të sjellim në këtë vend një sistem qeverisës, që është në harmoni me besimin dhe doktrinën e tij. Po cili është qëllimi i këtij sistemi?

¹⁷⁸ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në takimin me zyrtarët e administratës publike, më 12.9.1379 sipas kalendarit iranian.

¹⁷⁹ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në takimin me zyrtarët e administratës publike, më 12.9.1379 sipas kalendarit iranian.

Qëllimi ishte që ky shtet, nëpërmjet këtij sistemi, të përfitojë nga të gjitha të mirat, zhvillimet dhe begatitë që Allahu i Lartësuar ua ka premtuar popujve besimtarë.

Shtet islam do të thotë shteti ku Islami qeveris në të, i jep jetë. Islami që motivon aktivitetin, vë në lëvizje; Islami që është i zhveshur nga mendimi i devijuar, nga ngurtësimi; Islami që është i zhveshur nga kapja; Islami që i nxit njerëzit; Islami udhëzues i njerëzimit drejt shkencës dhe njohurisë; Islami me të cilin është vepruar me të në shekullin e parë; Islami që një grup i përçarë e çoi në majën e qytetërimit botëror historik, si dhe qytetërimi dhe shkenca e tij të dominojë mbarë botën. Dominimi shkencor tërheq pas vetes fuqinë politike, mirëqenien ekonomike dhe virtytet e moralit. E gjitha kjo qëndron, nëse shteti bëhet islam, në kuptimin real të fjalës.¹⁸⁰

Mirëpo deri tani nuk kemi arritur të shteti islam dhe askush nuk mund të pretendojë se ne jemi një vend islam.¹⁸¹

¹⁸⁰ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në hytben e namazit të xhumasë, në Teheran, më 28.5.1384 sipas kalendarit iranian.

¹⁸¹ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në takimin me zyrtarët e administratës publike, më 12.9.1379 sipas kalendarit iranian.

Shteti islam ëshë premisë për formimin e botës islame

Kur ne e tejkalojmë këtë fazë, pas saj vjen bota islame. Prej shtetit islam bëhet e mundur, formimi i botës islame. Modeli që u realizua, e bën të mundur ekzistencën e shembujve të ngjashëm në botë.¹⁸²

Ne mund t'i forcojmë shtyllat e qytetërimit islam

Populli iranian do ekzistojë, sikurse ka ekzistuar edhe më parë, me falënderimin e Allahut dhe kështu do të jetë pas kësaj, një rojtar i mirë i unitetit të tij të rëndësishëm dhe ndërgjegjes së vet, vigjilencës dhe lidhjes së tij të fortë me përgjegjësit, zyrtarët, sepse ka pasur përherë në krye të këtij sistemi qeverisës, zyrtarë të duhur që punojnë në shërbim të këtij populli.

Qeveria e Republikës Islamike, do ta mundësojë vendosjen e themeleve të qytetërimit islam në këtë vend, madje në të gjitha vendet shtete islame apo shoqëritë islame.¹⁸³

¹⁸² Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në takimin me zyrtarët e administratës publike, më 12.9.1379 sipas kalendarit iranian.

¹⁸³ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në takimin me zyrtarët e administratës publike, 6.2.1376 sipas kalendarit iranian.

FAKTORËT QË NDIKUAN NË ARRITJEN E QYTETËRIMIT ISLAM

*Mbajeni të gjallë dritën e shpresës
Pritshmëria lëviz me mall dhe shpresë
Mbështetja te Mehdiu është ringjallje e frymës së shpresës
Me ndihmën e besimit, ne mundemi
Përcaktimi i të ardhmes është në dorën e njeriut
Përfitimi nga përgatitjet dhe aftësitë
Të punosh me sinqeritet dhe besnikëri
Thirrja për të lëvizur dhe për t'u ngritur në këmbë
Qëndrueshmëria është kusht i arritjes së qytetërimit islam
Drejtësia dhe korrektësia e Profetit Muhamed (Paqja e bekimi i
Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!)*
Lidhja me Allahun
*Profeti Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi
familjen e tij!) kërkonte gjithmonë ndihmë nga Allahu i Lartësuar*

Mbajeni të gjallë dritën e shpresës

Ne gjithmonë duhet ta ruajmë dhe ta mbajmë të gjallë në zemrat tona dritën e shpresës. Nëpërmjet dritës së shpresës dhe përpjekjes, do të arrijmë qëllimin.¹⁸⁴

Ne ecim duke zbatuar ligjet që vetë i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) ka ecur me to në fazat më të vështira të jetës së tij. Ai shpresonte dhe ecte me të. Kështu, në po të njëjtën ditë që e rrethuan, jo vetëm jeta e tij ishte në rrezik, por i gjithë kombi i tij në Mekë, u detyrua të shkonte në Taif. Një ditë tjetër, në lagjen e Ebu Talibit, ai thoshte: **“Pa dyshim, unë jam i dërguar i besuar për ju.”**¹⁸⁵

Në varësi të çfarë çështjeje i tha këto fjalë? Duke u mbështetur tek Allahu dhe ligjet hyjnore, si dhe te luftimet që ai ishte i vendosur t’i bënte. Edhe ne, gjithashtu, ecim duke u mbështetur në po këto ligje. Përse ta humbim shpresën?

Ai mundi ta bëjë, edhe ne, gjithashtu, mund ta bëjmë. Ai arriti të ndryshojë historinë dhe e vuri botën për qindra vite nën ndikimin e ligjeve dhe rregullave të tij. Edhe ne,

¹⁸⁴ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në takimin me përfaqësues nga segmente të ndryshme të shoqërisë, në qytetin e Kunit, më 19.10.1371 sipas kalendarit iranian.

¹⁸⁵ Sure “Eh Shuara”, ajeti 125.

gjithashtu, po të ecim në të njëjtën rrugë, do t'ia arrijmë qëllimit.¹⁸⁶

Pritshmëria lëviz me mall dhe shpresë

Pritje për besimtarin, do të thotë bindje dhe besim, se mendimi hyjnor, mendimi i ndritur që ka zbritur si shpallje për njerëzit, një ditë do ta përfshijë tërësisht jetën njerëzore. Një nga dimensionet e pritshmërisë, është se pritshmëria lëviz me mall dhe shpresë. Pritje do të thotë: shpresë, por edhe pritja, gjithashtu, ka dimensione të tjera, të ndryshme.¹⁸⁷

Një nga dimensionet e pritshmërisë, është besimi dhe shpresa për të ardhmen, si dhe mungesa e pesimizmit. Vetë shpirti i pritjes i mëson njeriut luftën në rrugën e mirësisë dhe të drejtësisë. Nëse nuk do të ekzistonte pritja dhe shpresa, beteja nuk do të kishte kuptim dhe, nëse nuk do të ekzistonte besimi në të ardhmen, atëherë edhe pritshmëria

¹⁸⁶ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në takimin me Gardën Revolucionare Islamike, më 10.12.1368 sipas kalendarit iranian.

¹⁸⁷ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në takimin me përfaqësues nga segmente të ndryshme të shoqërisë, më 11.2.1369 sipas kalendarit iranian.

nuk do kishte kuptim. Pritja e vërtetë është në harmoni me qetësinë shpirtërore dhe besimin.¹⁸⁸

Mbështetja te Mehdiu është ringjallje e frymës së shpresës

Fuqitë e mëdha botërore sot po përpiqen të sprovonjë popujt myslimanë, me frymën e dëshpërimit, deri sa të thonë: “Kjo nuk mund të ndodhë! Nuk bën më dobi pas kësaj!” Ata duan të mbjellin me forcë dëshpërimin te njerëzit. Pjesë e kësaj politike të fuqive të mëdha, është edhe populli iranian.

Nëse ne biem në humnerën e lajmeve propagandistike dhe helmuese të armiqve, do të shohim me sytë tanë se shumica e lajmeve që ata lëshojnë, bëhen vetëm për të mbjellë dëshpërim në shpirtin e bijve të popullit. Përse? Kjo bëhet me qëllim që t’ua marrin furinë e zemërimit dhe të shpresës nga ky grupim njerëzish që punojnë dhe veprojnë me shpresë dhe t’i shndërrojnë ata në krijesa të vdekura apo të ngjashme me të vdekurit, me

¹⁸⁸ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në takimin me përfaqësues nga segmente të ndryshme të shoqërisë, më 22.12.1368 sipas kalendarit iranian.

qëllim që kjo t'ua mundësojë atyre (armiqve) të bëjnë atë që dëshirojnë.

Me një popull të gjallë, ata nuk mund të bëjnë çfarë duan. Por me një trup që ka humbur ndërgjegjen dhe ka rrjedhur, që ka humbur shqisën e ndjenjës dhe është lënë në një cep, çdokush mund t'i injektojë çfarë të dojë. Mirëpo armiqët nuk mund të bëjnë atë që dëshirojnë, nëse ekziston një njeri aktiv, i gjallë, i ndërgjegjshëm.

Tek ata shpirtra jeton bindja dhe besimi, bashkë me shpresën te Mehdiu i shenjtë e i premtuar. Nuk ka asnjë dyshim se njeriu i bindur në këtë origjinë, nuk e njeh kurrë dëshpërimin. Përse? Sepse ai e di mirë se fundi do të jetë i lumtur, nuk ka kthim pas, kështu që ai përpiqet dhe ecën drejt saj.¹⁸⁹

Me ndihmën e besimit, ne mundemi

Ky është besimi që mund të shkatërrojë qeveritë djallëzore dhe faraonët, sikurse ka ndodhur më parë, i ka shkërmoqur. Kush mund t'i imagjinonte ditët e shfaqjes së Islamit, se një grupim i vogël, i dobët e i shtypur, në një cep

¹⁸⁹ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në takimin me përfaqësues nga segmente të ndryshme të shoqërisë, më 25.9.1376 sipas kalendarit iranian.

të Mekës, do të mundej, që me begatinë dhe mirësinë e këtyre ajeteve hyjnore, të themelojë një nga qytetërimet më të mëdha të asaj kohe, që do të ngrinte lart dhe do të zhvillonte qytetërimin njerëzor dhe do sillte këtë sundim dhe ymet madhështor.¹⁹⁰

Ajo do të mbetet përherë kështu, e fortë, përgjatë gjithë kohës.

Një pjesë e njerëzve ka menduar se shumë shpejt, çdo gjë, do të shfaroset: **“Gjithashtu, (Ai e bëri këtë) për t’i ndëshkuar hipokritët dhe hipokritet, idhujtarët e idhujtaret, që mendojnë keq për Allahun.”**¹⁹¹

Ata mendonin se i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*), në shumë ngjarje që ndodhën, nuk do të kishte sukses: **“Jo! Ju menduat se i Dërguari dhe besimtarët nuk do të kthehen kurrë te familjet e tyre dhe zemrat tuaja ishin të kënaqura me këtë trill. Ju ushqyet mendime shumë të këqija dhe kështu u bëtë popull i pavlefshëm i nisur drejt shkatërrimit.”**¹⁹²

Ata kanë mendim të keq për Allahun, nuk i japin rëndësi dhe vlerë brendisë së fesë. Ata janë **“popull i pavlefshëm i nisur drejt shkatërrimit”**.

¹⁹⁰ D.m.th. ymeti dhe shoqëria e madhe islame.

¹⁹¹ Sure “El Fet’h”, ajeti 6.

¹⁹² Sure “El Fet’h”, ajeti 12.

Ne, myslimanët, nuk duhet të arrijmë deri në këtë cak. Kur'ani mund ta udhëzojë njeriun, mund ta nxjerrë nga një njeri: **“Me të vërtetë, njeriu është në humbje.”**¹⁹³ dhe ta çojë te një njeri tjetër: **“Atëherë ti, o njeri, që përpiqesh shumë, mundin tënd do ta gjeshe te Zoti yt.”**¹⁹⁴

Ai ecën drejt Allahut dhe do të arrijë te Ai.¹⁹⁵

Përcaktimi i të ardhmes është në dorën e njeriut

Nuk ka dyshim se njohja e njerëzve që zgjedhin këtë rrugë dhe e marrin me forcë dhe atyre që e kundërshtojnë atë dhe nuk përfitojnë nga të mirat e saj, është e lidhur me dëshirën e njerëzimit dhe zgjedhjen e tyre. Janë vetë ata që zgjedhin fatin dhe të ardhmen e tyre. Mirëpo kjo rrugë është vënë para njerëzve.¹⁹⁶

Përfitimi nga përgatitjet dhe aftësitë

¹⁹³ Sure “El Asr”, ajeti 2.

¹⁹⁴ Sure “El Inshikak”, ajeti 6.

¹⁹⁵ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në takimin me punonjësit që do iknin në Haxh, më 25.10.1381 sipas kalendarit iranian.

¹⁹⁶ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në takimin me administratën publike, më 20.3.1380 sipas kalendarit iranian.

Sigurisht, në çdo periudhë kohe, çdo individ dhe çdo grupim i njerëzimit përfiton prej saj (misionit) sipas përgatitjeve dhe aftësive të tyre.

Myslimanët e parë përfituan nga koncepti i misionit dhe i të vërtetës së tij, duke përhapur dritën e saj ndriçuese në çdo cep të botës në atë periudhë kohe dhe të udhëzojnë shumë njerëz në rrugën e drejtë, duke i tërhequr ata drejt të vërtetës së adhurimit. Pas kësaj, në një moment të kohës, ata arritën të themelonin atë qytetërim, atë madhështi dhe dituri në botë. Çështjet që edhe sot i mbetet shkëlqimi, shikohet nga pas perdeve të historisë dhe distancave të gjata kohore. Bota akoma vazhdon të shijojë mirësitë e atij zhvillimi shkencor, industrial, ideologjik, enciklopedik. Në të gjitha periudhat e kohës, gjithashtu, kurdo që myslimanët kanë mundur të përfitojnë mirësinë e duhur nga Islami, janë lumturuar dhe çdo njeri ka arritur të përfitojë sipas përgatitjes që ka pasur. Kjo ka tërhequr lumturinë drejt vetes së tij.¹⁹⁷

Të punosh me sinqeritet dhe besnikëri

Vëllezër të dashur! Ky ajet lidhet me një nga betejat që ka luftuar i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë*

¹⁹⁷ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në takimin me administratën publike, më 26.8.1377 sipas kalendarit iranian.

mbi të e mbi familjen e tij!): “(Shpërblim kanë edhe ata) të cilëve njerëzit (hipokritë) u thanë: ‘Shumë njerëz po mblidhen kundër jush, prandaj frikësohuni!’ e kjo gjë ua shtoi atyre besimin dhe thanë: ‘Neve na mjafton Allahu, Ai është mbrojtës i mrekullueshëm!’”¹⁹⁸

Allahu na mjafton ne. Ai na mbron: **“Neve na mjafton Allahu, Ai është mbrojtës i mrekullueshëm!”** Kjo nuk mund të thuhet në vendet ku bëhet shakaja apo në dhomat e gjumit. Ne nuk bëjmë gjë me vepra dhe nuk përpiqemi, nuk bëjmë as edhe një lëvizje, si dhe nuk e ekspozojmë veten përballë rrezikut, nuk lëvizim as gishtin më të vogël dhe të themi pastaj: **“Neve na mjafton Allahu, Ai është mbrojtës i mrekullueshëm!”**

Jo, kurrësi jo, pasha Allahun e Lartësuar, nuk do të mjaftojë për atë që nuk lufton në rrugë të Tij. Kjo lidhet me fushëbetejën. Ne sot jemi në një fushëbetejë. Nëse nuk është një luftë ushtarake dhe luftë për jetë a vdekje, atëherë përse fuqitë e mëdha të botës armiqësohen kaq shumë me Islamin dhe sundimin islam? Përgjigjja është: Ne jemi aty. Çdo vepër dhe çdo ligj të mirë, e vendosim. Çdo dokument të mirë ne e bëjmë, çdo gjykim të mirë dhe çdo sjellje të mirë që shfaqet prej nesh, që të çon drejt forcimit të këtij sistemi dhe Islamit, e pranojmë. Nëse kjo lind dhe buron prej nesh, i kemi dhënë një goditje të fortë armiqve. Këtu njeriu mund

¹⁹⁸ Sure “Ali Imran”, ajeti 173.

të thotë: **“Neve na mjafton Allahu, Ai është mbrojtës i mrekullueshëm!”**

Përgjigjja e Allahut të Lartësuar do të jetë: **“Ata u kthyen me dhuntitë dhe mirësitë e Allahut, nuk i gjeti asgjë e keqe dhe fituan kënaqësinë e Allahut. Allahu është Zotërues i mirësive të mëdha.”**¹⁹⁹

Thirrja për të lëvizur dhe për t’u ngritur në këmbë

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi tëe mbi familjen e tij!*) u ka bërë thirrje njerëzve që të lëvizin dhe të qëndrojnë në këmbë. Allahu i Lartësuar, në ajetet e para që i ka zbritur të Dërguarit të Tij, ka thënë: **“Çohu dhe tërhiq vërejtjen** (duke thirrur)”²⁰⁰; *“el kijamu”-“ngritja në këmbë”* është lëvizja, dalja nga gjendja e qëndrimit shtrirë, pa lëvizur, si dhe të konsiderosh veten përgjegjës. **“Unë ju këshilloj vetëm me një gjë: Për hir të Allahut të angazhoheni sinqerisht.”**²⁰¹

Të ngrihesh dhe të angazhohesh vetëm për hir të Allahut, në të gjitha situatat e jetës njerëzore, është zgjidhja e problemeve. Pa lëvizje dhe angazhim, nuk mund të arrihet asnjë qëllim i lartë.²⁰²

¹⁹⁹ Sure “Ali Imran”, ajeti 174.

²⁰⁰ Sure “El Mudethir”, ajeti 3

²⁰¹ Sure “Sebe”, ajeti 46.

²⁰² Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në takimin me administratën publike, më 2.7.1382 sipas kalendarit iranien.

Këshilla e rëndësishme kur'anore, drejtuar atyre që akoma nuk kanë marrë përsipër të luftojnë të kotën, është: Ngrihuni e angazhohuni për hir të Allahut, dyshe-dyshe, ose vetëm. Pastaj mediton!

Kjo këshillë u drejtohet gjithmonë të gjithë besimtarëve të Allahut.

Në historinë islame, ne kemi parë njerëz, qoftë në formë individuale apo grupim, se e konsideruan detyrë angazhimin për hir të Allahut. Ata u ngritën për hir të Allahut, jo për ndonjë qëllim tjetër, e kryen detyrimin e tyre dhe morën atë që synonin dhe kishin si qëllim. Nëse nuk do të ekzistonte fryma për hir të Allahut, në mesin e myslimanëve, e cila ishte thirrja e të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) në përballjen e problemeve dhe mohimeve, Islami kurrë nuk do të triumfonte.

Nëse ne nuk do të ndienim ekzistencën e frymës së ngritjes dhe angazhimin për hir të Allahut te njerëzit dhe, nëse udhëheqësi ynë, me pozitë të lartë, nuk do të ngrihej për hir të Allahut, po të priste se çfarë do të thonë të tjerët dhe çfarë do të bëjnë, ose populli të priste për të parë planin

dhe programin e atyre, do të ishte e sigurt, që revolucioni kurrë nuk do të triumfojë.²⁰³

Islami u dha myslimanëve një mësim të mirë. Për sa kohë Islami do të ekzistojë në mesin e myslimanëve, pa dyshim se rezultati i tij do të jetë përherë shkëlqimi, sublimimi dhe lartësimi shpirtëror dhe material. Ai mësim është lufta e sinqertë në rrugë të Allahut.

Kështu që, sa herë që xihadi është i sinqertë, rezultati i tij do jetë shkëlqimi. Xihadi i sinqertë mund të jetë për hir të Allahut, por mund të jetë edhe për dikë, veç Allahut. Nëse ka qenë për hir të Allahut, do të jetë i përhershëm e nuk shuhet kurrë, por do të çohet në këmbë me një lëvizje të sinqertë për hir të Tij. Nëse nuk bëhet për hir të Tij, atëherë nuk do të zgjasë shumë; ose mund të jetë dashurues i zjarrit të vatanit të vet dhe çohet për të bërë një lëvizje të sinqertë për hir të vatanit. Këto lëvizje nuk kanë jetëgjatësi, por mund të mbeten për sa kohë të ekzistojë entuziazmi dhe ndjenjat për të. Sapo kjo ndjenjë ftohet, qoftë edhe sa madhësia e një atomi, ai i hap sytë e tij dhe i thotë vetes: “Unë të shkoj drejt vdekjes? Le ta hajë filani! Le të thyejë qafën ai!”

Ndërsa, kur xihadi është për hir të Allahut, çështja nuk do të jetë e tillë. Sa më shumë të shtohet mprehtësia e

²⁰³ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në hytben e namazit të xhumasë, në Teheran, më 16.3.1359 sipas kalendarit iranian.

logjikës te njeriu, aq më shumë shtohet xihadi i tij. Kjo ndodh, sepse: **“Gjithçka që keni ju, është kalimtare, ndërsa ajo që ndodhet tek Allahu, është e përhershme. Vërtet, Ne do t’i shpërblejmë ata që kanë duruar sipas veprave më të mira që kanë bërë.”**²⁰⁴

Ajo që ne prezantuam për hir të Allahut, është e përhershme.²⁰⁵

Qëndrueshmëria është kusht i arritjes së qytetërimit islam

Nuk ka dyshim se thelbi i qëndrueshmërisë dhe i rezistencës te një popull, është i çmuar dhe shumë i shtrenjtë. Me këtë substancë, nëpërmjet udhëzimit hyjnor dhe furnizimeve të panjohura shpirtërore, si dhe lutjeve të mençura e udhëzimeve shpirtërore të mikut të madh të Allahut, popullit iranian do t’i mundësohet, me vullnetin e Allahut, që të ngrejë lart pozitën e qytetërimit islam edhe një herë tjetër në këtë botë, si dhe të ndërtojë qytetërimin madhështor islam. Kjo është e ardhmja juaj. Vetë rinia duhet ta llogarisë vetë veten në këtë lëvizje madhështore, kurse

²⁰⁴ Sure “En Nahl”, ajeti 96.

²⁰⁵ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në takimin me komandantët e Gardës Revolucionare, më 29.6.1373 sipas kalendarit iranian.

forcat besimtare e të sinqerta, këtë çështje duhet ta bëjnë qëllimin e tyre.²⁰⁶

Drejtësia dhe korrektësia e Profetit Muhamed *(Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!)*

Drejtësia dhe korrektësia e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) ishte një drejtësi që historia e njëzimit s'ka pasur ndonjëherë të dytë si ajo. Ai nxori në dritë një drejtësi, nëpërmjet të cilës arriti të themelojë këtë ndërtesë të fortë hyjnore të përhershme. Po a do të mund të realizohej kjo, pa qenë drejtësia dhe korrektësia? Me drejtësinë e tij u bë e mundur kjo; me drejtësinë e tij, i edukoi shokët e tij. Me drejtësinë dhe korrektësinë e tij, ai arriti që në atë vend, ku askush nuk e imagjinonte, të ndërtojë çadrën e përhershme të qytetërimit njerëzor, në mesin e shkretëtirës së egër të Hixhazit: **“Andaj, ti thirru dhe bëhu këmbëngulës, ashtu siç je urdhëruar...”**²⁰⁷

Allahu i Lartësuar i flet Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) në suren

²⁰⁶ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në takimin me të liruarit nga burgu dhe të plagosurit, më 29.5.1376 sipas kalendarit iranian.

²⁰⁷ Sure “Esh Shura”, ajeti 15; Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në hytben e e namazit të xhumasë, në Teheran, më 23.2.1379 sipas kalendarit iranian.

“Hud”, në ajetin 112: **“Prandaj qëndro i patundur në udhën e drejtë, ashtu siç je i urdhëruar. Ashtu le të veprojnë edhe besimtarët që janë me ty, e mos i kaloni kufijtë, se Ai, me të vërtetë, i sheh mirë ato që punoni ju.”**

Në një transmetim të Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*), thuhet: “Flokët m’i ka zbardhur surja ‘Hud’.”²⁰⁸

Kur është pyetur se cila pjesë e saj ia ka zbardhur, është përgjigjur: “Ky ajet: **‘Prandaj qëndro i patundur në udhën e drejtë, ashtu siç je i urdhëruar.’**”

Përse u zbardhën flokët e të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*)? Arsyeja është: Ky ajet thotë: Qëndro fort dhe përqendrohu në këtë rrugë, sikurse je urdhëruar dhe bëj durim.

Vetë qëndrueshmëria është një çështje e vështirë. Kjo është “rruga e drejtë”, rruga që na e kanë përshkruar ajetet që flasin për Ditën e Kiametit. Pa dyshim se puna dhe vepra jonë e brendshme dhe rruga jonë në këtë dynja, është vetë rruga e drejtë. Ne vërtet tani ecim në këtë rrugë, por kemi detyrë të ruajmë saktësinë. Nëse njeriu dëshiron të ruajë saktësinë në çdo vepër të tij, atëherë s’ka dyshim se përfundimi është zbardhja e flokëve. Më e rëndësishmja nga të gjitha këto, sipas optikës sime, është fjalia që vjen më

²⁰⁸ “El Muhakkiku El Erdebili”, Zubdetul Bejan, f. 167.

poshtë: **“Ashtu le të veprojnë edhe besimtarët që janë me ty.”**

Nuk ka qenë i urdhëruar vetëm Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) që të qëndrojë drejt. Urdhërohen edhe besimtarët të qëndrojnë me vendosmëri në këtë rrugë. Njerëzit, nga njëra anë, përballen me sulmet e fatkeqësive dhe problemet e jetës: armiqtë, komplotistët, agresorët, fuqitë dominuese, kurse nga ana tjetër, janë burim i sulmit të pasioneve të tyre psikologjike: dëshirat psikologjike të njeriut dhe shpirtit të tij të padurueshëm, që anon dhe pëlqen bukuritë dhe stilitë e kësaj bote, tërhiqet prej tyre. Ata shmangen nga kjo rrugë e drejtë, majtas apo djathtas. Nuk ka dyshim se dashuria për ar dhe argjend, dashuria për pasurinë dhe pasionet seksuale, si dhe dashuria për pozitën dhe ngjashëm me të, vendosin një lak në qafën e njeriut dhe e tërheqin atë drejt tyre.

Pa dyshim se rezistenca dhe qëndrueshmëria përballë këtyre çështjeve, si dhe vendosmëria e fortë e besimtarëve në rrugën e drejtë, duke bërë që këmba e njeriut të mos rrëshqasë midis këtyre dy forcave të mëdha tërheqëse, tërheq presionet e armiqve dhe presionin psikologjik të zemrës skllavëruese të pasioneve.

Udhëzimi i tyre, sipas mendimit të shumicës së dijetarëve, ia ka zbardhur flokët të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*).²⁰⁹

Lidhja me Allahun

Sigurisht, në këtë rrugë, ne e kemi për detyrë, të mos harrojmë drejtimin dhe lidhjen me Allahun e Lartësuar. Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) ka qenë gjithmonë në një gjendje përgjërimi, drejtimi dhe lutje ndaj Allahut të Madhëruar. Me të vërtetë, të kërkosh nga miku më i madh, Allahu, dhe të lidhesh me zemër me Të, është prej funksioneve tona. Forcimi i anës shpirtërore, lidhja me Allahun dhe kushtimi i vëmendjes dhe rëndësisë së dhikrit, lutjes dhe kërkesës, janë prej detyrave tona. Nuk ka dyshim se forcimi i lidhjes me Allahun, përpjekja për çështjet e kësaj bote, më së shumti nga kërkimi i diturisë, njohurisë dhe përpjekjes në rrugën e ndërtimit, ndërgjegjja për çështjet politike dhe ekonomike dhe ruajtja e shpresës, të gjitha këto, janë faktorë dhe cilësi që me dritën e Republikës Islamike të Iranit, do të shkëlqejnë të ardhmen e afërt dhe do të bëjnë që njerëzimi të kënaqet dhe të përfitojë nga begatitë e Islamit.

²⁰⁹ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në takimin me ndjekësit e tij, më 6.1.1385 sipas kalendarit iranian.

Popullin iranian do ta bëhet dëshmitar i unitetit njerëzor në faqen e tokës.²¹⁰

Profeti Muhamed (Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!) kërkonte gjithmonë ndihmë nga Allahu i Lartësuar

Në kohët e vështira, ai nuk e ka vënë re se përgjërimi dhe kërkesa e ndihmës së tij ndaj Allahut do të linte një përshtypje në mendjet e dëgjuesve dhe shikuesve të tij, sepse ai është vetë i dobët. Ai e thoshte hapur dhe qartë shprehjen: “Unë vetë jam i pafuqishëm dhe nuk mund të bëj asgjë, pa ndihmën e Allahut të Lartësuar.”

Në Betejën e Ah’zabëve, armiqtë kishin rrethuar Medinen, të Dërguarin e Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*), bashkë me besimtarët. Ata donin ta çrrënjosnin Islamin, Kur’anin dhe rendin e ri me gjithë rrënjë. I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) ra në gjunjë përpara syve të njerëzve, ngriti duart lart drejt qiellit dhe filloi të përgjërohet e të lutet: “O Zoti im! Na ndihmo! Shtriye triumfin Tënd dhe na jep ne sukses!”²¹¹

²¹⁰ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në takimin me përfaqësues nga segmente të ndryshme të shoqërisë, më 19.10.1371 sipas kalendarit iranian.

²¹¹ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në takimin me përfaqësues të Këshillit të Kuvendit Islam, më 29.3.1379 sipas kalendarit iranian.

NDJEKJA E MODELIT PROFETIK

Të veprosh sipas ligjeve të Islamit; rruga e mbërritjes drejt qëllimit

I tillë ishte Imam Khomeni (Allahu ia shenjtëroftë sekretet!)

*Shtyllat e Republikës Islamike, në qasjen e Imam Khomenit
(Allahu ia shenjtëroftë sekretet!)*

Të veprosh sipas ligjeve të Islamit; rruga e mbërritjes drejt qëllimit

Kjo lindje (lindja e Profetit) ka qenë mëshirë e Allahut për historinë e njerëzimit. Kur'ani, në lidhje me ekzistencën e Profetit, është shprehur: **“Ne nuk të kemi dërguar ty (o Profet), veçse si mëshirë për botët.”**²¹²

Kjo mëshirë është e pakufishme, që përfshin: edukimin, pastrimin, të mësuarit, udhëzimin e njerëzve në rrugën e drejtë, si dhe përparimin e njerëzve në fusha të ndryshme të jetës materiale dhe shpirtërore. Ajo nuk është e veçantë vetëm për njerëzit e asaj periudhe kohe, por lidhet me gjithë historinë: **“Ai do ta dërgojë atë edhe tek të tjerë (myslimanë) nga ata, të cilët ende nuk u janë bashkuar.”**²¹³

Mënyra e mbërritjes drejt qëllimit është veprimi me njohuritë e Islamit dhe ligjet e tij, të cilat janë vendosur për njerëzimin.²¹⁴

²¹² Sure “El Enbija”, ajeti 107.

²¹³ Sure “El Xhumu’a”, ajeti 3.

²¹⁴ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në takimin me administratën publike, më 29.2.1382 sipas kalendarit iranian.

I tillë ishte Imam Khomeni (Allahu ia shenjtëroftë sekretet!)

Imam Khomeni (Allahu ia shenjtëroftë sekretet!), nëpërmjet xhihadit dhe hixhretit që bëjnë besimtarët në kufijtë e shtetit hyjnor, u bë një dëshmi tjetër e ajetit kur'anor: **“Vërtet, ata që besuan dhe mërguan (për hir të besimit), e më pas luftuan me pasurinë dhe jetën e tyre në rrugën e Allahut...”**²¹⁵

Me përballjen e tij ndaj rrezikut, duke flijuar shpirtin e tij në rrugë të Allahut, ai u vu në ballë të njerëzve që Allahu i ka lavdëruar aq shumë: **“Ka njerëz që e flijojnë veten, për të fituar pëlqimin e Allahut. Allahu është shumë i mëshirshëm me robtë e Vet.”**²¹⁶

Nëpërmjet qëndrimit të tij historik, në rrugë të Allahut dhe përpjekjes së pandërprerë e të pashembullt për të vendosur drejtësinë e vërtetë dhe çlirimin e njerëzve të pambrojtur nga padrejtësia dhe diskriminimi, ai iu përgjigj thirrjes hyjnore: **“O ju që keni besuar! Bëhuni të qëndrueshëm në urdhrat e Allahut!”**²¹⁷
“O ju që keni besuar! Bëhuni zbatues të palëkundur të drejtësisë, duke dëshmuar në Emër të Allahut!”²¹⁸

²¹⁵ Sure “El Enfal”, ajeti 72.

²¹⁶ Sure “El Bekare”, ajeti 207.

²¹⁷ Sure “El Maide”, ajeti 8.

²¹⁸ Sure “En Nisa”, ajeti 135.

Një përgjigje që ngjall krenarinë, zemërimin dhe pafajësinë e idhujtarëve dhe mohuesve kokëfortë, si dhe mëshirën dhe dashurinë për myslimanët e botës, e bëri një dëshmi të vërtetë e të plotë të ajetit kur'anor: **“Muhamedi është i Dërguar i Allahut. Ata që janë me të, janë të ashpër ndaj jobesimtarëve e të mëshirshëm midis tyre.”**²¹⁹

Kurse nëpërmjet kërkimit të ndihmës, faljes së mesnatës dhe përgjërimit të singertë, ai hyri në rrugën: **“Është e vërtetë se Zoti yt do të të vendosë ty në një vend të lavdëruar.”**²²⁰

Ai urdhëronte për të bërë vepra të mira dhe i ndalonte të këqijat. Ishte një luftëtar në rrugë të Allahut.

Duke prerë të gjitha lidhjet që nuk harmonizohen me dashurinë për të vërtetën, ai u bë dëshmues i ajetit²²¹: **“Nuk gjen njerëz, që besojnë në Allahun dhe në Ditën e Fundit, që të ushqejnë dashuri ndaj atyre, të cilët kundërshtojnë Allahun dhe të Dërguarin e Tij, edhe në qofshin ata etërit e tyre ose bijtë e tyre, ose vëllezërit e tyre, ose farefisi i tyre. Allahu ka skalitur besimin në zemrat e tyre dhe i ka fuqizuar ata me Shpalljen e Vet. Ai do t'i shpjerë ata në kopshte, nëpër të cilat rrjedhin lumenj e ku do të qëndrojnë përgjithmonë. Allahu është i kënaqur me ata,**

²¹⁹ Sure “El Fet’h”, ajeti 29.

²²⁰ Sure “El Isra”, ajeti 79.

²²¹ Nga një mesazh për popullin fisnik iranian, në mbyllje të ceremonisë përkujtimore dyzet ditore të Imam Khomenit (*Allahu ia shenjtëroftë sekretet!*), më 23.4.1368 sipas kalendarit iranian.

por edhe ata do të jenë të kënaqur me Të. Ata janë Pala e Allahut dhe, vërtet që Pala e Allahut do të jetë fituese.”²²²

Shtyllat e Republikës Islamike, në qasjen e Imam Khomenit *(Allahu ia shenjtëroftë sekretet!)*

Nuk ka asnjë dyshim se shtyllat e Republikës Islamike, e cila është përqasja e vetë Imamit dhe themelet e forta të Islamit, në Iranin islam, kanë rëndësi dhe janë themelet e jetës sonë politike dhe ekonomike, pavarësisht armiqve të fuqishëm. Populli iranien nuk do të heqë dorë, në asnjë rrethanë, nga jeta nën hijen e Islamit muhamedan, i cili ka arritur gjer këtu me sakrificat të shumta dhe duke dhënë shpirtin e njerëzve më të dashur. Pa dyshim se parimet e Imam Khomenit *(Allahu ia shenjtëroftë sekretet!)*, me në krye parimin e mosndarjes midis fesë dhe politikës, rezistencën ndaj shtypjes civile, për të izoluar Islamin dhe Kur’anin, do të mbeten përherë parimet e gjalla të Republikës Islamike të Iranit.²²³

²²² Sure “El Muxhadele”, ajeti 22.

²²³ Fragment nga deklarata e udhëheqësit për hanxhinjtë, më 28.2.1372 sipas kalendarit iranien.

ARSIMIMI DHE KËRKIMI I TË DREJTËS

Pyetja paraprin mbërritjen drejt të vërtetës

Faktorët e ruajtjes së qytetërimit islam dhe zhvillimi i tij

Përkushtimi fanatik ndaj besimit

Lufta e ftohtë dhe pa zhurmë

Lufta dhe vendosmëria

Asketizmi dhe mosdhënia rëndësi kësaj bote

Kur në botë nuk ekzistonte asnjë lajm për diturinë, mësimin, të mësuarin, leximin, gjurmë të mësimnxënies dhe

të mësuarit, Islami dhe Kur'an i ynë e filluan me fjalën *“lexo”* dhe është betuar për lapsin dhe shkrimin, ka çliruar të burgosurit e luftës në këmbim të disa fjalëve që do u mësonin myslimanëve. Kjo çështje u referohet katërmbëdhjetë shekujve të kaluar.

Veprat e Islamit dhe të Profetit tonë të bekuar, Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*), bënë të mundur që shoqëria arabe analfabete, (analfabet quhet ai njeri i paarsimuar: **“Është Ai që u solli të analfabetëve një të Dërguar nga gjiri i tyre, për t’u lexuar atyre Shpalljet e Tij, për t’i pastruar e për t’u mësuar Librin dhe Urtësinë, ndonëse ata më parë ishin vërtet në humbje të plotë.”**²²⁴, në një kohë që Evropa ka qenë e rrethuar nga pesha e injorancës), të bëhet një shoqëri që ka në gjirin e saj universitete të mëdha dhe dijetarët më në zë. Shembujt janë të shumtë, si: Farabei, Ibn Sina, Muhamed bin Zekeria, Raziu, Ebu Rejhan el-Bejruni, etj.

Pra, luftimi i injorancës dhe nxitja për dije, arsim, bëri që kjo shoqëri të përparojë në shtatë apo tetë shekuj ndaj gjithë botës së sotme. Sigurisht, pas kësaj kohe, ne kemi mbetur shumë prapa. Myslimanët u bënë përtacë dhe gjendja është këtu ku jemi sot. Mirëpo ne tani, mund ta rifillojmë nga e para. Revolucioni u ndez përsëri dhe Islami

²²⁴ Sure “El Xhumu’a”, ajeti 2.

u rikthye në arenën e jetës dhe akoma nuk i ka dhënë një kuptim analfabetizmit.²²⁵

Sikurse Islami ka pasur lëvizjen më të rëndësishme në drejtim të dijes, emocionit dhe nxitjes më të madhe për të, u shfaq qytetërimi Islam, me ndihëm e lëvizjes shkencore, e cila filloi që nga dita e parë e shfaqjes së Islamit. Nuk kaluan as dy shekuj nga shfaqja e Islamit, kur doli në pah lëvizja shkencore islame. Kjo ndodhi në atë mjedis.²²⁶

Kjo është njohuria, dija që përfundoi në shkencë dhe e çoi shoqërinë islame në shkallën më të lartë të qytetërimit shkencor.²²⁷

Pyetja paraprin mbërritjen drejt së vërtetës

²²⁵ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në takimin me përfaqësues nga segmente të ndryshme të shoqërisë, më 4.7.1369 sipas kalendarit iranian.

²²⁶ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në takimin me elitat e popullit dhe studentë të universiteteve, më 5.7.1383 sipas kalendarit iranian.

²²⁷ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në hytben e namazit të xhumasë, në Teheran, më 18.2.1377 sipas kalendarit iranian.

Interpretimi është pararojë e orientimit të përhershëm të njerëzimit dhe çelësi i tij. Sikur të mos ekzistonte te njeriu lënda e interpretimit, dhe e kërkimit të së vërtetës, bota nuk do të kishte asnjë udhëzim dhe nuk do të zgjidhej asnjë rrugë drejt përsosjes. Kjo është një çështje e natyrshme te njerëzit, pasi interpretimi dhe pyetja janë pararojë dhe çelës i hulumtimit për të vërtetën, për të mbërritur drejt saj dhe për të gjetur shtegun, si rrjedhojë, edhe mbërritja, lidhja dhe realizimi i asaj që dëshirohet.²²⁸

Islami është nxitësi më i madh i dijes, i shkencës edhe sot. Lufta shkencore është një nga detyrat tona më të mëdha.²²⁹

Faktorët e ruajtjes së qytetërimit islam dhe zhvillimi i tij

Vëllezër të dashur! Unë po ju them se ajetet 8-9 janë së bashku. Ajeti: **“Allahu është Ai që e ka çuar të Dërguarin e Vet me udhërrëfimin dhe Fenë e së Vërtetës, për ta ngritur atë më lart se të gjitha fetë, edhe nëse nuk e**

²²⁸ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në takimin me komisionin e fëmijëve dhe botuesit, në radion e Republikës Islamike të Iranit, më 1.2.1371 sipas kalendarit iranian.

²²⁹ Mesazh, me rastin e rifillimit të hapjes së universiteteve, më 6.7.1378 sipas kalendarit iranian.

pëlqejnë idhujtarët.”²³⁰, thotë se Islami, nën hijen e faktorëve të tij subjektivë, për të cilat kemi thënë se, në njërën anë, ato janë logjike dhe argumentuese, kurse, në anën tjetër, janë drejtësi sociale, që do të dominojnë botën, jo nëpërmjet kompleteve, as me anë të shpatës, as nëpërmjet punëve që përpiqen të bëjnë përherë armiq të Islamit, jo vetëm në vende të tjera, por edhe Republikën tonë islame. Përkundrazi, do ta dominojnë nëpërmjet rrugës së logjikës dhe zbatimit të drejtësisë. Ky ajet thotë: **“Ata dëshirojnë të fikin dritën e Allahut me gojën e tyre, por Allahu e përsos dritën e Vet, edhe nëse (këtë gjë) e urrejnë jobesimtarët.”**²³¹

Le të kërcënojnë si të duan, sepse Allahu i Lartësuar e konsideron kurthin e armiqve të dobët përballë Islamit. Nuk vlen vetëm për komplotin e mohuesve Kurejsh në kohën e Profetit Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*). Kjo nënkupton të gjitha kurthet e armiqve kundër Republikës Islame, d.m.th: bllokadën ekonomike dhe komplotet propagandistike të përhapura në çdo vend, si dhe presionet politike dhe takimet e vazhdueshme sioniste, të bashkuara me fuqitë e tjera armike të Republikës Islame, duke punuar ditë e natë kundër kësaj Republike, i përfshin të gjitha këto çështje.

²³⁰ Sure “Es Saff”, ajeti 9.

²³¹ Sure “Es Saff”, ajeti 8.

Kur'ani na thotë në këmbim të angazhimit të këtij populli me Islamin dhe rrugën e Allahut, në këmbim të unitetit të këtij populli dhe lidhjes me njëri-tjetrin, në këmbim të dëshirës së zjarrtë që ka kapluar këtë popull, që ditën e parë është ecja në rrugë të Allahut dhe Kur'anit, në këmbim të qëndrimit në rrugë të drejtë të këtij populli dhe durimit të tij, mençurisë dhe ndërgjegjes së tij, pa dyshim se të gjitha këto forca, të gjitha këto komplete dhe të gjitha këto dredhi, të gjitha këto armiqësi janë të destinuara të dështojnë.²³²

Përkushtimi fanatik ndaj besimit

Nuk ka asnjë dyshim se qëllimi i sistemit qeverisës, që ngrihet mbi bazë të misionit profetik, është lumturia e njerëzimit dhe një jetesë e rehatshme e tyre. Kjo nuk realizohet ndryshe vetëm se nëpërmjet atyre dy qëllimeve (duke i dhënë rëndësinë vlerave shpirtërore dhe drejtësisë). Nëse kjo realizohet, atëherë armiqësitë nuk do të kenë asnjë lloj ndikimi. Shumë njerëz mund të pyesin se çfarë ka ndodhur deri tani? Kanë ekzistuar dy fuqi të mëdha. Secila prej tyre thurte komplete kundër nesh dhe nuk ka arritur të fusë në dorë Republikën Islamike. Edhe sot, kur njëra nga

²³² Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në një grup vizitorësh në varrin e Imam Ridait, më 1.1.1376 sipas kalendarit iranian.

ato fuqi është shuar dhe ka mbetur tjetra, as ajo, edhe as klientët e saj, qoftë vendet e zhvilluara, qoftë ato të dobëtat, të cilat kanë pranuar të bashkëpunojnë me Amerikën nëpërmjet portës së përbuzjes dhe poshtërimit, kurrë nuk do të munden t'i japin ndonjë goditje të fortë Republikës Islamike të Iranit. Sekret i kësaj është besimi, kujdesi i njerëzve për fenë, duke treguar përgjegjësi për të, si dhe pranimi i anës shpirtërore në jetën e njerëzve. Kjo ndjenjë vjen, me qëllim që sistemi qeverisës i shoqërisë të ecë në drejtimin e drejtësisë.²³³

Lufta e Ftohtë dhe pa zhurmë

Lufta e butë është sikurse lapsi²³⁴, punon qetë dhe pa shkaktuar zhurmë. Një nga mënyrat e luftës së ftohtë ka qenë shndërrimi i rinisë besimtare e të përkushtuar me besimin, e cila është faktor i ruajtjes së një qytetërimi. Këtë çështje e kanë ndjekur në Andaluzi në shekujt e mëparshëm, d.m.th. rininë, në gjithë botën, e angazhuan dhe e futën në korrupsion (*fesad*), duke ndjekur pasionet dhe epshet, duke pirë alkool, e të tjera të ngjashme me këto. Edhe sot, ata punojnë në këtë drejtim.

²³³ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në takimin me administratën publike, më 29.9.1374 sipas kalendarit iranien.

²³⁴ Udhëheqësi, këtë luftë e krahason me punën e lapsit, i cili shkruan qetë, pa zhurmë dhe pa pengesë.

Kur të ushëtitjë, mos e thëntë Zoti, zëri i shkatërrimit të besimit, i shkaktuar nga lufta e fshehtë e armiqve, nëse ju o popull dhe forca kulturore, nuk jeni vigjilentë, nuk do ketë më rrugë tjetër për kurim, për sa kohë të ekzistojnë organizata që shkatërrojnë lulen e rinisë. Armiqtë sot punojnë për këtë çështje.²³⁵

Lufta dhe vendosmëria

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*), asnjëherë nuk është frikësuar të përballlet me botën, të mbushur me padrejtësi, qoftë kur ka qenë i vetëm në Mekë, qoftë kur rrotull tij ishte grumbulluar një pakicë shumë e vogël besimtarësh. Ai qëndronte ballëlart përballë prijësve mendjemëdhenj arabë dhe fisnikëve arrogantë Kurejsh, moralit të tyre të keq. Ai e tha fjalën e tij të vërtetë, e përsëriti fjalën, e shpjegoi atë, e sqaroi, i përballoi përbuzjet, vështirësitë dhe problemet, derisa arriti të tërheqë një numër të madh njerëzish në fenë islame. Njësoj, qoftë kur e themeloi qeverinë islame dhe e pranoi vetë qeverisjen, si një kryetar i kësaj qeverie. Po atë ditë, i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) ishte i rrethuar nga armiq dhe kundërshtarë të

²³⁵ Fragment nga fjalim i udhëheqësit, në takimin me zyrtarët e Drejtorisë së Arsimit dhe Edukimit, më 21.5.1371 sipas kalendarit iranien.

ndryshëm, fise arabe të armatosura. Primitivizmi ishte i përhapur në të gjitha anët e shkretëtirës së Hixhazit dhe thirrja islame e kishte për detyrë t'i pajtonte ata, kurse ata e luftonin, mbretërit e mëdhenj të botës në atë kohë, dy fuqitë e mëdha të asaj kohe, d.m.th. perandoria perse dhe perandoria romake.

I Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) te të dyja këto perandori dërgoi mesazhe, u solli argumente dhe iu adresua, vuri në lëvizje ushtritë, i përballoi vështirësitë, vuajti një bllokadë ekonomike. Situata te banorët e Medines arriti deri aty, sa mund të kalonin dy apo tri ditë pa ngrënë ushqim, për t'ua marrë frymën fare.

Profeti Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*) u rrethua nga shumë vështirësi në çdo drejtim. Kjo gjë shkaktoi frikë dhe tmerr te një pjesë.

Një pjesë tjetër u trondit, kurse një pjesë u ankua. Të tjerë nisën të nxisin Profetin Muhamed (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*), që të bëhet më i butë. Mirëpo i Dërguari i Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*), për asnjë çast, nuk u përkul në fushën e thirrjes dhe luftës së këtyre të dy fuqive dhe me forcë përparoi, bashkë me shoqërinë islame, derisa arriti kulmin e fuqisë dhe të forcës.

Vetë, pra, sistemi dhe shoqëria, në pak vite, me mirësinë dhe vendosmërinë e të Dërguarit të Allahut (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*), në fushat e betejës dhe të thirrjes në Islam, arriti të shndërrohej në fuqinë dhe forcën e parë në botë.²³⁶

Asketizmi dhe mosdhënia rëndësi kësaj bote

Të gjitha këto pohime dhe rekomandime, që i shohim në transmetime të ndryshme, në librin “Nehxhul Belaga”, në hadithet e Profetit të bekuar (*Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!*), tek Imamët dhe njerëzit e mëdhenj të fesë, rreth asketizmit në dynja dhe mosdhënies rëndësi bukurive të saj, nga ana e individit, ndodhin për shkak të ndikimit të madh të këtij faktori. Sigurisht, armiqtë e Islamit dhe myslimanët me mendime të devijuara, kanë menduar, ose kanë demonstruar se Islami, me thirrjen e tij drejt asketizmit, ka bërë thirrje për ta braktisur këtë botë, me kuptimin e manifestimeve të botës së ekzistencës, ndërkohë që nuk ka qenë kjo çështja. Përkundrazi, qëllimi ishte bota e keqe, e dënueshme, e qortueshme, si dhe ajo që unë dhe ju i kemi venë qëllim vetes sonë dhe interesave materiale, duke mos renduar pas tyre. Kjo është ajo që të çon drejt fatkeqësisë, drejt shkatërrimit dhe është thelbi i të gjitha të këqijave.

²³⁶ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në takimin me nëpunësit e administratës publike, më 15.8.1378 sipas kalendarit iranien.

SHMANGIA E DISKRIMINIMIT

Ruajtja e unitetit shoqëror

Përçarja dhe konflikti, faktor i dobësimit të myslimanëve

Vëllezërit tanë të dashur dhe ndjekësit e medh'hebit të Ehli Bejtit, në çdo vend të botës qofshin, nuk duhet ta harrojnë kurrë këtë çështje, gjetjen dhe kërkimin i unitetit dhe dashuri-respektit me grupimet e tjera islame. Mos i lini armiqtë t'ju shfrytëzojnë, mos i lejoni të dobësojnë vëllazërinë dhe t'ju bëjnë që të shtypni njëri-tjetrin me duart tuaja: **"Bindjuni Allahut dhe të Dërguarit të Tij dhe mos u grindni ndërmjet jush, sepse do të humbni guximin e do t'ju lërë fuqia. Bëhuni të durueshëm, se Allahu, me të vërtetë, është me të durueshmit."**²³⁷

Ju duhet t'i konsideroni të gjithë ata që janë në botën islame si vëllezërit tuaj. Sistemi qeverisës i Islamit, sot, është i ekspozuar ndaj rrezikut të armiqve, kurse rrënja e fesë, sot, i ekspozohet shtypjes dhe kërcënimit, nga ana e fuqive të mëdha botërore.^{238*}

²³⁷ Sure "El Enfal", ajeti 46.

²³⁸. ragment nga fjalimi i udhëheqësit, në takimin me pjesëmarrësit e Konferencës Botërore të Ehli Bejtit, më 4.3.1369 sipas kalendarit iranien.

* "Sahfetul Imam", vëll. 1, f. 374-375: "Ata mendojnë se, nëpërmjet këtij dominimi dhe nëpërmjet unitetit të shteteve islame, nuk është e mundur t'i bëjnë gjërat që dëshirojnë. Nuk është i mundur dominimi apo kontrolli ndaj lëndëve narkotike të tyre, naftës apo floririt të tyre, prandaj edhe nxituan të gjenin zgjidhje, që ishte përçarja e shteteve islame."

Ruajtja e unitetit shoqëror

Këshilla ime tjetër për ju është: Përpiquni të ruani unitetin në rang të përgjithshëm të bijve të shoqërisë.

Nëse Islami nuk mbështet mbi disa shtresa, duke i respektuar siç e meritojnë, sikurse janë mësuesit, dijetarët e fesë, punëtorët, fermerët etj, atëherë kjo nuk nënkupton se Islami praktikon kastën (shtresëzimin). Jo, kurrësi jo! Islami e kundërshton shtresëzimin dhe ndarjen në grupe. Besimtarët, me shtrirjen e familjes së madhe islame, janë vëllezër dhe ajo që i lidh ndërmjet tyre, është lidhja vëllazërore. Të gjithë njerëzit, pa përjashtim, duhet ta ruajnë këtë lidhje në nivelin e shoqërisë sonë sociale dhe prej këtej, edhe standardin e ymetit të madh islam.²³⁹

Përçarja dhe konflikti, faktor i dobësimit të myslimanëve

Kjo humbje e fuqisë dhe poshtërim, që një pjesë e shteteve islame janë sprovuar sot, e ka burimin te përçarja dhe konflikti ndërmjet vetes të tyre. Nëse myslimanët do të

²³⁹ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në takimin me punëtorët, më 5.4.1368 sipas kalendarit iranian.

ishin sfidues, Palestina nuk do të ishte në gjendjen që është sot, as Bosnja nuk do të kishte pësuar atë që pësoi, po as Kashmiri, as Taxhikistani. As myslimanët e Evropës nuk do të jetonin me vuajtje, por edhe myslimanët e Amerikës nuk do të përjetonin një padrejtësi të tillë. Shkaku mund të jetë përçarja jonë.²⁴⁰

²⁴⁰ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, në takimin me përfaqësues nga segmente të ndryshme të shoqërisë, më 14.6.1372 sipas kalendarit iranian.

LOGJIK A DHE DREJTËSIA

Shkaqet e triumfit të Islamit ndaj të gjitha feve të botës

Qëllimi i sistemit qeverisës islam është: Vendosja e drejtësisë islame

Shkaqet e triumfit të Islamit ndaj të gjitha feve të botës

Janë edhe dy shkaqe të tjera, nëpërmjet të cilave Islami jo vetëm mund të triumfojë ndaj të gjitha feve të botës, por edhe të tërheqë drejt vetes të gjitha zemrat dhe të hedhë poshtë çdo logjikë të rremë që përballlet me të. Po cilat janë këto dy shkaqe?

Shkaku i parë është shprehja e logjikës së fortë, e argumenteve të sakta, me të cilat zbukurohet Islami.

Shkaku i dytë është shprehje e drejtësisë, në kuptimin e vërtetë të fjalës.²⁴¹

Qëllimi i sistemit qeverisës islam është: Vendosja e drejtësisë islame

S'ka dyshim se synimi më urgjent, në formimin e sistemit qeverisës islam, është vendosja e drejtësisë sociale dhe drejtësisë islame. Me këtë qëllim kanë ardhur edhe Profetët, kanë zbritur librat dhe peshorja hyjnore, që është çlirimi i njerëzve nga presioni i padrejtësisë, i zullumit, i diskriminimit, që ata të jetojnë nën hijen e drejtësisë dhe të

²⁴¹ Fragment nga fjalimi i udhëheqësit, me grupet e vizitorëve, në varrin e Imam Ridait, më 1.1.1376 sipas kalendarit iranian.

marrin përsosmëritë njerëzore në kufijtë e atij sistemi të drejtë qeverisjeje.

Thirrja drejt sistemit islam, pa asnjë mëdyshje e vendosur dhe puna e vazhdueshme në rrugën e drejtësisë sociale, është një thirrje e mangët, jo e plotë, madje e gabuar dhe mashtruese. Çdo sistem qeverisës, sado i copëtuar të jetë me manifestime islame, nëse realizimi i drejtësisë dhe shpëtimi i njerëzve të dobët e të privuar nuk është në krye të listës së projekteve të saj, atëherë ajo qeveri është jo-islame dhe hipokrite. Prej këtui, është marrë në konsideratë pretendimi i mbretërve dhe i sundimtarëve, të cilët, pavarësisht ekzistencës së thirrësve myslimanë dhe ndjenjës së Kur'anit, ndoqën rrugën e mizorëve të tjerë zullumqarë, duke zgjeruar largësinë midis të varfrit dhe të pasurit. Vetën e tyre e radhitën në krah të pasanikëve, duke i neglizhuar dhimbjet e fukarenjve dhe të këmbëzbathurve, qoftë përgjatë historisë, qoftë në kohën e sotme. Kjo sjellje e tyre është konsideruar tradhti, si nga ana e ndërgjegjes, ashtu edhe nga ana e vigjilencës botërore, sipas njohurive dhe dijeve të Kur'anit dhe Islamit.²⁴²

²⁴² Mesazh, me rastin e përvjetorit të parë të vdekjes së Imam Khomenit (*Allahu ia shenjtëroftë sekretet!*), më 10.3.1369 sipas kalendarit iranian.

Përmbajtja

HYRJE.....	5
PËRSHKRIMI I QYTETËRIMIT NË FILLIM TË ISLAMIT.....	10
Themelimi i qytetërimit islam.....	12
Reflektimi në histori, është një faktor për ndërtimin e të ardhmes.....	14
Përgatitja e themelimit të qytetërimit islam.....	15
Rigjallërimi i një qytetërimi madhështor nga Saharaja.....	15
Propozimi i një modeli gjithëpërfshirës dhe të përhershëm: I Dërguari i Allahut ndërton modelin.....	16
Marrja e mesazhit hyjnor dhe zbatimi i tij.....	17
Mesazhi i lirisë, vigjilenca dhe lumturia.....	18
Zemrat e flakëruara të banorëve të Medines.....	19
SHTYLLAT E FORMIMIT TË QYTETËRIMIT.....	21
Besimet dhe mendimet e vërteta.....	22
Edukimi i karaktereve - Parimet dhe themelet e njerëzimit.....	22
Nga njerëz injorantë, të paditur, në personalitete madhështore, dritëdhënëse.....	24
Formimi i qelizave të trupit të ymetit islam.....	24
Rëndësia e kohës së rinisë në sistemin islam.....	25

Ndërtimi i kombit.....	26
NJOHURITË THELBËSORE NË SISTEMIN E QEVERISË SË TË DËRGUARIT TË ALLAHUT.....	28
Njohuria e parë: Qartësia.....	29
Njohuria e dytë: Drejtësia absolute dhe gjithëpërfshirëse.....	29
Njohuria e tretë: Adhurimi i plotë, pa asnjë ortakëri (shirk).....	32
Njohuria e katërt: Pasioni dhe dashuria për Allahun.....	34
Njohuria e pestë: Rekomandimi i njerëzve dhe arsimimi i tyre.....	37
Njohuria e gjashtë: Xhihadi dhe sakrifica në rrugë të Allahut.....	39
KARAKTERSTIKAT E SISTEMIT PROFETIK.....	41
Treguesi i parë: Besimi dhe ana shpirtërore.....	42
Treguesi i dytë: Paanshmëria dhe drejtësia.....	42
Miratimi i ligjit të drejtësisë shoqërore.....	43
Qëndrimi i paanshëm, që në çastet e para.....	45
Treguesi i tretë: Shkenca dhe njohuria.....	46
Treguesi i katërt: Kthjelltësia dhe vëllazëria.....	46
Treguesi i pestë: Përmirësimi i mënyrës së sjelljes dhe moralit.....	47
Treguesi i gjashtë: Lavdia dhe fuqia.....	48
Treguesi i shtatë: Puna, lëvizja dhe zhvillimi i vazhdueshëm.....	48
Tërësia e ligjeve dhe e rregullave për botën.....	51
UDHËHEQJA FETARE E POPULLIT.....	53
Udhëheqja fetare e popullit në qeverinë profetike.....	54

Sistemi islam është i ndërtuar mbi ligjet kur'anore dhe udhëzimin e Allahut.....	56
Votimi i popullit dhe zgjedhja e tij në kuadër të drejtësisë.....	57
Modeli qeveritar, bazuar mbi ekuilibrat e jurisprudencës.....	57
Filozofia e përgjegjësisë në sistemin islam.....	59
Ndryshimi midis pavarësisë popullore perëndimore dhe pavarësisë popullore fetare.....	60
E drejta e zgjedhjes së popullit, e ka burimin te ligji i Allahut.....	61
Caktimi i drejtuesit të komunitetit, mbi bazën e treguesve hyjnorë.....	63
Mbikëqyrja është veçori vetëm e Allahut të Lartësuar.....	65
Përmbajtja e vërtetë e Gadijrit.....	67
LIDHJA MES NJERËZVE DHE UDHËHEQËSVE.....	70
Vilajeti është lidhja më e fortë me njerëzit.....	71
Vilajeti hyjnor është një lidhje me njerëzit.....	73
Lidhja e përhershme e Prijësit të besimtarëve me popullin.....	74
Qeveria e vërtetë popullore në kohën e ardhjes së imam Mehdiut.....	75
FAKTORËT E ZHVILLIMIT TË QYTETËRIMIT ISLAM.....	76
Sekreti i zhvillimit të Islamit në periudhën e injorancës (xhahilijetit).....	77

Besimi me zemër është faktori i zhvillimit të myslimanëve.....	78
Mos dhënia përparësi vetes dhe interesave personale.....	79
Qëllimet kryesore janë: shpirti dhe Islami.....	80
Qëndrueshmëria dhe përballja e sinqertë.....	82
Të bësh durim ndaj vështirësive rraskapitëse.....	83
Sekreti i vazhdimet të lëvizjes islame.....	84
Uniteti i fjalës.....	85
Të vepros për të kundërshtuar, është gabim.....	87
Zemrat janë drejtuar kah uniteti.....	88
Vuajtjet e botës islame.....	89
Si u gjet qytetërimi islam?.....	90
Çlirimi nuk bëhet me shpatë, por me “armën” e mëshirës.....	92
EPOKAT E QYTETËRIMIT ISLAM.....	94
Bota islame, nga Andaluzia deri në Kinë.....	95
Faktori i triumfit të revolucionit të Islamit të parë.....	97
Përfitimi prej mësimave hyjnore.....	99
QENDRAT E QYTETËRIMIT ISLAM.....	101
Mungesa e besimit e brezit aktual të qytetërimi islam.....	102
Dituria dhe shkenca e Evropës i detyrohet qytetërimit andaluzian.....	103
FAKTORËT E DOBËSIMIT TË QYTETËRIMIT ISLAM.....	106
Kushtet e lartësimit.....	106
Politika e bërjes së Iranit model si Andaluzia.....	107
Dobësimi i besimit dhe dhënia përparësi pasionit.....	109

SHMANGIA NGA THEMELET E FESË DHE MENAXHIMI I SHOQËRISË.....	112
Ndarja e fesë nga politika.....	113
Kthimi i shikimit të moraleve islame në politikë.....	115
Ndryshimi i standardeve dhe dobësimi i vlerave.....	118
Parandalimi i konvertimit të standardeve hyjnore.....	119
Mbjellja e konfliktit dhe përçarja e unitetit të rreshtit.....	120
Mosmarrëveshja: Helmi shkatërrues i popujve.....	121
INJORIMI I MADHËSHTISË SË YMETIT ISLAM.....	123
Jurisprudenca islame është trashëgimia më e rëndësishme islame.....	124
Qytetërimi perëndimor është ushqyer nga qytetërimi islam.....	125
RINDËRTIMI I QYTETËRIMIT ISLAM.....	126
Ndërtimi i qytetërimit mbi themelin e qytetërimit profetik.....	127
Toka e Shpalljes hyjnore, themelimi i qytetërimit islam.....	127
Revolucioni Islamik ndoqi rrugën e Profetit më të madh, Profetit Muhamed (<i>Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!</i>).....	128
Qëllimi: Ta jetosh jetën e mirë islame.....	129
Revolucioni Islamik bëri që Islami origjinal muhamedan të zërë vendin e Islamit amerikan.....	130
Të durosh të gjitha fatkeqësitë, për hir të Islamit.....	131
Një lëvizje brenda kufijve, për një mesazh botëror.....	132
Revolucioni ynë është një ditë e re, për të gjithë popujt myslimanë.....	133

Themelimi i qytetërimit, mbi themelet e kulturës dhe të dijes.....	134
Qëllimi është: Forcimi i fesë së Allahut.....	135
QËLLIMET E MËDHA TË QYTETËRIMIT ISLAM.....	137
Ndërtimi i njeriut të përsosur dhe zbatues i modelit islam.....	138
Shkencës i është bashkuar morali.....	138
Zhvillimi i shkencës dhe lulëzimi i ekonomisë.....	139
MIRËQENIA DHE URBANIZIMI.....	143
Bota e denjë për njeriun.....	144
Shpenzimi në dynja për Ahiretin.....	144
Dynjaja parë nga pikëpamja e Islamit.....	145
Sistemi islam nuk mjafton për rindërtimin e jetës ekonomike.....	146
Falënderimi për mirësinë e madhe hyjnore.....	148
Realizimi i drejtësisë dhe formimi i shoqërisë së drejtë dhe të hapur.....	148
RRUGA E MBËRRITJES DREJT QYTETËRIMIT ISLAM.....	150
Rruga që zgjidhet me devotshmëri.....	151
Rilindja dhe revolucioni islam.....	151
Qëllimi kryesor është: Ringjallja rishtas e Islamit.....	152
Vetëm sundimi i Islamit.....	153
Morali dhe rruga e kërkuar për guvernatorët myslimanë.....	154
Zyrtarët duhet të bëhen myslimanë.....	155
Kuptimi i qeverisë islame.....	155

Karakteristikat e shtetit islam.....	157
Begatitë e shtetit islam.....	157
Shteti islam është premisa e formimit të botës islame.....	159
Ne mund t'i forcojmë shtyllat e qytetërimit islam.....	159
FAKTORËT QË NDIKUAN NË ARRITJEN E QYTETËRIMIT ISLAM.....	160
Mbajeni të gjallë dritën e shpresës.....	161
Pritshmëria lëviz me mall dhe shpresë.....	162
Mbështetja te Mehdiu është ringjallje e frymës së shpresës.....	163
Me ndihmën e besimit, ne mundemi.....	164
Përcaktimi i të ardhmes është në dorën e njeriut.....	166
Përfitimi nga përgatitjet dhe aftësitë.....	166
Të punosh me sinqeritet dhe besnikëri.....	167
Thirrja për të lëvizur dhe për t'u ngritur në këmbë.....	168
Qëndrueshmëria është kusht i arritjes së qytetërimit islam.....	172
Drejtësia dhe korrektësia e Profetit Muhamed (<i>Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!</i>).....	173
Lidhja me Allahun.....	176
Profeti Muhamed (<i>Paqja e bekimi i Allahut qoftë mbi të e mbi familjen e tij!</i>) kërkonte gjithmonë ndihmë nga Allahu i Lartësuar.....	177
NDJEKJA E MODELIT PROFETIK.....	178
Të veprosh sipas ligjeve të Islamit; rruga e mbërritjes drejt qëllimit.....	179

I tillë ishte Imam Khomeni (<i>Allahu ia shenjtëroftë sekretet!</i>).....	180
Shtyllat e Republikës Islamike, në qasjen e Imam Khomenit (<i>Allahu ia shenjtëroftë sekretet!</i>).....	182
ARSIMIMI DHE KËRKIMI I TË DREJTËS.....	183
Pyetja paraprin mbërritjen drejt të vërtetës.....	186
Faktorët e ruajtjes së qytetërimit islam dhe zhvillimi i tij.....	186
Përkushtimi fanatik ndaj besimit.....	188
Lufta e ftohtë dhe pa zhurmë.....	189
Lufta dhe vendosmëria.....	190
Asketizmi dhe mosdhënia rëndësi kësaj bote.....	192
SHMANGIA E DISKRIMINIMIT.....	193
Ruajtja e unitetit shoqëror.....	195
Përçarja dhe konflikti, faktor i dobësimit të myslimanëve.....	195
LOGJIKA DHE DREJTËSIA.....	197
Shkaqet e triumfit të Islamit ndaj të gjitha feve të botës.....	198
Qëllimi i sistemit qeverisës islam është: Vendosja e drejtësisë islame.....	198

تأسيس الحضارة الإسلامية

السيد علي الخامنئي

تيرانا 2020

اسم الكتاب: تأسيس الحضارة الإسلامية

المؤلف: السيد علي الخامنئي

المترجم: الحاج ولنت مريا

التصحيح الأدبي: يريدا كولا

التصحيح اللغوي: ويولسا كاراي

الاخراج النهائي و تصميم الغلاف: صبريه فرا

ناشر: جمعية النسيم - تيرانا - ألبانيا